



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSPEKTORATI SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL**

**ANALIZA VJETORE E PUNËS
VITI 2023
INSPEKTORATI SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL**

TIRANË - JANAR 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSPEKTORATI SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Nr. 1573 Prot.

Tiranë, më 31.01.2024

ANALIZA VJETORE E PUNËS
VITI 2023
INSPEKTORATI SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL

Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial është institucion qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe industrinë, i cili është krijuar dhe funksionon në mbështetje të Ligjit Nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 410, datë 13.5.2015 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, si dhe Urdhrit të Kryeministrit Nr.105, datë 13.08.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, i ndryshuar. Në strukturën organizative ISHTI ka si pjesë përbërëse të tij 10 (dhjetë) drejtori, përkatësisht:

1. Drejtoria e Analizës, Vlerësimit të Riskut dhe Monitorimit (DAVRM)
2. Drejtoria e Laboratorit Qendror (DLQ)
3. Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve Nën Presion (DIPNP)
4. Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre (DINGN)
5. Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makinerive Ngritëse (DIPIEMN)
6. Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare (DSGIK)
7. Drejtoria e Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional (DIPKN)
8. Drejtoria e Çështjeve Juridike (DÇJ)
9. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës (DBF)
10. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme (DBNJSHB)

Për hartimin e Analizës Vjetore të Punës mbi veprimtarinë e ISHTI-t për vitin 2023, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme është bazuar në analizën e punës së përgatitur nga secila drejtori, mbi veprimtarinë e tyre të punës gjatë vitit 2023, sipas sektorëve dhe detyrave të tyre funksionale. Më poshtë pasqyrohet në mënyrë të detajuar aktiviteti i secilës drejtori për periudhën Janar - Dhjetor 2023.

**↓ DREJTORIA E ANALIZËS, VLERËSIMIT TË RISKUT DHE MONITORIMIT
(DAVRM)**

Drejtoria e Analizës, Vlerësimit të Riskut dhe Monitorimit ka si qëllim kryesor të punës së saj, sigurimin, bashkërendimin, mbikëqyrjen, orientimin dhe aplikimin e duhur të procedurave, metodologjive dhe standardeve të inspektimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Objektivat kryesorë të punës së Drejtorisë së Analizës, Vlerësimit të Riskut dhe Monitorimit (DAVRM) për vitin 2023, konsistuan në:

A. Vlerësimin dhe menaxhimin e niveleve të riskut duke klasifikuar në risk sektori dhe risk subjekti sipas shkallëve:

- risk i ulët,
- risk i mesëm,
- risk i lartë

Është realizuar analizë e thelluar e të gjitha inspektimet të kryera nga drejtoritë inspektuese, me qëllim klasifikimin dhe vlerësimin e riskut të sektorit dhe riskut të subjektit.

B. Analizë specifike mbi punën inspektuese të drejtorive, përkatësisht:

- DINGN, inspekton 1000 subjekte në vit,
- DIPNP, inspekton 2500 subjekte në vit,
- DIPIEMN, inspekton 2000 subjekte në vit,

Analiza e verifikimit të procedurave të kryerjes së inspektimeve kryhet me qëllim rritjen e sigurisë dhe cilësisë duke kontribuar në rritjen e efikasitetit dhe menaxhimin e riskut.

C. Verifikim i subjekteve të mbyllura në QKB, me qëllim përditësimin e listës së planit të inspektimit të drejtorive inspektuese. Sektori i Planifikimit analizon dhe verifikon me kujdes subjektet me status:

- Subjekti rezulton "i mbyllur";
- Subjekti "nuk ushtron aktivitet";
- Subjekti "ka ndryshuar adresë aktiviteti";
- "pajisja nuk është në punë".

D. Identifikimi i problematikave në inspektimet e realizuara për secilën drejtori bazuar në të dhënat e gjeneruara nga sistemi e-inspektimi dhe hartimi i raporteve javore/mujore.

- Inspektimet e kryera me autorizim nga çdo inspektor, shkeljet e konstatuara, rekomandimet e lëna dhe masat administrative të vendosura sipas rasteve.
- Vlerësimi dhe respektimi i kërkesave ligjore mbi procesin e inspektimit;
- Dokumentimi i praktikave në respektimin e kërkesave ligjore;
- Raportimi i parregullsive të inspektimit me qëllim përmirësimin e procesit të inspektimit;

❖ Detyrat kryesore të DAVRM

Drejtoria e Analizës, Vlerësimit të Riskut dhe Monitorimit për vitin 2023 është fokusuar në këto detyra parësore:

- Vlerësimin dhe menaxhimin e niveleve të riskut.
- Analiza e riskut mbi drejtoritë inspektuese.
- Lista e subjekteve me profil risku të lartë
- Kontrolli mbi respektimin e planit të inspektimit të drejtorive inspektuese.
- Monitorimi i procesit të inspektimit në sistemin e-inspektimi.

Drejtoria e Analizës, Vlerësimit të Riskut dhe Monitorimit përbëhet nga: Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Riskut, Sektori i Planifikimit dhe Metodikave të Kontrollit, si dhe Sektori i Monitorimit, ku secili prej tyre ka të përcaktuara qartë detyrat e tij funksionale dhe përgjegjësitë, duke bashkëpunuar në varësi të kërkesave të caktuara në funksion të Drejtorisë. Në analizën e realizuar për periudhën 1-vjeçare është specifikuar puna e secilit sektor.

1. **Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Riskut**

Vlerësimi i riskut ka si qëllim, që të sigurojë identifikimin dhe trajtimin në kohën e duhur të risqeve në këtë institucion. Identifikimi i fushave të riskut, vlerësimi i riskut dhe eliminimi/ reduktimi i riskut, në minimumin e mundshëm, në mënyrë që të arrihen objektivat dhe të krijohet një kulturë vendimmarrje me risk të përllogaritur në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial.

Përbushja e qëllimit të menaxhimit të riskut në ISHTI realizohet nëpërmjet:

- a) Ngritjes dhe funksionimit të sektorit të vlerësimit të riskut me qëllim kategorizimin dhe menaxhimin e nivelit të riskut;
- b) Analizimin dhe raportimin e vazhdueshëm të problematikave të hasura gjatë procesit të inspektimit me qëllim përmirësimin e procesit;
- c) Monitorimit të qëndrueshmërisë së riskut;
- d) Marrjes së masave për pakësimin/ eliminimin e riskut në nivel të pranueshëm.

DAVRM, pas hartimit të “Udhëzimit për Menaxhimin e Riskut” është angazhuar në vijim për rishikimin dhe përmirësimin e metodologjisë së menaxhimit të riskut dhe po punohet për konfigurimi i riskut nga roli ligjor sipas udhëzimeve të Inspektoratit Qendror (IQ) në plotësim të modul-it “Vlerësimi i Risk-ut” në sistemin online “e-inspektimi”. Prioriteti i analizës në këtë periudhë ka qenë identifikimi i fushave të riskut, vlerësimi i riskut, si dhe analizimi indikatorëve për reduktimin e riskut në minimumin e mundshëm për inspektim.

Të gjitha subjektet që inspektohen nga ISHTI, do të kalojnë në një filtër kontrolli sipas profilit të riskut nga Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Riskut (SAVR) në funksion të detyrave që kryen. Sektori realizon vlerësimin e të dhënave të inspektimit dhe i analizon indikatorët me qëllim evidentimin e nivelit të riskut, trajtimin e tij nëpërmjet një sistemi metodik të strukturuar, për përbushjen me korrektësi dhe me cilësi të inspektimeve.

SAVR në vijim të punës ka bërë analizën e plotë të mënyrës së funksionimit të drejtorive, të cilat kryejnë inspektime në terren dhe që zotërojnë në veçvete risk, konkretisht, Drejtorisë së Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre (DINGN), Drejtorisë së Inspektimit të Pajisjeve Nën Presion (DIPNP), si dhe të Drejtorisë së Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike dhe Makinerive Ngritëse (DIPIEMN) me objekt:

- a. Analizë të vendimeve me shkelje (gjōba) pēr vitin 2023, pēr evidentimin e indikatorëve mē tē rēndēsishēm tē konstatuara gjatē shkeljeve, me qëllim marrjen e masave pēr fokusin e kontrollit në vijim.
- b. Analizē e detajuar e tē gjitha inspektimeve tē realizuara pēr periudhēn janar-dhjetor 2023, pēr secilēn drejtori inspektuese me qëllim klasifikimin e riskut tē sektorit dhe riskut tē subjektit.
- c. Analizē e "listē verifikimeve" bazuar mbi kērkesat e ligjore, pēr standardizimin e tyre dhe verifikimit nēse listat janë tē aplikueshme nga inspektorēt në terren ose jo.
- d. Analizē mbi procedurat dhe rregullat e inspektimit dhe tē dokumentimit tē Drejtorisë sē Inspektimit tē Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makineritē Ngritēse.

1.1 Analiza specifike e klasifikimit tē riskut mbi Drejtoritē Inspektuese

Analiza e veprimtarisë sē DAVRM pēr vitin 2023, ēshtē bazuar në një sistem monitorimi online dhe kontrolli ditor. Raportet e pērgatitura dhe analizat e kryera pēr çdo drejtori inspektuese shērbejnē në pērmirēsimin e procesit tē punēs dhe në pērmbushjen e objektivave tē pērcaktuara pēr institucionin.


1.1.1 Nga analiza e realizuar pēr periudhēn janar-dhjetor 2023 pēr DINGN rezulton se:

Nga 810 inspektime në total, 330 inspektime ose 40.7% kanë rezultuar me risk tē lartē sektori, në bazē tē monitorimit janë identifikuar problematika që lidhen me mungesēn e dokumentacionit shoqērues në sistemin e-inspektimeve, hedhja në sistem e dokumentacionit ēshtē detyrim ligjor nga ana e inspektorëve. Në 56 inspektime ose 6.9% janë identifikuar me risk tē mesēm sektori ku rezulton se janë ngarkuar një pjesē e dokumentacionit tē deklaruar në listē verifikim. Në 106 inspektime ose 13% janë vlerēsuar me risk tē ulēt sektori sepse, pjesa mē e madhe e dokumentacionit ēshtē ngarkuar në sistem dhe procesi i inspektimit ēshtē realizuar në pērputhje me legjislacionin në fuqi. Në 13 inspektime rezulton që janë klasifikuar njēkohēsisht me risk sektori dhe risk subjekti, në rastet kur subjektit i ēshtē lēnē detyrē plotēsimi i tē gjithē dokumentacionit. 17 inspektime janë vlerēsuar me risk tē lartē subjekti sepse pēr arsye tē moszbatimit tē kērkesave ligjore kanë marrē masē administrative. Në 2 inspektime janë vlerēsuar me risk tē mesēm subjekti, pasi subjekti zbaton pjesērisht kērkesat dhe çertifikimet tē pērcaktuara me ligj.

KLASIFIKIM RISKU DINGN			
	Risk Sektori	Risk Sektori/Subjekti	Risk Subjekti
I Ulēt	106	0	0
I Mesēm	56	0	2
I Lartē	330	13	17

Tabela nr. 1 Klasifikimi i riskut, DINGN janar-dhjetor 2023.

Klasifikim i Riskut DINGN



Grafiku nr. 1 Klasifikimi i riskut DINGN


1.1.2 Nga analiza e kryer për periudhën janar - dhjetor 2023 për Drejtorinë e Pajisjeve nën Presion (DIPNP) rezulton se:

Nga 3006 inspektime në total, **1350 inspektime ose 44.9%** janë vlerësuar me risk të lartë sektori, ku në bazë të monitorimit janë identifikuar problematika që lidhen me mungesën e dokumentacionit shoqërues në sistemin e-inspektimeve, si detyrim ligjor nga ana e inspektorëve. **71 inspektime ose 2.3%** janë identifikuar me risk të mesëm sektori ku rezulton se janë ngarkuar një pjesë e dokumentacionit të deklaruar në listë verifikimi. **75 inspektime ose 2.5%** janë vlerësuar me risk të ulët sektori, sepse pjesa më e madhe e dokumentacionit është ngarkuar në sistem dhe procesi i inspektimit është realizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në **8 inspektime** rezulton që janë klasifikuar njëkohësisht me risk sektori dhe risk subjekti, në rastet kur subjektit i është lënë detyrë plotësimi i të gjithë dokumentacionit dhe nuk e kanë ri inspektuar si subjekt. **18 inspektime** janë vlerësuar me risk të lartë subjekti sepse për arsye të moszbatimit të kërkesave ligjore, kanë marrë masë administrative.

KLASIFIKIM RISKU (Janar-Dhjetor) (DIPNP)			
	Risk Sektori	Risk Sektori/Subjekti	Risk Subjekti
I Ulët	75	0	0
I Mesëm	71	0	0
I Lartë	1350	8	18

Tabela nr.2 Klasifikimi i riskut, DIPNP janar-dhjetor 2023.

Klasifikim i Riskut DIPNP



Grafiku nr. 2 Klasifikimi i riskut DIPNP


1.1.3 Nga analiza e realizuar për periudhën janar-dhjetor 2023 për Drejtorinë e Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makinerive Ngritëse (DPIEMN) rezulton se:

Nga 2197 inspektime në total, **355 inspektime** ose **16.1%** janë vlerësuar me risk të lartë sektori, ku në bazë të monitorimit janë identifikuar problematika që lidhen me mungesën e dokumentacionit shoqërues në sistemin e-inspektimeve, si detyrim ligjor nga ana e inspektorëve. **74 inspektime** ose **3.3%** janë identifikuar me risk të mesëm sektori ku rezulton se janë ngarkuar një pjesë e dokumentacionit të deklaruar në listë verifikim, pjesa tjetër mungon pavarësisht se në listë verifikim është pohuar që subjekti disponon të gjithë dokumentacionin. Në **62 inspektime** ose **2.82%** janë vlerësuar me risk të ulët sektori, sepse pjesa më e madhe e dokumentacionit është ngarkuar në sistem dhe procesi i inspektimit është realizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në **140 inspektime** rezulton që janë klasifikuar njëkohësisht me risk sektori dhe risk subjekti rastet kur subjektit i është lënë detyrë plotësimi i të gjithë dokumentacionit dhe nuk e kanë ri inspektuar si subjekt në vazhdimësi. **38 inspektime** janë vlerësuar me risk të lartë subjekti, subjektet që për arsye të moszbatimit të kërkesave ligjore, kanë marrë masë administrative ose subjekti nuk disponon dokumentacion.

KLASIFIKIM RISKU(DPIEMN)			
	Risk Sektori	Risk Sektori/Subjekti	Risk Subjekti
I ulët	62	0	0
I mesëm	74	0	0
I lartë	355	140	38

Tabela nr.3 Klasifikimi i riskut DIPIEMN

Klasifikim i Riskut DIPIEMN



Grafiku Nr. 3 Klasifikimi i Riskut DIPIEMN

1.2 Analiza e inspektimeve me gjobë

Bazuar në informacionin e analizuar nga Sektori i Analizës dhe Vlerësimit të Riskut është hartuar raporti përmbledhës, duke identifikuar disa nga masat administrative që janë marrë ndaj subjekteve të inspektuara.

Drejtoria e Inspektimit të Gazit, Naftës dhe Nënprodukteve (DINGN)													
Inspektime Viti 2023													
	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	Totali
Nr.	54	74	69	77	72	66	83	38	69	64	79	74	819
Aksidente Viti 2023													
Nr.											1		1
Masa Administrative Viti 2023													
Nr.	1	-	1	-	-	-	-	-	-	5	8	1	16
	Shmangie e cilësisë					Shkelje të ligjshmërisë			Shuma				
Sh.a	1					3			4				
Sh.p.k	3					9			12				
Totali	4					12			16				

Tabela Nr. 4- Masa administrative të marra nga DINGN, për periudhën janar- dhjetor 2023

Nga rezultatet e tabelës nr.1, në total për Drejtorinë e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre janë vendosur 16 masa administrative me gjobë, nga të cilat 12 për subjektet Sh.p.k dhe 4 për subjektet Sh.A. Në total janë marrë 4 gjoba për shmangie cilësie dhe 12 gjoba për shkelje të ligjshmërisë. Një masë administrative është marrë gjatë muajit nëntor për arsye aksidenti.

Drejtoria e Inspektimit të Paisjeve Nën Presion (DIPNP)													
Inspektime Viti 2023 sipas të dhënave nga portali e-inspektimit													
	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	Totali
Inspektime	264	321	312	278	297	257	225	166	214	250	227	237	3048
Masa Administrative	4	-		1	-					3	1	1	10

Tabela Nr. 5- Masa administrative të marra nga DIPNP, për periudhën Janar-Dhjetor 2023

Nga të dhënat e tabelës për DIPNP, rezultojnë që në total janë vendosur **10 gjoba** për vitin 2023, nga 3006 inspektime të realizuara në total.

Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makinerive Ngritëse (DIPIEMN)												
						Inspektime Viti 2023						
JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	Totali
128	139	144	159	262	225	198	165	182	176	223	243	2244
						Aksidente Viti 2023						
						Gjoha Viti 2023						
-	1	2	4	3	-	3	3	8	2	2	5	33
						Shkaqet e gjobave						
Mos realizimi i detyrave të lëna												

Tabela Nr. 6- Masat administrative të marra nga DIPIEMN, për periudhën Janar-Dhjetor 2023

Nga të dhënat e tabelës për DIPIEMN, rezultojnë që në total janë vendosur **33 gjoba** për vitin 2023, nga 2197 çështje të realizuara në total.

2.1 Sektori i Planifikimit dhe Metodikave të Kontrollit

Sektori i Planifikimit dhe Metodikave të Kontrollit (SPMK), ka realizuar analizën vjetore të inspektimeve të hartuara nga drejtoritë përkatëse. Qëllimi i këtij sektori është realizimi i procesit të planifikimit të veprimtarisë së inspektimit, nëpërmjet analizimit të situatës, për përdorimin në mënyrë eficientë të burimeve të inspektimit duke garantuar standardizimin e procesit.

Paraqitja e tabelave të mëposhtme tregojnë raportin e planifikimit vjetor për secilën drejtori dhe inspektimet e realizuara jashtë dhe brenda planit. Gjithashtu është dhënë edhe numri i çështjeve që janë anuluar për secilën drejtori. SPMK ka kryer një analizë e hollësishme nga monitorimi i sistemit e-inspektimi për identifikimin e subjekteve, të cilat janë të mbyllura, nuk ushtrojnë aktivitet, nuk ndodhen në adresën e deklaruar ose pajisja është jashtë funksioni.

Muaji	Planifikimi	Inspektime të Realizuara	Jashtë planit	Anulluara
Janar	56	54	8	0
Shkurt	64	70	10	4
Mars	74	69	0	0
Prill	73	73	4	4
Maj	74	72	0	0
Qershor	69	66	1	0
Korrik	86	83	0	0
Gusht	39	38	1	0
Shtator	70	68	1	1
Tetor	63	64	9	0
Nëntor	65	79	14	0

Dhjetor	67	74	8	0
TOTAL	535	810	56	9

Tabela nr. 7 Inspektimet e planifikuara nga DINGN për periudhën Janar- Dhjetor 2023

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton për Drejtorinë e Inspektimit të Naftës dhe Gazit gjatë vitit 2023 ka planifikuar 535 inspektime në total dhe janë realizuar 56 inspektime jashtë planit ose 15.8% të inspektimeve. Në total janë kryer 810 inspektime dhe 9 çështje janë anuluar.

Muaji	Planifikimi	Inspektime Realizuara	Jashtë planit	Anulluara
Janar	303	258	33	6
Shkurt	278	317	50	4
Mars	330	305	17	7
Prill	286	277	8	1
Maj	299	290	19	7
Qershor	288	256	10	1
Korrik	312	225	14	0
Gusht	237	164	6	2
Shtator	205	213	5	1
Tetor	269	243	16	7
Nëntor	209	222	12	5
Dhjetor	224	236	18	1
TOTAL	3240	3006	208	42

Tabela nr.8 Inspektimet e planifikuara nga DiPNP për periudhën Janar-Dhjetor 2023

Bazuar në të dhënat e sistemit të gjeneruara në këtë tabelë rezulton se Drejtorisë së Inspektimit të Pajisjeve Nën Presion në total ka planifikuar 3240 çështje dhe ***jashtë planit janë realizuar 208 inspektime ose 6.4%*** të inspektimeve. Në total janë kryer 3006 inspektime dhe 42 çështje rezultojnë të anuluar.

Muaji	Planifikimi	Inspektime të Realizuara	Jashtë planit	Anulluara
Janar	110	123	19	5
Shkurt	110	136	15	3
Mars	110	144	17	0
Prill	124	146	30	13
Maj	124	238	19	24
Qershor	124	225	9	0
Korrik	105	198	11	0
Gusht	105	165	20	0
Shtator	105	182	35	0
Tetor	110	175	25	1
Nëntor	110	222	55	1
Dhjetor	109	243	62	0

TOTAL	1346	2197	317	47
--------------	-------------	-------------	------------	-----------

Tabela nr. 9 Inspektimet e planifikuara nga DIPIEMN për periudhën Janar-Dhjetor 2023

Bazuar në të dhënat e sistemit të gjeneruara në këtë tabelë rezulton se, Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makinerive Ngritëse ka planifikuar në total 1346 inspektime ku **317 janë inspektime jashtë planit ose 23.5%** të planifikimeve. Në total janë kryer 2197 inspektime dhe 47 çështje janë të anulhuara.

2.1.1 Identifikimi i Subjekteve të Mbyllura

Përgjatë periudhës 1 –vjeçare janë verifikuar të gjitha inspektimet e realizuara për të identifikuar subjekte të cilat janë të mbyllura dhe nuk duhet të jenë objekt inspektimi, me qëllim lehtësimin e procesit të planifikimit.

Drejtoria Inspektuese	Subjekte të mbyllura	Nr
Drejtoria e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre (DINGN)	Subjekte të mbyllura	31
Drejtoria e Pajisjeve nën Presion (DIPNP)	Subjekte të mbyllura/nuk disponon pnp/gln, i ka jashtë përdorimi pnp/gln, ka ndaluar aktivitetin	327
Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makinerive Ngritëse (DIPIEMN)	Subjekte të mbyllura, nuk është objekt inspektimi ose nuk ushtron aktivitet në adresën e deklaruar	192

Tabela nr. 10 Subjekte të mbyllura Janar-Dhjetor 2023

Nga të dhënat e tabelës rezulton se, nga monitorimi në sistem i inspektimeve në total kemi 550 subjekte të cilat janë të mbyllura, nuk janë objekte inspektimi, nuk disponojnë pnp/gln, kanë të ndaluar aktivitetin, ose nuk ushtrjnë aktivitet në adresën e deklaruar. Nga këto inspektime për DINGN janë 31 subjekte në total, për DIPNP 327 subjekte dhe për DIPIEMN 192 subjekte. Drejtoritë inspektuese janë vënë në dijeni për këto subjekte me qëllim planifikimin sa më të saktë të procesit të inspektimit.

2.1.2 Çështjet e Anulluara

Për periudhën Janar -Dhjetor 2023, në total për të tre drejtoritë inspektuese janë anuluar 98 çështje. Shumica e këtyre çështjeve janë anuluar me arsyetimin:

- Bazuar në Procesverbalin me Nr. 3319/1 Prot., datë 08.05.2023 për shkak të problematikës së sistemit, çështjet e lëna "riinspektim" janë krijuar gabimisht dy herë në sistem;
- Bazuar në Procesverbalin me Nr. 3964 Prot., datë 30.05.2023 anulohet çështja, për shkak se janë hedhur të dhënat gabim gjatë procesit të inspektimit. Subjekti u inspektua përsëri me Nr.çështje: ISHTI-DQ-2023-002754, ku u hodhën të dhënat e sakta, në lidhje me dokumentacionin përkatës të subjektit.
- Bazuar në Procesverbalin me Nr. 7998 Prot., datë 18.10.2023, anulohet çështja për shkak se, ka pasur një shkoputje të internetit dhe gjatë plotësimit të rubrikave ka hyrë subjekti APM me përfaqësues Mirjeta Furxhi, gabimisht është vazhduar inspektimi deri në Vendimin Përfundimtar ku u pa që po punohej mbi subjektin APM.

Ky manual përcakton se sektori i Monitorimit, pjesë e Drejtorisë së Analizës, Vlerësimit të Riskut dhe Monitorimit, do të ketë si objektiv punën në terren. Veprimtaria e punës në terren për Sektorin e Monitorimit lidhet me ndjekjen dhe verifikimin e procesit të inspektimit të kryer nga inspektorët e çdo drejtorie inspektuese duke shqyrtuar afatet e autorizimit, dokumentacionin që siguron një proces të rregullt ligjor inspektimi dhe kodin etik gjatë këtij procesi inspektimi si dhe transparencën e vendimit përfundimtar.

Për kryerjen e këtij monitorimi në terren, Drejtoria e Analizës, Vlerësimit të Riskut dhe Monitorimit (DAVRM) ka krijuar tre formularë; në mënyrë të tillë që procesi i monitorimit të jetë sa më i saktë:

1. *Autorizim;*
2. *Procesverbal;*
3. *Informacion;*

Grupi i Monitorimit, do të nisë me verifikimin në terren pas formularit "Autorizim", të lëshuar me urdhër nga Kryeinspektori. Gjatë apo pas procesit të monitorimit, grupi i monitorimit përgatit dokumentacionin përkatës, formularin "Procesverbal" dhe më pas formularin "Informacion" (akte verifikimi, relacion mbi monitorimin, etj.). Për zbatimin e procedurave përkatëse, sipas çdo rasti të konstatuar dhe/ose në rast se ka dyshime për/apo moszbatim të ligjit, i referon këto raste duke informuar me shkrim titullarin e institucionit /Kryeinspektorin.

3.1.2 Monitorimi i procesit të inspektimit

Një nga objektivat e punës për Drejtorinë gjatë vitit 2023-ka qenë monitorimin e inspektimeve dhe identifikimin e problematikave gjatë inspektimeve, me qëllim përmirësimin dhe funksionimin sipas ligjit të procesit të inspektimit.

1. Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve


Referuar sistemit e-Inspektimi për periudhën Janar-Dhjetor 2023, për DINGN janë planifikuar që të realizohen **535 çështje për inspektim** dhe totali i realizuar për vitin 2023 është **810 inspektime**. Nga këto inspektime të realizuara 56 inspektime janë jashtë planit, ndërkohë që 9 çështje në sistem rezultojnë të anuluar. Gjatë procesit të monitorimit janë identifikuar në total 5 inspektime, që lidhen me mosmbajtje të Procesverbalit në kohë reale dhe 77 inspektime, që kanë vendndodhje të ndryshme me adresën e subjektit që është inspektuar.

Gjatë procesit të monitorimit, janë shqyrtuar në total **810 inspektime** të realizuara nga DINGN, ku rezulton se në 341 prej tyre nuk kanë të ngarkuar dokumentacionin shoqërues, ku edhe në grafikun ilustrues ka edhe përqindjen më të lartë të problematikave. 42% e inspektimeve nuk kanë dokumentacion shoqërues. 252 inspektime, ose 31% e tyre kanë kryer një proces të rregullt procedural duke ngarkuar edhe në sistem të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Në 106 inspektime rezulton se ka pjesën më të madhe të dokumentacionin ose 13%. Në 7% të inspektimeve janë ngarkuar vetëm pjesërisht dokumentacione. Në 4% të rasteve ose 31 inspektime që janë kryer rezulton që subjektet janë të mbyllura. Në 16 raste subjekti ka marrë masë administrative.

INSPEKTIMET E SHQYRTUARA PËR MUNGESË DOKUMENTACIONI DINGN (JANAR-DHJETOR 2023)

Dokumentacioni shoqërues	Nr. Inspektimeve
Nuk ka dokumentacion shoqërues	341
Ka dokumentacion shoqërues	252
Ka pjesën më të madhe të dokumentacionit	106
Ka dokumentacion pjesërisht	56
Subjektit i lihet detyrë detyrë plotësimi i dokumentacionit	5
Subjekti ka marrë masë administrative	16
Subjekte të mbyllura	31
Inspektimi kryhet me kërkesë të subjektit	3
Çështje të anuluar	9

Tabela nr.11 Inspektime të shqyrtuara për dokumentacion DINGN



Grafiku nr.4 Inspektime të shqyrtuara për dokumentacion DINGN

2. Drejtoria e Inspektimit të Paisjeve nën Presion


Referuar sistemit të e-Inspektimit për periudhën Janar-Dhjetor 2023, për DIPNP janë planifikuar **3240 inspektime** dhe janë realizuar në total **3006 inspektime**. Nga këto inspektime të realizuara janë **208 inspektime** jashtë planit, ndërkonë që janë **42 çështje** në sistem që rezultojnë të anuluar.

Gjatë procesit të monitorimit, janë shqyrtuar në total 3006 inspektime të realizuara nga DIPNP, ku rezulton se, në 1353 prej tyre nuk kanë dokumentacion shoqërues ku edhe në grafikun ilustrues ka edhe përqindjen më të lartë 44% e inspektimeve që nuk kanë dokumentacion shoqërues. 1029 inspektime ose 34% ka dokumentacion shoqërues/ka pjesën më të madhe të dokumentacionit. Në 71 inspektime ose 2% ka pjesërisht dokumentacion. Në 42 inspektime, ose 1% janë çështje të anuluar. Në 327 inspektime, ose 11% janë subjekte të mbyllura/nuk disponon pnp/gln,i ka jashtë

përdorimi pnp/gln/ka ndaluar aktivitetin. Në 166 inspektime, ose 5% subjekti disponon bombola gln të lëvizshme <25 kg/kaldajë/bombola të gazrave teknik. Në 20 inspektime ose 1% subjektit i është lënë detyrë/shtyrje e afatit të inspektimit. Në 23 inspektime ose 1% se subjektet kanë ndryshuar adresë/pronësi/janë në proces rikonstruksioni. Në 3 inspektime subjekti nuk disponon dokumentacion. Në 14 inspektime subjekti ka marrë masë administrative.

INSPEKTIMET E SHQYRTUARA PËR KLASIFIKIM RISKU DIPNP (JANAR-DHJETOR 2023)	
Dokumentacioni shoqërues	Nr.Inspektimeve
Ka dokumentacion shoqërues/Ka pjesën më të madhe të dokumentacionit	1029
Nuk ka dokumentacion shoqërues	1353
Ka dokumentacion pjesërisht.	71
Çështje të anulhuara	42
Subjekte të mbyllura/Nuk disponon pnp/gln, i ka jashtë përdorimi pnp/gln, ka ndaluar aktivitetin	327
Subjekti disponon bombola gln të lëvizshme <25 kg/kaldajë/bombola të gazrave teknik	166
Subjektit i është lënë detyrë/Shtyrje e afatit të inspektimit	20
Subjekte që kanë ndryshuar adresë/pronësi/janë në proces rikonstruksioni	23
Subjekti nuk disponon dokumentacion	3
Sub Subjekti ka marrë masë administrative	14

Tabela nr.12 Inspektime të shqyrtuara për dokumentacion DIPNP



Grafiku nr.5 Inspektime të shqyrtuara për dokumentacion DIPNP


3. Drejtoria e Inspektimit të Paisjeve, Elektrike dhe Makinerive Ngritëse

Referuar sistemit të e-Inspektimit për periudhën janar-dhjetor 2023, për DIPIEMN janë planifikuar **1346 inspektime** dhe janë realizuar në total **2197 inspektime**. Nga këto inspektime të realizuara janë **317 inspektime** jashtë planit, ndërkohë që janë **47 çështje** në sistem që rezultojnë të anulhuara.

Gjatë procesit të monitorimit, janë shqyrtuar në total 2197 inspektime të realizuara nga DIPIEMN, ku rezulton se, në 968 prej tyre kanë të ngarkuar dokumentacion shoqërues/ ka pjesën me të madhe të dokumentacionit shoqërues ku, edhe në grafikun ilustrues ka edhe përqindjen më të lartë, 43% e inspektimeve kanë të ngarkuar dokumentacion shoqërues/ka pjesën me të madhe të dokumentacionit. 351 inspektime, ose 16% e tyre nuk ka dokumentacion shoqërues. Në 475 inspektime, ose 21% subjektit i është lënë detyrë plotësimi i dokumentacionit. Në 74 inspektime, ose 3% ka dokumentacion pjesërisht. Në 78 inspektime, ose 4% subjekti ka kërkuar shtyrje inspektimi. Në 32 inspektime ose 1% subjekti ka marrë masë administrative. Në 192 inspektime ose 9% janë subjekte të mbyllura, nuk është objekt inspektimi, ose nuk ushtron aktivitet në adresën e deklaruar. Në 24 inspektime subjekti nuk disponon dokumentacion. 47 ose 2% e çështjeve në sistem janë çështje të anulhuara.

INSPEKTIMET E SHQYRTUARA PËR KLASIFIKIM RISKU DIPIEMN (JANAR-DHJETOR 2023)	
Dokumentacioni shoqërues	Nr. Inspektimeve
Nuk ka dokumentacion shoqërues	351
Subjektit i është lënë detyrë plotësimi i dokumentacionit	74
Ka dokumentacion pjesërisht	475
Subjekti ka kërkuar shtyrje inspektimi	78
Subjekti ka marrë masë administrative	32
Subjekte të mbyllura, nuk është objekt inspektimi ose nuk ushtron aktivitet në adresën e deklaruar	192
Ka dokumentacion shoqërues/ ka pjesën me të madhe të dokumentacionit	968
Nuk është realizuar inspektimi	3
Subjekti nuk disponon dokumentacion	24
Çështje të anulhuara	47

Tabela nr.13 Inspektime të shqyrtuara për dokumentacion DIPIEMN



Grafiku nr.6 Inspektime të shqyrtuara për dokumentacion DIPIEMN

↓ DREJTORIA E LABORATORIT QENDROR
(DLQ)

Drejtoria e Laboratorit Qendror, si haikë përbërëse kryesore e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, ka ushtruar veprimtarinë e saj duke përmbushur me profesionalizëm, saktësi dhe kohë detyrën kryesore të saj, kryerjen me përgjegjësi të analizave laboratorike të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në Laboratorin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve, si dhe analizave të detergjentëve të ndryshëm, letrës, lëkurës dhe këpucëve në Laboratorin e Tekstitit.

Analizat kryhen në përputhje me kërkesat e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare që mbulojnë fushën e shërbimit për testimin e kampioneve të marra në dogana, tregun e brendshëm dhe të tretë.

Më poshtë gjeni në mënyrë të detajuar analizën e punës së kryer për vitin 2023, të ndarë sipas sektorëve.

1. Laboratori i Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve

Laboratori i Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve është i angazhuar që çdo veprimtari të jetë në përputhje me kërkesat e standardit S SH EN ISO 17025 : 2017, e cila bën të mundur rritjen e saktësisë dhe besueshmërisë së tërësisë së analizave që kryhen nga ky laborator.

Gjatë vitit 2023 në Laboratorin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve u testuan gjithsej **6507** kampione, nga të cilat **2599** kampione të marra në dogana dhe **3854** kampione të marra për tregun e brendshëm, ku: **783** kampione janë sondazhe, **3071** kampione janë të plota dhe **54** kampione janë palë e tretë nga të cilat **15** kanë hyrë nga kodifikimi dhe **39** prej tyre nga zyra e protokollit. *Nga analizimi 3 kampionë, përkatësisht 2 gazoil dhe 1 white spirit, kanë rezultuar me shmangie nga standardi gjatë vitit 2023.*

Krahasimisht me vitin 2022 u testuan gjithsej **6475** kampione, nga të cilat **2278** kampione të marra në dogana dhe **4132** kampione të marra për tregun e brendshëm, ku: **999** kampione janë sondazhe, **3133** kampione janë të plota, **65** kampione janë palë e tretë nga këto, 21 kampione kanë ardhur të sekretuara nga zyra e protokollit dhe 44 kampione të sekretuara nga zyra e kodifikimit. *Nga analizimi 3 kampionë, përkatësisht 3 gazoil, kanë rezultuar me shmangie nga standardi gjatë vitit 2022.*

Në mënyrë të detajuar paraqesim tabelën nr.1 ku janë të pasqyruara kampionet e analizuar për vitin 2023 të ndara në kampione të marra në dogana, tregu i brendshëm (të plota, sondazhe) dhe palë të treta të hyra nga zyra e kodifikimit.

Nr.	Emri i kampionit	Doganë	Subjekt			TOTAL
		Kampione	Të plota	Sondazh	Të tretë	
1.	Benzinë	468	972	247	2	1689

2.	Gazoil	829	1087	511	7	2434
3.	Vajgur avioni	11	7	-	-	18
4.	Lëndë djegëse	7	-	1	-	8
5.	G L N	166	729	4	-	899
6.	Vaj lubrifikant	913	204	2	4	1123
7.	Bitum	131	19	-	1	151
8.	Antifrizë	-	-	2	-	2
9.	Naftë bruto	27	26	11	-	64
10.	Mazut	27	13	1	1	42
11.	Solar	-	-	-	-	-
12.	Graso	4	6	-	-	10
13.	Benzin avionesh	-	2	-	-	2
14.	Biodiesel	1	-	1	-	2
15.	Antifriz	-	-	-	-	-
16.	Hollues	11	-	-	-	11
17.	Gjysëm produkt	3	6	-	-	9
18.	Lamix	1	-	-	-	1
19.	White spirit	-	-	3	-	3
	TOTAL	2599	3071	783	15	6468

Në tabelën nr.2. paraqiten kampionet me tregues jashtë standardit gjatë vitit 2023.

Nr	Emri i kampionit	Numri i kampioneve jashtë standardit
1.	Gazoil	2
2.	Ëhite Spirit	1

Në mënyrë të detajuar paraqesim tabelat nr.3 për vitin 2022 të ndara këto në kampione të marra në dogana, tregu i brendshëm (të plota, sondazhe) dhe palë të treta të hyra nga zyra e kodifikimit.

Nr.	Emri i kampionit	Doganë	Subjekt			TOTAL
		Kampione	Të plota	Sondazh	Të tretë	
1.	Benzinë	326	999	64	2	1391
2.	Gazoil	766	1118	80	12	1976
3.	Vajgur avioni	167	7	-	-	174
4.	Lëndë djegëse	4	-	-	-	4
5.	G L N	204	737	7	-	948
6.	Vaj lubrifikant	708	205	7	25	945
7.	Bitum	15	19	2	-	36
8.	Antifrizë	-	-	-	-	-
9.	Naftë bruto	33	23	5	3	64
10.	Mazut	33	12	4	2	51
11.	Solar	1	-	1	-	2
12.	Graso	3	6	-	-	9
13.	Benzin avionesh	-	3	-	-	3
14.	Biodiesel	1	-	-	-	1
15.	Virxhinia	-	-	-	-	-
16.	Hollues	16	-	-	-	16
17.	Gjysëm produkt	1	4	-	-	5
18.	Lamix	-	-	-	-	-
19.	Ëhite spirit	-	-	-	-	-
	TOTAL	2278	3133	999	44	6454

Gjatë vitit 2022 ka rezultuar 3 kampione me tregues jashtë standardit të paraqitura në tabelën nr.4.

Nr	Emri i kampionit	Numri i kampioneve jashtë standardit
1.	Gazoil	3

Grafik krahasues nr.1 - Kampionet e analizuar në Laboratorin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve gjatë vitit 2022 dhe 2023



Krahas përmbushjes së detyrës të kryerjes së testimeve, stafi i laboratorit ka përmbushur edhe detyra të tjera që përshkruhen si më poshtë:

- Implementon dhe zbaton në mënyrë të vazhdueshme të gjitha kërkesat e ISO 17025-2017 për të përmbushur të gjitha detyrat e një laboratorit të akredituar.
- Është punuar për përgatitjen e vizitës vlerësuese të Laboratorit nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.
- Është pritur grupi vlerësues të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.
- Përshtatjen e procesit të analizave sipas Standardeve të reja nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve.
- Pjesmarrja në test krahasimi ndërkombëtar me Laborator të Akredituar Grek dhe vlerësimi maksimal për rezultatet nga analizimi i kryer i mostrës.
- Pjesmarrja e punonjeseve në trajnim ndërkombëtar, e cila ndikon në ngritje profesionale të stafit dhe njohja e përshtatja me metodat e reja bashkëkohore.

A. Problematika ende të pazgjidhura gjatë këtij viti kanë ngelur aparatet e defektuara për të cilat:

- Sugjerojmë vendosjen e sistemit të kondicionimit për të ruajtur mostrat në kushte optimale dhe ventilimit antizjarr në ambjentet e magazinimit të mostrave për largimin e avujve të krijuar nga qëndrimi i mostrave në këto ambiente. Në këto kushte bëjmë të mundur evitimin e probabilitetit të zjarrit të mundshëm nga avujt e këtyre karburanteve.
- Për limitimin e rrezikut të eksplozimit dhe kontaminimit të personelit është e domosdoshme vendosja e detektorëve për tejkalimin e përqëndrimit të nivelit të gazit dhe të avujve

hidrokarbure të dëmshëm për shëndetin e personelit dhe eliminimin e ndonjë zjarri të mundshëm, detektorë zjarri dhe sistem fikje zjarri të menjëhershëm, detektorë për rrjedhje gazesh si helium, oksigjen dhe gaz i lëngshëm etj. Mirëmbajtje të sistemit të ventilim - kondicionimit dhe rishikimi për shtesa dhe përshtatje e ventilimit në përputhje me kërkesat e kushteve të analizimit.

3. Objektiv në vazhdimësi mbetet blerja e aparateve të reja për shtimin e mëtejshëm të treguesve të analizuar, njohja dhe shfrytëzimi i literaturës së re, si dhe metodikave bashkëkohore, pjesëmarrja në seminare dhe trajnime të ndryshme të organizuara brenda dhe jashtë vendit nga institucione vendase apo specialistë të huaj.
4. Shërbimi i inspektimit të mirëmbajtjes, riparimit dhe kalibrimit, pasi është një procedurë e pashmangshme dhe e domosdoshme për Laboratorin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve dhe kriteri i domosdoshëm për mbajten e titullit "Laborator i Akredituar".
5. Pjesëmarrja e vazhdueshme në trajnime në rang kombëtar dhe ndërkombëtar, e cila ndikon në ngritjen profesionale të stafit dhe njohja e përshtatja me metodat e reja bashkëkohore.

2.2 Laboratori i Tekstilit

Gjatë vitit 2023 në Laboratorin e Tekstilit janë kryer analiza dhe janë realizuar disa objektiva si më poshtë:

Synimi kryesor i Laboratorit gjatë muajve të parë të këtij viti ka qenë, implementimi i metodikave të reja, trajnimi i personelit me qëllim rritjen e cilësisë në kryerjen e analizave dhe përcaktimeve laboratorike, si dhe futja e aparaturave të reja bashkëkohore në të ardhmen me qëllim rritjen e numrit të komponentëve të analizuar.

Për këtë periudhë pranë Laboratorit janë kryer kryesisht analiza detergjentësh të ndryshëm, solucione për larje dyshemeje, sapun likuid, larës rrobash, pastrues yndyrë, sapun rrobash, zbardhues, etj.

Stafi i këtij laboratorit gjatë kësaj periudhe janë angazhuar maksimalisht, për të përmirësuar performancën e këtij laboratorit, duke futur standarde të reja në fushën e tekstilit dhe detergjentëve.

Gjithashtu, gjatë këtij viti janë kryer trajnime "Njohja me kërkesat e standardit ISO/IEC 17025:2017, kërkesa të përgjithshme për kompetencën e laboratoreve testues dhe kalibrues"

Në disa raste një metodikë standardi mund të mos gjejë zbatim konkret, atëherë mund të përdoren metoda alternative të botuara në literaturë shkencore, ose të aplikuar nga laboratorë kimikë të fushës së prodhimit përkatës. Kjo e fundit rekomandohet dhe nga standardi S SH EN ISO/ IEC 17025: 2017 mbi "Akreditimin e Laboratorëve".

Implementimi i këtyre metodikave të reja sigurisht që kërkon plotësimin e Laboratorit me pajisje të reja. Kjo është një domosdoshmëri për të aplikuar metodikat dhe standardet bashkëkohore për të arritur një rezultat më të mirë. Pra sikurse e theksuam, zbatimi i metodikave të reja është i lidhur ngushtë me futjen e aparateve të reja, pa të cilat nuk mund të zbatohen këto metodika. Mungesa e fondeve ka qenë shkak i mosrealizimit të metodikave bashkëkohore.

Brenda kësaj periudhe bazuar në literaturën bashkëkohore u hartuan:

1. Lista e plotë me kërkesa për aparaturat me të domosdoshme si:

- a. Peshore teknike 0 deri 3200gr
- b. Peshore analitike 220gr,0.1mg,
- c. Titrator automatik me dy module,
- d. Aparat për matjen e opacitetit të letrës
- e. Aparat për testimin e përbërjes dhe identifikimin e fibrave,
- f. Aparat për përcaktimin e trashësisë së tekstileve dhe produkteve tekstile,
- g. Aparat për përcaktimin e ndryshimit të dimensioneve në larjen dhe tharjen,
- h. Aparat për përcaktimin e zgjatjes në forcën maksimale të tekstileve, duke përdorur metodën e shiritit,
- i. Aparat për përcaktimin e gjatësisë dhe gjerësisë së pëlhurave,
- j. Shkalla gri për vlerësimin e ndryshimit të ngjyrës.
- k. Testet e qëndrueshmërisë së ngjyrave të tekstileve,
- l. Aparat (Përzierës magnetik),
- m. Frigorifer ftohës për laborator.

2. Kërkesa për kimikate dhe enë laboratorike.

3. Kërkesa drejtuar Ministrisë së linjës për pajisjen e Laboratorit me aparatura dhe trajnim të stafit.

Gjithashtu në Laboratorin e Tekstilit janë analizuar për këtë periudhë gjithsej 73 analiza për palë të treta. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2022, kemi një rritje të testimit për produktet e detergjenteve dhe materiale tekstil.

DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË PAJISJEVE NËN PRESION
(DIPNP)

1. PËRMBAJTJA

- ❖ Kuadri ligjor mbi të cilin zhvillon aktivitetin inspektues D.I.P.N.P.
- ❖ Organizimi i D.I.P.N.P.
- ❖ Aktiviteti inspektues në operatorët ekonomik të cilët përdorin pajisje/instalime nën presion, në bazë të Planeve të Miratuara.
- ❖ Pasqyrat e aktivitetit për 4 mujorin e parë të vitit 2023 për çdo Sektor.
- ❖ Pasqyra krahasuese me të njëjtën periudhë të vitit 2022.

2. PËRMBLEDHJE

Më poshtë trajtohet veprimtaria inspektuese e D.I.P.N.P. për periudhën Janar-Dhjetor 2023, sipas organizimit në 3 Sektorë Rajonalë dhe zonave në përbërje të çdo Sektori, bazuar në Planet Mujore të inspektimit në operatorët ekonomikë, të cilët përdorin pajisje/instalime nën presion, si dhe në bazë të Programeve të Inspektimit të miratuar nga Kryeinspektori.

3. HYRJE

Drejtorja e Inspektimit të Pajisjeve Nën Presion është pjesë përbërëse e strukturës organizative të ISHTI-t, krijuar në zbatim të VKM Nr. 410, datë 13.05.2015 "Për Krijimin, Organizimin dhe Funksonimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial".

A. Misioni i DIPNP është shprehur në gërmën "c", pika 1, Kreu II, të VKM Nr. 410/2015, ku përcaktohet se: *"ISHTI është struktura përgjegjëse për inspektimin, për zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e sigurisë së punës së instalimeve nën presion, si një linjë teknologjike e përbërë nga enë, tubacione dhe aksesore sigurie dhe që shërbejnë për mbajtjen, trajtimin dhe shpërndarjen e fluideve, sipas legjislacionit për sigurinë e enëve nën presion"*

B. Detyrat e DIPNP janë përcaktuar në Nenin 16 "Detyrat e Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion", të Ligjit Nr.32 datë 24.03.2016 "Për Garantimin e Sigurisë së Punës së Pajisjeve dhe Instalimeve Nën Presion", ku citohet se: *është organi shtetëror, i specializuar për kontrollin e veprimtarisë në fushën e projektimit, prodhimit, montimit dhe shfrytëzimit të pajisjeve/instalimeve nën presion dhe ka për detyrë:*

1. Zbatimin e detyrimit të operatorëve ekonomikë, që pajisjet/instalimet nën presion, t'i nënshtrohen vlerësimit të konformitetit nga një organ i miratuar/notifikuar;
2. Kryen inspektime tek operatorët ekonomikë privatë ose entet publike që ushtrojnë veprimtari me pajisje/instalime nën presion, ku vlerëson nëse:
 - a. ushtrimi i aktivitetit që shfrytëzon pajisjet/instalimet nën presion, kryhet në përputhje me kërkesat e këtij ligji;

- b. miratimi për zhvillimin e aktivitetit që shfrytëzon pajisjet/instalimet nën presion është marrë në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 - c. është përgatitur dokumentacioni teknik i nevojshëm për vendosjen e pajisjeve dhe instalimeve nën presion;
 - d. instalimi dhe testimi i pajisjeve/instalimeve nën presion është bërë në përputhje me legjislacionin dhe aktet teknike në fuqi;
 - e. pajisja/instalimi nën presion është mirëmbajtur rregullisht gjatë funksionimit të saj dhe nëse ajo është e kontrolluar dhe testuar në përputhje me rregullat teknike në fuqi;
 - f. personat që përdorin pajisjet/instalimet nën presion dhe personat që punojnë në mirëmbajtjen e tyre plotësojnë kushtet e përcaktuara për këto veprimtari;
3. Mban evidenca të historikut të inspektimeve teknike, avarive të ndodhura, regjistrin të pajisjeve/instalimeve nën presion të përdorura nga subjektet përkatëse.

C. Fushat kryesore të inspektimit:

1. Instalimet nën presion, si dhe pajisjet që përdorin operatorët ekonomikë, të cilët janë licensuar për importimin, magazinimin dhe tregtimin me shumicë të Gazit të Lëngëzuar të Naftës (GLN).
2. Instalimet në operatorët ekonomikë që merren me mbushje, depozitim dhe tregim bombolash me pakicë.
3. Instalimet nën presion në Autogaze që shërbejnë për furnizimin e automjeteve.
4. Instalimet nën presion që përdoren për qëllime rezidenciale, social – kulturore, industriale, etj.

D. Kuadri ligjor mbi të cilin zhvillon aktivitetin inspektues D.I.P.N.P.

Për realizimin e detyrave të saj D.I.P.N.P. mbështetet në kuadrin ligjor si më poshtë:

1. Ligji Nr.10433 datë 16.06.2011 "Për Inspekimin në Republikën e Shqipërisë".
2. V.K.M. Nr. 410 datë 13.05.2015 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial".
3. Ligji Nr. 32 datë 24.03.2016 "Për Garantimin e Sigurisë së Punës së Paisjeve dhe instalimeve Nën Presion".
4. Ligji Nr.10480 datë 17.11.2011 "Për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve Jo Ushqimore" i ndryshuar.
5. Ligji Nr.10489 datë 15.12.2011 "Për Tregtimin dhe Mbikqyerjen e Tregut të Produkteve JoUshqimore" i ndryshuar.
6. V.K.M. Nr. 212 datë 16.03.2016 "Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me GLN".
7. V.K.M. Nr. 1062 datë 23.12.2015 Për miratimin e rregullit teknik "Për paisjet dhe bashkësitë nën presion" dhe përcaktimin e listës së standarteve të harmonizuara.
8. V.K.M. Nr. 1065 datë 23.12.2015 Për miratimin e rregullit teknik "Enët e thjeshta nën presion" dhe përcaktimin e listës së standarteve të harmonizuara.

9. Vendimi Nr. 430, datë 26.6.2019 Për miratimin e rregullit teknik "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve të transportueshme nën presion"
10. Rregulloren e Brendshme, miratuar me Urdhër Nr. 900, datë 21.12.2010 të Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
11. Rregulloreve teknike në fuqi si dhe udhëzimeve të brendshme të I.S.H.T.I-t.
12. Urdhrat dhe Programet e Inspektimit të Kryeinspektorit për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore për prodhimin, vlerësimin e konformitetit, instalimin, përdorimin dhe inspektimin teknik të pajisjeve/instalimeve nën presion.

E. Organizimi i D.I.P.N.P.

Aktiviteti inspektues i pajisjeve/instalimeve nën presion kryhet sipas organizimit mbi bazën e strukturës së miratuar konform Urdhrit të Kryeministrit Nr. 105 datë 13.08.2020 dhe përbëhet nga 25 inspektorë, të organizuar në 4 Sektor, përkatësisht:

- | | |
|---|-------------------------------|
| 1. Sektori Rajonit Qendror - Tiranë - Durrës - Elbasan - Korçë- | 1 Përgjegjës dhe 9 inspektorë |
| 2. Sektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër- | 1 Përgjegjës dhe 7 inspektorë |
| 3. Sektori Rajonit Jugor - Fier - Berat - Vlorë - Gjirokastrë- | 1 Përgjegjës dhe 7 inspektorë |
| 4. Sektori Mbikëqyrjes dhe Ekspertizës Teknike- | 1 Përgjegjës dhe 2 inspektorë |

3. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

Qëllimi i inspektimit të operatorëve ekonomikë, të cilët për nevoja të aktivitetit kanë instaluar duke vënë në përdorim pajisje/instalime nën presion është njohja e gjendjes teknike në lidhje me sigurinë e këtyre pajisjeve dhe garantimi i sigurisë, nëpërmjet plotësimit të detyrimeve që rrjedhin nga përcaktimet e Nenit 8 "Përgjegjësitë e Operatorit Ekonomik dhe punëmarrësit për shfrytëzimin e pajisjeve/instalimeve nën presion", të Ligjit Nr. 32 datë 24.03.2016, nga këta operatorët ekonomikë.

Duke marrë në konsideratë jo vetëm llojin e fluidit që mbajnë apo transportojnë, por edhe qëllimin, ndërtimin, strukturën, aksesorët e sigurisë dhe sidomos regjimin e punës në presion vazhdimisht e të larta, pajisjet/instalimet nën presion janë të një risku të lartë, ç'ka e bën të detyrueshëm inspektimin teknik periodik të përvitshëm nga Organet e Miratuara.

1. Aktiviteti i kryer

- a. **Aktiviteti i katërmujorit të parë i DIPNP** përfshin inspektimet e operatorëve ekonomikë, sipas planit të miratuar nga Kryeinspektori, nga Inspektorati Qendror, si dhe në pajisjet/instalimet nën presion që ata shfrytëzojnë.
 - Për muajin Janar 2023 si DIPNP kanë qënë të planifikuar për të kryer 228 inspektime në operatorë ekonomikë dhe 364 inspektime në pajisje/instalime nën presion, të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
 - i. **Sektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë** - 131 subjekte dhe 200 pajisje nën presion

- ii. *Sektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastrë* - 80 subjekte dhe 117 pajisje nën presion
 - iii. *Sektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër* - 35 subjekte dhe 47 pajisje nën presion
- Për muajin Shkurt 2023 si DIPNP kanë qënë të planifikuar për të kryer 272 inspektime në operatorë ekonomikë dhe 447 inspektime në pajisje/instalime nën presion, të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
- i. *Sektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë* - 171 subjekte dhe 221 pajisje nën presion
 - ii. *Sektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastrë* - 94 subjekte dhe 156 pajisje nën presion
 - iii. *Sektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër* - 51 subjekte dhe 70 pajisje nën presion
- Për muajin Mars 2023 si DIPNP kanë qënë të planifikuar për të kryer 283 inspektime në operatorë ekonomik dhe 439 inspektime në pajisje/instalime nën presion, të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
- i. *Sektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë* - 168 subjekte dhe 226 pajisje nën presion
 - ii. *Sektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastrë* - 85 subjekte dhe 158 pajisje nën presion
 - iii. *Sektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër* - 49 subjekte dhe 55 pajisje nën presion
- Për muajin Prill 2023 si DIPNP kanë qënë të planifikuar për të kryer 261 inspektime në operatorë ekonomikë dhe 545 inspektime në pajisje/instalime nën presion të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
- i. *Sektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë* - 172 subjekte dhe 315 pajisje nën presion
 - ii. *Sektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastrë* - 55 subjekte dhe 133 pajisje nën presion
 - iii. *Sektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër* - 46 subjekte dhe 97 pajisje nën presion

Përsa më sipër, për periudhën Janar-Prill janë planifikuar për t'u inspektuar 1057 subjekte dhe janë inspektuar 1137, janë planifikuar 1638 inspektime në PNP dhe janë realizuar 1795 inspektime në PNP.

Janë Inspektuar Jashtë Programit 56 Subjekte si më poshtë:

- i. *Sektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë* -50 subjekte
- ii. *Sektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastrë* - 0 subjekte
- iii. *Sektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër* - 6 subjekte

- ii. **Spektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastër** - 75 subjekte dhe 160 pajisje nën presion
 - iii. **Spektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër** - 39 subjekte dhe 60 pajisje nën presion
- Për muajin Qershor 2023 si DIPNP kanë qenë të planifikuar për të kryer 244 inspektime në operatorë ekonomikë dhe 478 inspektime në pajisje/instalime nën presion, të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
- i. **Spektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë** - 190 subjekte dhe 283 pajisje nën presion
 - ii. **Spektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastër** - 70 subjekte dhe 145 pajisje nën presion
 - iii. **Spektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër** -34 subjekte dhe 50 pajisje nën presion
- Për muajin Korrik 2023 si DIPNP kanë qenë të planifikuar për të kryer 211 inspektime në operatorë ekonomikë dhe 452 inspektime në pajisje/instalime nën presion, të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
- i. **Spektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë** - 96 subjekte dhe 234 pajisje nën presion
 - ii. **Spektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastër** - 76 subjekte dhe 138 pajisje nën presion
 - iii. **Spektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër** - 58 subjekte dhe 80 pajisje nën presion
- Për muajin Gusht 2023 si DIPNP kanë qenë të planifikuar për të kryer 163 inspektime në operatorë ekonomikë dhe 279 inspektime në pajisje/instalime nën presion, të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
- i. **Spektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë** - 50 subjekte dhe 84 pajisje nën presion
 - ii. **Spektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastër** - 84 subjekte dhe 126 pajisje nën presion
 - iii. **Spektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër** - 44 subjekte dhe 69 pajisje nën presion

Përsa më sipër, për periudhën Maj-Gusht 2023 janë planifikuar për t'u inspektuar 897 subjekte dhe janë inspektuar 981, janë planifikuar 1588 inspektime në PNP dhe janë realizuar 1681 inspektime në PNP.

Janë Inspektuar Jashtë Programit 33 Subjekte si më poshtë:

- i. **Spektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë** - 10 subjekte
- ii. **Spektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastër** - 9 subjekte
- iii. **Spektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër** - 14 subjekte

Janë Riinspektuar 11 Subjekte si më poshtë:

- i. **Sektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë -** 11 subjekte
- ii. **Sektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastrë -** 0 subjekte
- iii. **Sektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër -** 0 subjekte

Gjatë Periudhës Maj-Gusht 2023 janë mbajtur në total 821 Akte Inspektimi dhe 0 Akte Konstatimi:

- i. **Sektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë -** 341 Akte Inspektimi dhe 0 Akt Konstatime
- ii. **Sektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastrë -** 280 Akte Inspektimi dhe 0 Akt Konstatime
- iii. **Sektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër -** 200 Akte Inspektimi dhe 0 Akt Konstatime.

Janë inspektuar në total për periudhën Maj-Gusht 2023: 4 Shkolla, 6 Kopshte, 0 Çerdhe dhe 21 aty për aty si më poshtë:

- i. **Sektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë -** 1 Shkollë, 0 Kopshte, 0 Çerdhe dhe 11 aty për aty.
- ii. **Sektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastrë -** 1 Shkollë, 6 Kopshte, 0 Çerdhe dhe 9 aty për aty.
- iii. **Sektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër -** 2 Shkolla, 0 Kopshte, 0 Çerdhe dhe 1 aty për aty, etj.

Janë regjistruar në total 76 Pajisje të reja pranë Drejtorisë së D.I.P.N.P-së si më poshtë:

- i. **Sektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë -** 62 Pajisje të reja
- ii. **Sektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastrë -** 5 Pajisje të reja
- iii. **Sektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër -** 9 Pajisje të reja

Si dhe janë hequr e ndaluar 179 Pajisjet si më poshtë:

- i. **Sektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë -** 25 subjekte
- ii. **Sektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastrë -** 114 subjekte
- iii. **Sektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër -** 40 subjekte

Po për këtë periudhë janë zbatuar:

1. Urdhri Nr.2734 Prot, datë 06.04.2023 dhe Autorizimi Nr.2734/1 Prot, datë 06.04.2023 "Për Subjektet që Ushtrjnë Aktivitet në Fushën e Gazrave Teknik, të ndara sipas Kategorive Industrial dhe Mjeksor në të gjithë Territorin e Republikës së Shqipërisë".
2. Urdhri Nr.4328 Prot, datë 12.06.2023 dhe Autorizimi Nr.4328/1 Prot, datë 12.06.2023 "Për Kontrollin, Parandalimin dhe Marrja e Masave për Zbatimin e Ligjit, në Subjektet që Ushtrjnë Aktivitet në Vijën Bregdetare Shkodër - Ksamil, Golem-Qeret-Karpen-Spille-Divjakë dhe Sarandë-Ksamil-Palas", ku është kërkuar:

- I. Të informohen subjektet mbi detyrimet dhe kërkesat ligjore për zbatim. Të njihen konkretisht me bazën ligjore në fuqi dhe çdo informacion ose këshillim të nevojshëm.
- II. Identifikimi i Subjektit të shërbejë dhe si objekt inspektimi në vijim.
- III. Në rast të konstatimit të shkeljeve në flagrancë, nga inspektori të procedohet sipas kërkesave të Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", "Neni 27", "pika 2", gërma a" citojmë: pika 2: "Inspektimi mund të fillojë pa autorizimin, sipas pikës 1 të këtij neni, vetëm kur: a) "konstatohet në flagrancë nga inspektori shkelja e një kërkesë ligjore, brenda fushës së tij të inspektimit".
- c. **Aktiviteti i katërmujorit të tretë i DIPNP** përfshin inspektimet e operatorëve ekonomikë sipas planit të miratuar nga Kryeinspektori, nga Inspektorati Qendror, si dhe në pajisjet/instalimet nën presion që ata shfrytëzojnë.
- Për muajin Shtator 2023 si DIPNP kanë qenë të planifikuar për të kryer 207 inspektime në operatorë ekonomikë dhe 361 inspektime në pajisje/instalime nën presion, të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
 - i. **Spektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë** - 128 subjekte dhe 77 pajisje nën presion
 - ii. **Spektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastrë** - 66 subjekte dhe 127 pajisje nën presion
 - iii. **Spektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër** - 29 subjekte dhe 57 pajisje nën presion
 - Për muajin Tetor 2023 si DIPNP kanë qenë të planifikuar për të kryer 231 inspektime në operatorë ekonomikë dhe 437 inspektime në pajisje/instalime nën presion, të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
 - i. **Spektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë** - 117 subjekte dhe 168 pajisje nën presion
 - ii. **Spektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastrë** - 65 subjekte dhe 168 pajisje nën presion
 - iii. **Spektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër** - 57 subjekte dhe 101 pajisje nën presion
 - Për muajin Nëntor 2023 si DIPNP kanë qenë të planifikuar për të kryer 223 inspektime në operatorë ekonomikë dhe 434 inspektime në pajisje/instalime nën presion, të cilat janë realizuar sipas Sektorëve më poshtë:
 - i. **Spektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë** - 124 subjekte dhe 169 pajisje nën presion
 - ii. **Spektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastrë** - 72 subjekte dhe 191 pajisje nën presion
 - iii. **Spektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër** - 38 subjekte dhe 74 pajisje nën presion

- Për muajin Dhjetor 2023 si DIPNP kanë qenë të planifikuar për të kryer 219 inspektime në operatorë ekonomikë, të cilat do të realizohen sipas Sektorëve më poshtë:

- i. **Sektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë -** 125 subjekte
- ii. **Sektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastër -** 58 subjekte
- iii. **Sektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër -** 36 subjekte

Përsa më sipër, për periudhën Shtator-Dhjetor 2023 janë planifikuar për t'u inspektuar 890 subjekte dhe 1232 inspektime në PNP.

Janë Inspektuar Jashtë Programit 49 Subjekte si më poshtë:

- i. **Sektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë -** 10 subjekte
- ii. **Sektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastër -** 23 subjekte
- iii. **Sektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër -** 16 subjekte

Janë Riinspektuar 40 subjekte si më poshtë:

- i. **Sektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë -** 40 subjekte
- ii. **Sektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastër -** 0 subjekte
- iii. **Sektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër -** 0 subjekte

Gjatë Periudhës Shator-Dhjetor 2023 janë mbajtur në total 1811 Akte Inspektimi dhe 4 Akte Konstatimi:

- i. **Sektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë -** 476 Akte Inspektimi dhe 4 Akt Konstatime
- ii. **Sektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastër -** 828 Akte Inspektimi dhe 0 Akt Konstatime
- iii. **Sektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër -** 507 Akte Inspektimi dhe 0 Akt Konstatime.

Janë inspektuar në total për periudhën Shtator-Dhjetor 2023: 117 Shkolla, 41 Kopshte, 12 Çerdhe dhe 41 aty për aty si më poshtë:

- i. **Sektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë -** 7 Shkolla, 2 Kopshte, 0 Çerdhe dhe 8 aty për aty.
- ii. **Sektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastër -** 72 Shkolla, 31 Kopshte, 9 Çerdhe dhe 23 aty për aty.
- iii. **Sektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër -** 38 Shkolla, 8 Kopshte, 3 Çerdhe dhe 10 aty për aty,etj.

Janë regjistruar në total 100 Pajisje të reja pranë Drejtorisë së D.I.P.N.P-së si më poshtë:

- i. **Sektori Rajonit Qendror - Tiranë- Durrës - Elbasan - Korçë -** 54 Pajisje të reja
- ii. **Sektori Rajonit Jugor - Fier- Berat -Vlorë - Gjirokastër -** 26 Pajisje të reja
- iii. **Sektori Rajonit Verior - Lezhë - Shkodër - Kukës - Dibër -** 20 Pajisje të reja

Si dhe janë hequr e ndaluar 472 Pajisje si më poshtë:

- | | |
|--|--------------|
| i. Spektori Rajonit Qendror - Tiranë-- Durrës – Elbasan – Korçë - | 14 subjekte |
| ii. Spektori Rajonit Jugor - Fier-- Berat –Vlorë – Gjirokastër - | 336 subjekte |
| iii. Spektori Rajonit Verior - Lezhë – Shkodër – Kukës – Dibër - | 122 subjekte |

Përsa më sipër për periudhën Janar-Dhjetor 2023 janë Inspektuar 2816 Subjekte, 4708 Pajisje nën presion, 58 Riinspektime, 2568 Akt Inspektime, 9 Akt Konstatime, 139 Shkolla, 43 Kopshte, 16 Çerdhe, 103 Aty për aty, 263 PNP të reja, 109 Inspektime jashtë planit, 43 Riinspektime jashtë planit, 531 Pajisje të ndaluara dhe Çregjistruara.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 janë administruar dhe zgjidhur 11 Ankesa, si dhe është trajtuar 1 rast Aksidenti si pasojë e një avarie të ndodhur në Pajisjen nën Presion dhe 5 raste Aksidentesh për pasojë e një pakujdesie, si dhe rrjedhje GLN nga çarja e tubit.

Në zbatim të Autorizimeve mujore sipas ndarjes në zona e sektorë gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 janë mbajtur **9 Vendim Përfundimtare të Inspektimit** me shkelje për operatorët ekonomikë, që shfrytëzojnë pajisje/instalime nën presion, të cilët nuk kanë plotësuar detyrimet ligjore mbi dokumentacionin teknik e ligjor, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.32/2016 dhe Ligjit Nr. 10 433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” duke i penalizuar ata konkretisht:

• JANAR 2023

1. Ndaj Subjektit “**Alban Lika PF**”, me NIPT K62118503G, me adresë: Stacioni Zoteknik Xhafzotaj, Objekti me Nr. pasurie 14/7, Zk. 2574 Rrashbull, Durrës, janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore, të Ligjit Nr.10433 datë 16.06.2011, neni 54, subjekti pengon kryerjen e Inspektimit. Subjekti nuk pranon të vijë të paraqesë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe nuk lejohet asnjë përfaqësues të paraqesë dokumentacionin tekniko-ligjor. Kjo klasifikohet si kundravajtje administrative dhe parashikohet si dënim administrativ kryesor.

Përsa më sipër, ndaj Subjektit “Alban Lika PF”, në zbatim të Ligjit Nr. 10 433 datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, është mbajtur Vendimi Përfundimtar i Inspektimit datë 17.01.2023 Nr. ISHTI-DQ-2023-006083-5 duke e sanksionuar me gjobë në vlerën 100 000 (Njëqindmijë) lekë.

2. Ndaj Subjektit “**Krasniqi SA shpk**”, me NIPT K32627418M, me adresë: Shkozë Zk. 8516, Nr. Pasurie 1/50, Durrës, janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore, në zbatim të Nenit 7 pika 1, të Ligjit Nr. 32 datë 24.03.2016 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës së Paisjeve dhe Instalimeve Nën Presion”, ku citohet se: *para vënies në shfrytëzim, operatori ekonomik që ka në administrim apo pronësi pajisjen/instalimin nën presion, është i detyruar ta regjistrojë atë në librin e pajisjeve/instalimeve nën presion, pranë inspektoratit shtetëror përgjegjës.* Subjekti nuk ka bërë kërkesë për regjistrim pajisje nën presion. Kjo klasifikohet si kundravajtje administrative dhe parashikohet si dënim administrativ kryesor.

Përsa më sipër, ndaj Subjektit “Krasniqi SA shpk”, në zbatim të nenit 19 pika e, të Ligjit Nr.32 datë 24.03.2016 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës së Paisjeve dhe Instalimeve Nën Presion”, për shkelje të kërkesave të pikës 1 të nenit 7, si dhe të Ligjit Nr. 10 433 datë 16.06.2011 “Për

Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, është mbajtur Vendimi Përfundimtar i Inspektimit datë 25.01.2023 Nr. ISHTI-DQ-2023-000382-5 duke e sanksionuar me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë.

Subjektit i'u la detyrë që, brenda datës 24.02.2023 të plotësojë dokumentacionin tekniko-ligjor sipas dispozitave ligjore në fuqi.

3. Ndaj Subjektit “**Krasniqi SA shpk**”, me NIPT K32627418M, me adresë: Maminas, Zk.2585, Pasuria me Nr. 245/9, Durës, janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore, në zbatim të Nenit 7, pika 1, të Ligjit Nr. 32 datë 24.03.2016 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës së Pajisjeve dhe Instalimeve Nën Presion”, ku citohet se: *para vënies në shfrytëzim, operatori ekonomik, që ka në administrim apo pronësi pajisjen/instalimin nën presion, është i detyruar ta regjistrojë atë në librin e pajisjeve/instalimeve nën presion, pranë inspektoratit shtetëror përgjegjës.* Subjekti nuk ka bërë kërkesë për regjistrim pajisje nën presion. Kjo klasifikohet si kundravajtje administrative dhe parashikohet si dënim administrativ kryesor.

Përsa më sipër, ndaj Subjektit “Krasniqi Sa shpk”, në zbatim të nenit 19 pika e, të Ligjit Nr.32, datë 24.03.2016 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës së Paisjeve dhe Instalimeve Nën Presion”, për shkelje të kërkesave të pikës 1 të nenit 7, si dhe Ligjit Nr. 10 433 datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, është mbajtur Vendimi Përfundimtar i Inspektimit datë 25.01.2023 Nr. ISHTI-DQ-2023-000383-5 duke e sanksionuar me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë.

Subjektit i'u la detyrë që, brenda datës 24.02.2023 të plotësojë dokumentacionin tekniko-ligjor sipas dispozitave ligjore në fuqi.

4. Ndaj Subjektit “**Krasniqi SA shpk**”, me NIPT K32627418M, me adresë: Fshati Pjezë, Pasuria me Nr. 84/43, Zk. 2978, Durës, janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore, në zbatim të Nenit 7, pika 1, të Ligjit Nr. 32, datë 24.03.2016 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës së Pajisjeve dhe Instalimeve Nën Presion”, ku citohet se: *para vënies në shfrytëzim, operatori ekonomik, që ka në administrim apo pronësi pajisjen/instalimin nën presion, është i detyruar ta regjistrojë atë në librin e pajisjeve/instalimeve nën presion, pranë inspektoratit shtetëror përgjegjës.* Subjekti nuk ka bërë kërkesë për regjistrim pajisje nën presion. Kjo klasifikohet si kundravajtje administrative dhe parashikohet si dënim administrativ kryesor.

Përsa më sipër, ndaj Subjektit “Krasniqi SA shpk”, në zbatim të nenit 19, pika e, të Ligjit Nr.32 datë 24.03.2016 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës së Paisjeve dhe Instalimeve Nën Presion”, për shkelje të kërkesave të pikës 1, të nenit 7, si dhe Ligjit Nr. 10 433 datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, është mbajtur Vendimi Përfundimtar i Inspektimit datë 25.01.2023 Nr. ISHTI-DQ-2023-000384-5 duke e sanksionuar me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë.

Subjektit i'u la detyrë që, brenda datës 24.02.2023 të plotësojë dokumentacionin tekniko-ligjor sipas dispozitave ligjore në fuqi.

• PRILL 2023

1. Ndaj Subjektit "**Edmond Sallaku PF**", me NIPT K724130010, me adresë: Fshati Bërzhitë, Komuna Bërzhitë, Tiranë, janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore, të Ligjit Nr.32, datë 24.03.2016 "Për Garantimin e Sigurisë së Punës së Paisjeve dhe Instalimeve Nën Presion", Neni 4, pika 3, ku përcaktohet se: *Inspektorati shtetëror përgjegjës mbikëqyr zbatimin e këtij detyrimi nga operatorët ekonomikë përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin.* Neni 13, Pika 1 përcakton se: *Operatori ekonomik, që ka në pronësi apo administrim pajisjen/instalimin nën presion, është përgjegjës për kryerjen e inspektimeve apo kontroleve periodike e të veçanta të pajisjeve/instalimeve nën presion, për vlerësimin e konformitetit dhe përputhshmërisë me kërkesat thelbësore të sigurisë, sipas rregullit teknik përkatës. Pajisja/instalimi nën presion i nënshtrohet vlerësimit të konformitetit në mënyrë periodike dhe, në raste të veçanta, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe rregullit teknik përkatës.*

Përsa më sipër, Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion Tekniko-Ligjor të plotë, Vërtetimin e Përputhshmërisë së Projektit teknik, Inspektimin Teknik Periodik nga OMI. Kjo klasifikohet si kundravajtje administrative dhe parashikohet si dënim administrativ kryesor.

Për këto arsye, ndaj Subjektit "**Edmond Sallaku PF**", në zbatim të Ligjit Nr. 10 433 datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", është mbajtur Vendimi Përfundimtar i Inspektimit datë 11.04.2023, Nr. ISHTI-DQ-2023-001191-5 duke e sanksionuar me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë.

Subjektit i'u la detyrë të plotësojë dokumentacionin tekniko-ligjor, sipas dispozitave ligjore në fuqi, si dhe të paraqesë Vërtetimin e përputhshmërisë së projektit teknik të instalimit të pajisjes nën presion.

Në zbatim të Autorizimeve mujore sipas ndarjes në zona e sektorë gjatë periudhës **Maj-Gusht** 2023, nuk është mbajtur *asnjë Vendim Përfundimtar Inspektimi* me shkelje për operatorët ekonomik që shfrytëzojnë pajisje/instalime nën presion, të cilët nuk kanë plotësuar detyrimet ligjore mbi dokumentacionin teknik e ligjor, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.32/2016 dhe Ligjit Nr. 10 433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

• TETOR

1. Ndaj Subjektit "**TIRANA DUA GAZ shpk**", me NIPT L62227015C, me adresë: Rruga Vaqarr-Arbanë, Km.1, Zk.3712, Nr. Pas 21/38, Godinë Kati I parë, Tiranë, janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore, të Ligjit Nr. 32/2016 dt 24.03.2016, "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion", Neni 7 pika 1, ku citohet se: *Para vënies në shfrytëzim, operatori ekonomik, që ka në administrim apo pronësi pajisjen/instalimin nën presion, është i detyruar ta regjistrojë atë në librin e pajisjeve/instalimeve nën presion, pranë inspektoratit shtetëror përgjegjës.* Përsa më sipër, Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion Tekniko-Ligjor të plotë. Kjo klasifikohet si kundravajtje administrative dhe parashikohet si dënim administrativ kryesor.

Për këto arsye, ndaj Subjektit "**TIRANA DUA GAZ shpk**", në zbatim të Ligjit Nr. 32/2016, datë 24.03.2016, "Për garantimin e sigurisë së punës së paisjeve dhe instalimeve nën presion", Neni 7 pika 1, është mbajtur Vendimi Përfundimtar i Inspektimit, datë 02.10.2023, Nr. ISHTI-DQ-2023-005142-5 duke e sanksionuar me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë.

2. Ndaj Subjektit **Vjollca Subashi**, me NIPT M21518506P, me adresë: Rruga. Pavarsia, Pallati Emros, kati i parë, Plazh Durrës, janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore, të Ligjit Nr. 32/2016 dt 24.03.2016, “Për garantimin e sigurisë së punës së paisjeve dhe instalimeve nën presion”, Neni 4, pika 1, ku përcaktohet se: *Projektimi dhe shqyrtimi i projektit teknik të pajisjeve/instalimeve nën presion. Të gjitha pajisjet/instalimet nën presion prodhohen, montohen dhe vihen në shfrytëzim në përputhje me projektin teknik përkatës, të hartuar nga subjekte projektuese të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi, dhe procedurën përkatëse të montimit.* Kjo klasifikohet si kundravajtje administrative dhe parashikohet si dënim administrativ kryesor.

Për këto arsye, ndaj Subjektit “Vjollca Subashi”, në zbatim të Ligjit Nr. 32/2016 datë 24.03.2016, “Për garantimin e sigurisë së punës së paisjeve dhe instalimeve nën presion”, Neni 4 Pika1, është mbajtur Vendimi Përfundimtar i Inspektimit datë 18.10.2023 Nr. ISHTI-DQ-2023-005166-5 duke e sanksionuar me gjobë në vlerën 500 000 (pesëqindmijë).

3. Ndaj Subjektit “**Shkëlqim Osmani**” shpk, me NIPT L7190017D, me adresë: Rruga. Ali Demi, Godinë 1 katëshe, Nr.2, Tiranë, janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore, të Ligjit Nr.32/2016 datë 24.03.2016, “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion”, Neni 8, pika 6, ku përcaktohet se: *Operatori ekonomik ka përgjegjësi që, në çdo rast, përdorimi i pajisjeve/instalimeve nën presion të bëhet nga punëmarrës që ka përgatitje të dokumentuar me dëshmi aftësie, e cila lëshohet nga një organ i miratuar nga ministri, i akredituar për çertifikimin e personelit që kryen punë me pajisje/ instalime nën presion.* Kjo klasifikohet si kundravajtje administrative dhe parashikohet si dënim administrativ kryesor.

Për këto arsye, ndaj Subjektit “**Shkëlqim Osmani shpk**”, në zbatim të Ligjit Nr. 32/2016 datë 24.03.2016, “Për garantimin e sigurisë së punës së paisjeve dhe instalimeve nën presion”, Neni 8, pika 6, është mbajtur Vendimi Përfundimtar i Inspektimit datë 26.10.2023 Nr. ISHTI-DQ-2023-005242-5 duke e sanksionuar me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë.

● NËNTOR

1. Ndaj Subjektit “**Bujari Group shpk**”, me NIPT L71907003O, me adresë: Superstrada Laç-Fushë-Krujë, Km.4, ZK.1768, Mamurras janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore, të Ligjit Nr. 32/2016, datë 24.03.2016, “Për garantimin e sigurisë së punës së paisjeve dhe instalimeve nën presion”, Neni 4 pika 3, ku përcaktohet se: *Përpara fillimit të procedurës së montimit të pajisjes/instalimit nën presion, operatorët ekonomikë marrin masa për vlerësimin e konformitetit të tij, nga një organ i miratuar/notifikuar për vlerësimin e konformitetit, në përputhje me rregullat teknike përkatëse.* Kjo klasifikohet si kundravajtje administrative dhe parashikohet si dënim administrativ kryesor.

Për këto arsye, ndaj Subjektit “**Bujari Group shpk**” në zbatim të Ligjit Nr. 32/2016, datë 24.03.2016, “Për garantimin e sigurisë së punës së paisjeve dhe instalimeve nën presion”, Neni 4 pika 3, është mbajtur Vendimi Përfundimtar i Inspektimit datë 13.11.2023, Nr. ISHTI-DQ-2023-005720-5 duke e sanksionuar me gjobë në vlerën 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë.

Në mënyrë më të detajuar i gjithë aktiviteti i DIPNP sipas Sektorëve për periudhën Janar-dhjetor 2023, paraqitet në **Tabelën** bashkëlidhur.

PASQYRA E AKTIVITETIT Janar-Dhjetor 2023

Sektor	Inspektimi ne subjekte		Inspektimi te p.n.p.		Ri-Inspektimi sipas Planit	Akte te mbajtur			Subjekte te Reja				P.n.p. te reja	Inspektimi Jashite Planit	Ri-Inspektimi Jashite planit	Pufisje te ndaluar ose Cregjistruara
	Plan	Realizim	Plan	Realizim		Akt Inspektimi	Akt Konstatant	Shkolin	Kopsite	Çerfite	Ay per ay					
I	2	5	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	
SEKTORI TIRANE - DURRES - ELBASAN - KORÇE	1511	1512	2136	2329	58	1233	9	29	4	4	70	217	70	43	73	
SEKTORI FIER - BERAT - VLORE - GJROKASTER	828	822	1534	1619	0	828	0	72	31	9	23	26	23	0	336	
SEKTORI LEZHE - SHKODER - KUKES - DIBER	465	482	741	760	0	507	0	38	8	3	10	20	16	0	122	
Janar-Dhjetor	2804	2816	4411	4708	58	2568	9	139	43	16	103	263	109	43	531	

4 DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË PAJISJEVE, INSTALIMEVE ELEKTRIKE DHE
MAKINERIVE NGRITËSE
(DIPIEMN)

Gjatë këtij viti D.I.P.I.E.M.N. ka punuar për të realizuar detyrat e programuara sipas programeve të punës për periudhën Janar – Dhjetor 2023, referuar detyrimeve sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Në vijim struktura e kësaj analize i referohet dispozitave të Ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike”, i ndryshuar (Ligj sektorial për funksionimin e D.I.P.I.E.M.N.) dhe Ligjit Nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

I. Trajtimi i rasteve të aksidenteve

Gjatë vitit 2023 kanë ndodhur 10 (dhjetë) aksidente nga të cilat, 8 (tetë) aksidente janë shoqëruar me vdekje dhe 2 (dy) aksidente janë shoqëruar me plagosje. Krahasimisht me vitin paraardhës, gjatë vitit 2022 kanë ndodhur 11 (njëmbëdhjetë) aksidente, nga të cilët, 8 (tetë) aksidente janë shoqëruar me vdekje dhe 3 (tre) aksidente janë shoqëruar me plagosje. Më poshtë po bëjmë një klasifikim të aksidenteve që kanë ndodhur gjatë vitit 2023.

A. Rastet e aksidenteve që janë shoqëruar me vdekje të elektricistëve.

1. Në datën 16.03.2023, rreth orës 10⁰⁰, në lagjen Dracin, tek rruga Unaza Lindore, zonë kjo e Bashkisë Shkodër, ka vdekur nga goditja e rrymës elektrike të tensionit të lartë 6 kV, shtetasi Shpëtim Dekovi, vjeç 51, punonjës i Sektorit të Ndriçimit Rrugor, Drejtoria e Shërbimeve, Bashkia Shkodër, banor i Lagjes Xhabija, Shkodër. Paraditen e datës 16.03.2023 i aksidentuari Shpëtim Dekovi dhe kolegu i tij po punonin për të furnizuar me energji elektrike dy ndriçues të ndriçimit rrugor. Për instalimin e këtij rrjeti furnizues ata kanë përdorur një automjet me kosh. Gjatë tentativës për të kaluar kabllin e furnizimit me energji elektrike mes përcjellësave TL 6 kV dhe kabllove të fibrës optike duke qenë i hipur mbi kosh i aksidentuari Shpëtim Dekovi ka prekur në përcjellësin anësor të linjës elektrike 6 kV me trupin e tij. Në momentin e prekjës në pjesën rrymëpërcjellëse të linjës se fiderit nr. 8, viktimja Shpëtim Dekovi është goditur nga rryma elektrike e tensionit të lartë 6 kV dhe është rrëzuar në brendësi të koshit me pasojë vdekjen. Qarku i rrymës elektrike të tensionit të lartë është mbyllur në rrugën; përcjellës TL-trup i viktimës-këmbë-kosh metalik-konstruksionë metalike të automjetit-tokë.
Shkaku i vdekjes është **shkelja e rregullave të sigurimit teknik nga ana e të aksidentuarit lidhur me, ruajtjen e distancës së sigurisë (përfshirë 0.35 m) nga pjesët me tension deri në 15 kV.**

B. Rastet e aksidenteve që janë shoqëruar me plagosje të elektricistëve.

Nuk kemi raste të tilla.

C. Rastet e aksidenteve që janë shoqëruar me vdekje të qytetarëve në pajisje, impiante e instalime elektrike:

1. Në datën 21.03.2023, rreth orës 21⁰⁰, në banesën e saj, që ndodhet mjaft afër Njësisë Administrative Maminas, ka vdekur nga kontakti me rrymën e tensionit të ulët 220 volt, ndërkohë që po lahej në dush, shtetasja Ornela Shefqet Gjeçi (Koni), vjeç 45, me arsim të lartë.
Në kushtet e gjendjes së instalimit elektrik të brendshëm të banesës së të aksidentuarës Ornela Gjeçi (ky instalim ishte jashtë kushteve teknike), ky rast nuk është trajtuar me akt ekspertimi teknik. Shkaku i vdekjes është **përdorimi i instalimit elektrik të pasigurt (instalimi elektrik i banesës ishte jashtë kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit).**
2. Në datën 19.06.2023, rreth orës 14⁰⁵ në vendin e quajtur Vallto, Njësia Administrative Orikum, Bashkia Vlorë, është aksidentuar me pasojë vdekjen, nga goditja e rrymës elektrike të tensionit të lartë 10 kV, shtetasi Arbër Ferati, vjeç 35, banor i po kësaj zone. Gjatë procesit të korrjes me autokombanjë manovratori Arbër Ferati ka punuar në afërsi të linjës elektrike ajrore të fiderit nr 3 të N/stacionit 35/10 kV Radhimë. Në një moment autokombanja ka kapur me cepin e kabinës, kabllin ABC të linjës TU që furnizonte me energji elektrike një pompë uji të abonentes Hane Çapoj. Gjatë tentativë për heqjen kabllorë ABC të TU nga cepi i kabinës ku kishin ngecur, viktima Arbër Ferati ka kapur me dorën e majtë tek përcjellësi anësor i fazës "C" të linjës TL (10 kV) ndërkohë që, dorën e djathtë e ka pasur tek pjesa metalike e autokombanjës duke u goditur nga rryma elektrike e tensionit të lartë 10 kV me pasojë vdekjen. pasi është bërë pjesë e qarkut të shkarkimit të rrymës elektrike në tokë. Rruga e kalimit të rrymës është: Përcjellës linje 10 kV – dorë e majtë e viktimës - dorë e djathtë e viktimës – këmbë – autokombanjë-tokë.
Shkaku i vdekjes është **shkelja e rregullave të sigurimit teknik nga ana e të aksidentuarit lidhur me, ruajtjen e distancës së sigurisë (përfshirë 0.35 m) nga pjesët me tension deri në 15 kV.**
3. Në datën 23.07.2023, mbasdite, në oborrin e banesës e tij, që ndodhet në fshatin Resulaj, Selenicë, Bashkia Vlorë, ka vdekur nga kontakti me përcjellësin e rrymës elektrike të tensionit të ulët 220 volt, që u këput dhe ra në trupin e z. Eqerem Zekaj, vjeç 80, që ndodhej poshtë kësaj linje. Më pas, gjatë tentativës për të ndihmuar bashkëshortin që ndodhej nën tension, goditet nga rryma elektrike e TU 220 volt edhe bashkëshortja z.Mynyre Zekaj, vjeç 75, me pasojë vdekjen. Shkaku i vdekjes është **rrjeti elektrik i TU i pasigurt.**
4. Në datën 18.08.2023, paradite, tek lavazhi i z. Faik Hajdaraj, pranë rreth rrotullimit Çiflig, në bashkinë Dimal, ka vdekur nga goditja e rrymës e tensionit të ulët 220 volt, shtetasi Rohan Nuhu, vjeç 15, ndërkohë që po përdorte pompën e lavazhit.
Shkaku i vdekjes është **përdorimi i pajisjes së dëmtuar në një instalim elektrik të pasigurt (instalimi elektrik i lavazhit ishte pa tokëzim dhe pa salvavita).**

5. Në datën 24.08.2023, rreth orës 11⁰⁰, në oborrin e banesës së tij, në fshatin Miliska, Pukë, ka vdekur nga goditja e rrymës elektrike të tensioni të ulët 220 volt, shtetasi Viktor Shan Nika, vjeç 65, në pension, gjatë prekjes aksidentale tek pjesa e zhveshur e linjës TU që po instalonte (linjë me përcjellësa të xhuntuar dhe të paizoluar mirë të shtrirë në tokë dhe nën tension).
Shkaku i vdekjes është **kryerja e punimeve elektrike pa marrë masat teknike të parrezikshmërisë (punonte pa heqje të tensionit).**
6. Në datën 26.08.2023, rreth orës 01¹⁵, tek lokali "Orange Club" në qytetin Sarandë, është aksidentuar me pasojë vdekjen shtetasi Antonio Delilaj, vjeç 17, gjatë goditjes nga platforma ngritëse që bie poshtë, pasi shkëputet kavoja e saj nga vendi ku ishte fiksuar.
Shkaku i vdekjes është **përdorimi i pajisjes elektrike (platforma ngritëse) të pasigurt.**
7. Në datën 01.09.2023 rreth orës 20-21⁰⁰, në arën që është në pronësi të familjes Nasufi, poshtë kampatës së linjës TM 10 kV të fiderit 3B, N/Stacioni 35/10 kV Biçukas, traseja e të cilit kalon nëpër këtë arë, është aksidentuar me pasojë vdekjen nga prekja në tensionin 10 kV, shtetasi Ermando Nasufi, vjeç 31, me banim në fshatin Biçukas, Njësia Administrative Divjakë, Bashkia Lushnjë.
I aksidentuari Ermando Nasufi, në tentativë për të kthyer tubin prej alumini në një mënyrë të përshtatshme për ta bashkuar me tubacionin e vaditjes ka prekur me tubin prej alumini në përcjellësin anësor Al-Ç 35 mm² të linjës elektrike të këtij fideri. Në momentin e kontaktit të tubit të aluminit me linjën elektrike 10 kV, i aksidentuari Ermando Nasufi është goditur nga rryma elektrike e tensionit 10 kV, me pasojë vdekjen. Qarku i rrymës elektrike të tensionit të lartë është mbyllur në rrugën: faza "A" e linjës ajrore-tub alumini-duar të viktimës-këmbë-tokë. Shkaku i vdekjes është **shkelja e rregullave të sigurimit teknik nga ana e të aksidentuarit lidhur me, ruajtjen e distancës së sigurisë (përfshirë 0.35 m) nga pjesët me tension deri në 15 kV.**

D. Rastet e aksidenteve që janë shoqëruar me plagosje të qytetarëve në pajisje, impiante e instalime elektrike:

1. Në datën 24.04.2023, rreth orës 17⁴⁰, në rrugën e vjetër Rubik-Rrëshen, 2-3 km në dalje të Rubikut për Rrëshen, në afërsi të linjës elektrike ajrore L-23 110 kV Rubik. Repts, tek mbrojtëset metalike të rrugës auto është plagosur nga goditja e rrymës elektrike të tensionit të lartë 110 kV, shtetasi Jetnor Haxhiu, vjeç 35, banor i Njesisë Administrative Milot, Bashkia Kurbin. Rreth orës 17⁰⁰, të datës 24.04.2023, shtetasi Jetnor Haxhiu ka shkuar në afërsi të bregut të lumit Fan për të peshkuar me kallam peshkimi. Gjatë tentativës për të ngritur kallamin e peshkimit lart i aksidentuari ka prekur në përcjellësin anësor të linjës elektrike 110 kV. Në momentin e prekjes në pjesën rrymëpërcjellëse të linjës me anën e kallamit të peshkimit i aksidentuari Jetnor Haxhiu është goditur nga rryma elektrike e tensionit të lartë 110 kV dhe është rrëzuar në tokë me pasojë plagosjen, pasi është bërë pjesë e qarkut të rrymës elektrike të shkarkimit me hark një fazë e tensionit 110 kV e linjës ajrore me tokën. Qarku i rrymës elektrike të tensionit të lartë është mbyllur në rrugën:

përcjellës TL-kallam peshkimi -duar- barrierë metalike-trup i aksidentuarit-këmbë-tokë. Shkaku i plagosjes është shkelja e rregullave të sigurimit teknik nga ana e të aksidentuarit, lidhur me ruajtjen e distancës së sigurisë (përfshirë 0.6 m) nga pjesët me tension deri në 35 kV.

2. Në datën 17.07.2023, rreth orës 18^h në kasetën elektrike të hyrjes nr.2 të pallatit nr. 18, në rrugën "Irfan Tomini", Njësia Administrative nr.5, Bashkia Tiranë, është aksidentuar me pasojë plagosjen, nga goditja e rrymës elektrike të tensionit të ulët (TU) 0,4 kV, fëmija Selim Kotorri, vjeç 11, banor i po këtij pallati (kati i IV). Fëmija Selim Kotorri duke luajtur me top ka lëvizur kapakun metalik nga pozicioni dhe kasete elektrike është hapur. Në këtë moment ai ka tentuar të rivendos kapakun tek karkasa metalike e kasetës, në gjendjen e mëparshme. Në këtë tentativë i aksidentuari Selim Kotorri ka kapur me dorën e djathtë kapakun metalik dhe kur e ka afruar atë tek karkasa metalike e kasetës ka prekur tek përcjellësit e fazës "C", të kabllave duke shkaktuar kështu lidhje të shkurtër që është shoqëruar me hark elektrik. Fryrja e harkut elektrik ka shkaktuar djegien e fëmijës. Shkaku i plagosjes është shkelja e rregullave të sigurimit dhe shfrytëzimit teknik elektrik nga subjekti që administron rrjetin elektrik.

II. Konkluzione mbi shkaqet e ndodhjes së aksidenteve.

Trajtimi i aksidenteve dhe avarive që ndodhin në paisjet e instalimet elektrike, nga ana e D.I.P.I.E.M.N.-së realizohet në përputhje me nenin 10 të Ligjit nr. 8734 dt 01.02.2001 "Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike", i ndryshuar.

Për çdo rast aksidenti apo avarie, nga ana jonë njoftohet edhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë duke u dhënë edhe shkaqet e ndodhjes së tyre, menjëherë pasi kemi evidentuar mekanizmin e ngjarjes nëpërmjet inspektorëve tanë.

Për trajtimin e aksidenteve ne veprojmë sipas një procedurë shumëvjeçare duke përgatitur një dosje të ekspertimit teknik, që përmban aktin e ekspertimit teknik, të dhënat përkatëse, masat administrative (gjobë, propozime për largim nga puna ose ndjekje penale), të marra sipas përgjegjësive dhe masat parandaluese. Kjo praktikë është e nivelit që përdoret edhe nga organizma të tjerë që mbikëqyrin sigurinë elektrike sikurse është O.S.H.A. (Occupational Health and Safety Administration) në SH.B.A. Shkaqet e aksidenteve të vitit 2023 sipas problematikës janë:

A. Mos zbatimi i procedurave të punimit.

Mosvlerësimi i situatës anormale të parashikueshme, dhe për pasojë mosmarrja e masave tekniko-organizative, gjatë punimeve në terren rezulton përsëri mjaft problematike. Konkretisht për këtë shkak ka ndodhur aksidenti i datës 16.03.2023 me pasojë vdekjen e shtetasit Shpëtim Dekovi, punonjës i Sektorit të Ndriçimit Rrugor, Drejtoria e Shërbimeve, Bashkia Shkodër.

B. Kryerja e punimit elektrik nga persona të pakualifikuar.

Për këtë arsye ka ndodhur aksidenti i datës 24.08.2023, në fshatin Miliska, Pukë, me pasojë vdekjen e shtetasit Viktor Shan Nika.

C. Kryerja e punimeve në afërsi të linjave elektrike.

Për këtë arsye kanë ndodhur:

1. Aksidenti i datës 24.04.2023, afër linjës elektrike ajrore L-23 të TL 110 kV në rrugën e vjetër, Rubik-Rrëshen, me pasojë plagosjen e shtetasit Jetnor Haxhiu.
2. Aksidenti i datës 19.06.2023, afër linjës elektrike të tensionit të lartë 10 kV në Vallto, Njësia Administrative Oriku, Bashkia Vlorë, me pasojë vdekjen e shtetasit Arbër Ferati.
3. Aksidenti i datës 01.09.2023, afër linjës elektrike të tensionit të lartë 10 kV në Biçukas, Njësia Administrative Divjakë, Bashkia Lushnjë, me pasojë vdekjen e shtetasit Ermendo Nasufi.

D. Përdorimi i pajisjeve elektrike të pasigurta në instalime elektrike të pasigurta.

Për këtë arsye kanë ndodhur:

1. Aksidenti i datës 21.03.2023, në ambientet e banesës së shtetasës Ornela Shefqet Gjeçi (Koni), në Maminas, Durrës, me pasojë vdekjen e shtetasës Ornela Shefqet Gjeçi (Koni).
2. Aksidenti i datës 18.08.2023, tek lavazhi i z.Faik Hajdaraj, pranë rreth rrotullimit Çiflig, në Bashkinë Dimal, me pasojë vdekjen e shtetasit. (rrjeti i pa sigurtë, pajisje e dëmtuar).
3. Aksidenti i datës 26.08.2023, tek lokali "Orange Club" në qytetin Sarandë, me pasojë vdekjen e shtetasit Antonio Delilaj. (pajisja e pasigurt).

E. Rrjet elektrik i pasigurt.

Për këtë arsye kanë ndodhur:

1. Aksidenti i datës 17.07.2023, në kasetën elektrike të hyrjes nr.2 të pallatit nr. 18, në rrugën "Irfan Tomini", Njësia Administrative nr.5, Bashkia Tiranë, me pasojë plagosjen e fëmijës Selim Kotorri.
2. Aksidenti i datës 23.07.2023, në oborrin e banesës e tij, në fshatin Resulaj, Selenicë, Bashkia Vlorë, me pasojë vdekjen e bashkëshortëve Eqqerem dhe Mynyre Zekaj.

Masat administrative (Gjobat) në rastet e aksidenteve të ndodhura gjatë vitit 2023 janë sipas tabelës së mëposhtme.



Nr	Subjekti/Punonjësi	Adresa	Aksidenti	Gjobë (lekë)	Inspektori
1	HTM shpk	Shkodër, Lagjja Perash, Rr. Rrojej, nr.44	me vdekje i shtetasit Shpëtim Dekovi	50.000	Aleksandër Paci, Alfons Simoni
2	Ervis Berberi	Rr. Sami Frashëri, nr.33 Tiranë	me vdekje i shtetasit Shpëtim Dekovi	50.000	Aleksandër Paci, Alfons Simoni
3	Alb Tiefbau shpk	L.Qemal Stafa, Rr. Studenti, sheshi 2- Prilli, pall. Fishta, zk 8591 Shkodër	me vdekje i shtetasit Shpëtim Dekovi	100.000	Aleksandër Paci, Alfons Simoni

4	Vodafone Albania shpk	Autostrada Tr-Dr, Rruga Pavarësia, nr.61 Kashar Tiranë	me vdekje i shtetasit Shpëtim Dekovi	50.000	Aleksandër Paci, Alfons Simoni
5	I.B.C Telecom shpk	Rr. Marin Bicikemi, përballë katedrales, godina 4 katëshe, kati i parë nr.9 Shkodër	me vdekje i shtetasit Shpëtim Dekovi	50.000	Aleksandër Paci, Alfons Simoni
6	ITCOM shpk	L.Vasil Shanto, Bvl.Skenderbeg, pall.164 shk.1 Shkodër	me vdekje i shtetasit Shpëtim Dekovi	50.000	Aleksandër Paci, Alfons Simoni
7	One Albania sha	Tiranë Rr. Muhedin Llagami, Kompleksi Square 21	me vdekje i shtetasit Shpëtim Dekovi	50.000	Aleksandër Paci, Alfons Simoni
8	OSSH sha	Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd. nr. 88, H 1, Njësia adm nr.7, 1027	me vdekje i shtetasit Shpëtim Dekovi	50.000	Aleksandër Paci, Alfons Simoni
9	OSSH sha	Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd. Nr. 88, H 1 Njësia Adm nr.7, 1027	me vdekje i shtetasit Shpëtim Dekovi	50.000	Aleksandër Paci, Alfons Simoni
10	Dorel Dyrmishi	Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd. nr. 88, H 1 Njësia adm nr.7, 1027	me plagosje i shtetasit Selim Kotorri	50.000	Alfons Simoni
11	Drinald Balla	Lagja "Çlirimi", Rruga "Agim Prodani" ND 23, Lushnjë	me vdekje i shtetasit Ermendo Nasufi	50.000	Fuat Kushta
12	Andrea Shkoza	Lagja "Çlirimi", Rruga "Agim Prodani" ND 23, Lushnjë	me vdekje i shtetasit Ermendo Nasufi	30.000	Fuat Kushta
13	Josif Biti	Lagja "Çlirimi", Rruga "Agim Prodani" ND 23, Lushnjë	me vdekje i shtetasit Ermendo Nasufi	30.000	Fuat Kushta
14	Përparim Velo	Lagja "Çlirimi", Rruga "Agim Prodani" ND 23, Lushnjë	me vdekje i shtetasit Ermendo Nasufi	30.000	Fuat Kushta
Totali				690.000	

Një informacion përmblendhës dhe krahasues për aksidentet e ndodhura, si dhe masat administrative të vendosura gjatë vitit 2023 krahasuar me vitin 2022 jepet në tabelën e mëposhtme.

Viti	Aksidente								
	Gjithsej			Me vdekje			Me plagosje		
	Elektracist	Qytetar	Gjithsej	Elektracist	Qytetar	Gjithsej	Elektracist	Qytetar	Gjithsej
2022	1	10	11	0	8	8	1	2	3
2023	1	9	10	1	7	8	0	2	2

Viti	Gjëjat e vendosura në rastet e aksidenteve	
	Raste	Lekë
2022	17	1.550.000
2023	14	690.000



III. Inspektimet (Kontrollet teknike)


Një pjesë e rëndësishme e punës së D.I.P.I.E.M.N.-së, në zbatim të përcaktimeve ligjore është dhe kryerja e inspektimeve (kontrolleve teknike sikurse i përkufizon Ligji nr. 8734 datë 01.02.2001), nga ana e inspektorëve dhe grupe inspektorësh, sipas rëndësisë së pjesës së rrejtit që kontrollohet, nivelit të tensionit, rrezikshmërisë që paraqet, afateve të inspektimeve etj.

Natyrisht që, kjo detyrë zë dhe vëllimin më të madh të punës së inspektorëve dhe parashikohet edhe në programet e tyre të punës mujore. Inspektimet realizohen vetëm online. Gjatë inspektimeve plotësohen dokumentat si më poshtëlistuar:

1. Formulari i inspektimit
2. Proces-verbali i inspektimit
3. Vendimi përfundimtar i inspektimit.

Të gjitha këto me qëllimin e vetëm rritjen e nivelit të sigurisë së instalimeve dhe pajisjeve duke lënë detyra me afate konkrete për mënjanimin në kohë të rreziqeve deri në ndalim kur rreziku është akut dhe ka nevojë për ndërhyrje të menjëhershme. Vlerësimi i kryerjes me seriozitet të këtij procesi është me vlera, determinante për shkallën e sigurisë, mënjanimin në kohë të rreziqeve, që në fund të fundit jep dhe rezultantin e të gjithë punës në tërësi të çdo inspektori dhe të gjithë D.I.P.I.E.M.N.-së.

Për vitin 2023 janë realizuar 2197 inspektime, ndërkohë që, për vitin 2022 janë realizuar 1821 inspektime, ashtu sikurse vihet re, kemi një rritje të numrit të inspektimeve me 376 raste. Më poshtë gjendet i ilustruar Grafiku i inspektimeve për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.



Duhet pranuar se, nivelet e marrjes së vendimit për gjobë nga inspektorët ngelet për t'u trajtuar në kushtet e një numri jashtëzakonisht të madh të subjekteve që janë objekt inspektimi. Nëse do i referohemi dispozitave të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" do të ishte dënim kryesor "Paralajmërimi" i subjekteve të inspektuara, por nëse i referohemi dispozitave të Ligjit nr. 8734 datë 01.02.2001 "Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike", ku në nenin 14 të tij përcaktohen kompetencat e inspektorit përfshirë edhe gjobitjen e subjektit të inspektuar në rastin kur, shkeljet janë të atij niveli që kapërcen kriterin e proporcionalitetit. Nga ana jonë një kujdes dhe prioritet shumë më i madh do t'i jepet cilësisë së punës inspektuese dhe rritjes së monitorimit lidhur me inspektimet proaktive të bëra.

Gjobat e vendosura për vitin 2023 gjatë procesit të inspektimeve online janë sipas tabelës së mëposhtme.

Nr.	Subjekti/Personi	Adresa	Motivi i gjobës	Vlera (lekë)	Inspektori/ët
1	“Mon Cheri” sh.p.k	Tiranë	Mos realizim detyrash në afat	100,000	Airton Shkurtaj, Silvana Saraçini
2	“Royal Palace” sh.p.k	Shëngjin, Lezhë	Mos realizim detyrash në afat	50,000	Gentian Ndreu, Fuat Kushta
3	“Tanushaj 2012” sh.p.k.	Shëngjin, Lezhë	Mos realizim detyrash në afat	100,000	Gentian Ndreu, Fuat Kushta
4	“Kotica” sh.p.k.	Superstrada Laç-Lezhë	Mos realizim detyrash në afat	100,000	Gentian Ndreu, Fuat Kushta
5	“Cocja” sh.p.k.	Qyteti Shkodër	Mos realizim detyrash në afat	50,000	Gentian Ndreu, Fuat Kushta
6	“Nordî-1” sh.p.k.	Ashtë, Shkodër	Mos realizim detyrash në afat	50,000	Gentian Ndreu, Fuat Kushta
7	“Shehu-2006” sh.p.k.	Qyteti Lezhë	Mos realizim detyrash në afat	20,000	Gentian Ndreu, Fuat Kushta
8	NDRRIN Laundry & Textile shpk	Durrës Lagjia nr. 13, Rruga Pavarësia,	Mosrealizim detyrash në afat	100.0800	Taulant Saqe, Julian Çizmja
9	Riapi-05	Lagjia 8 Shkurti, Rr. Skënderbeu, Pallati nr. 9 AFE Konstruksion, Fier.	Mosrealizim detyrash në afat	50,000	Albes Çollaku, Amarildo Lamaj
10	Ascuja sh.p.k	Komuna Vaqarr, përballë Albatrans, Vaqarr, Tiranë	Mosrealizim detyrash në afat	50,000	Algin Xhaja, Vladimir Hiska
11	Alfred Sulaj pf	Tiranë, Kashar Rruga dytësore Tiranë – Durrës, km 9.	Mosrealizim detyrash në afat	50,000	Silvana Saracini, Alfons Simoni
12	Auto Manoku Servis shpk	Tiranë, Kashar, Yrshek, Rr. Nozllaku.	Mosrealizim detyrash në afat	50,000	Silvana Saracini, Alfons Simoni
13	Auto Manoku sha	Tiranë, Njësia Bashkiake nr-7, Rr. e Kavajës, Pallati-152.	Mosrealizim detyrash në afat	50,000	Silvana Saracini, Alfons Simoni
14	Ceko Cekodhima pf	Vlorë, Orikum, Fshati Radhimë, Godinë 1- katëshe tek Ura e Katorisë	Mosrealizim detyrash në afat	100,000	Albes Çollaku, Amarildo Lamaj
15	Viol 2019 shpk	Vlorë, Kati i parë, pallati Anakonda dhe Riviera, Rr. Murat Tërbaçi.	Mosrealizim detyrash në afat	100,000	Albes Çollaku, Amarildo Lamaj
16	Edmond Aliaj pf	Vlorë, Himarë, Dhërmi, Fshati Dhërmi, Rruga e Kampit, Lagjia Kamp.	Mosrealizim detyrash në afat	100,000	Albes Çollaku, Amarildo Lamaj
17	Shega Trans shpk	Durrës, Rrashbull Fshati Vrrinë, Godinë 1-katëshe, Zona Industriale	Mosrealizim detyrash në afat	200,000	Julian Cizmja, Taulant Saqe

18	REGINA GROUP	Vlorë, Rr. Murat Terbaçi, Lagjja Uji Ftohtë, Kulla Nr. 2.	Mosrealizim detyrash në afat	100.000	Albes Çollaku, Amarildo Lamaj
19	Hotel Bar Restorant Nimfa shpk	Vlorë, Rajoni, L. Uji Ftohtë	Mosrealizim detyrash në afat	100.000	Albes Çollaku, Amarildo Lamaj
20	ILFA	Vlorë Lagjja Pavarësia, Rr. Gjergj Araniti	Mosrealizim detyrash në afat	100.000	Albes Çollaku, Amarildo Lamaj
21	Kasim Çule pf	Vlorë, Orikum. Rr. Nacionale, Vlorë-Himarë, Fshati Radhimë.	Mosrealizim detyrash në afat	100.000	Albes Çollaku, Amarildo Lamaj
22	FREDI-A shpk	Tiranë, Njësia Bashkiake nr.11, Rruga e Durrësit, përballë ish-doganës.	Mosrealizim detyrash në afat	100.000	Silvana Saracini, Alfons Simoni
23	"FLORI"	Lezhë, Shënkoll, Lagjja "Prelaj", Rr."Sokol Olldashi".	Mosrealizim detyrash në afat	50.000	Gentian Ndreu, Auran Xhani
24	PASHK GJERGJI pi	Durrës, TAULANTIA Lagjja nr.1	Mosrealizim detyrash në afat	200.000	Silvana Saracini, Alfons Simoni
25	Tomaificio Bama shpk	Tiranë, Ish-Kombinati Tekstil	Mosrealizim detyrash në afat	100.000	Algin Xhaja, Vladimir Hiska
26	Xhevat Hallulli pf	Tiranë, Golem Karpen.	Mosrealizim detyrash në afat	100.000	Taulant Saqe, Julian Cizmja
27	Ved-ing (degë e shoqërisë së huaj)	Tiranë, Kamëz Mëzes, pas Spitalit Hygea	Mosrealizim detyrash në afat	100.000	Algin Xhaja, Vladimir Hiska
28	ASSEL TRONICS shpk	Durrës, Lagjja nr.14, Shkozet.	Mosrealizim detyrash në afat	200.000	Taulant Saqe, Julian Cizmja
29	Arben Mansaku pf	M. Mucò, Lagjja.6 Durrës	Mosrealizim detyrash në afat	100.000	Taulant Saqe, Redjan Ismailaj
30	H.S INERT shpk	Berat, Kucovë Kozare	Mosrealizim detyrash në afat	100.000	Albes Çollaku, Haris Ago, Erind Lika.
31	S. LOCI shpk	Tiranë, Rr. Konferenca e Pezës, Kombinat.	Mosrealizim detyrash në afat	50.000	Algin Xhaja, Vladimir Hiska
32	Fresh chicken Albania 2019 shpk	Fier, Fatos, Fshati Verbas	Mosrealizim detyrash në afat	100.000	Albes Çollaku, Haris Ago, Erind Lika.
33	7 Metalwood shpk	Korçë, Bulgarec Lumalas.	Mosrealizim detyrash në afat	100.000	Teki Abazi, Haris Ago
Total				2920.000	

Një informacion përmbledhës dhe krahasues për masat administrative të vendosura gjatë vitit 2023 krahasuar me vitin 2022 jepet në tabelën e mëposhtme.

Viti	Gjobat e vendosura në rastet e inspektimeve	
	Raste	Lekë
2022	17	1120.000
2023	33	2920.000

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është të harmonizohen veprimet dhe maksimalizohen efektet e nevojshme në pikat më të ndjeshme ku ka situata dhe faktorë që përbëjnë burim rreziku, të evitohen ato dhe kështu duke shmangur në kohë shkaqet shmangen pasojat.

B. Lidhur me zgjidhjen e kërkesave dhe ankesave:

Janë trajtuar kërkesat dhe ankesat e ardhura nga qytetarët si më poshtë:

1. Është trajtuar kërkesa për inspektim e z. Altin Dumishllari, lidhur me regjistrimin e platformës ngritëse për mallra, në Rrugën “Tre Krojet” Vaqarr, Tiranë, më datë 09.01.2023.
2. Është trajtuar kërkesa për inspektim e znj. Juliana Xhabafti, lidhur me regjistrimin e platformës ngritëse për mallra, në “Rruga e Serave”, fshati Picar, Vorë, më datë 02.02.2023.
3. Është trajtuar kërkesa për inspektim e z. Flogert Turja, lidhur me regjistrimin e platformës ngritëse për mallra, në Autostradën Tiranë-Durrës km.8, përballë City Park, Bërxullë, Tiranë, më datë 24.04.2023.
4. Është trajtuar kërkesa për inspektim e Gjykatës së Lartë, lidhur me zjarrin e rënë në ambientet e Gjykatës, Tiranë, ndodhur në datën 27.07.2023.
5. Është trajtuar kërkesa për inspektim e z. Erahd Shijaku, lidhur me dëmtimin e pajisjeve të fonisë, ndodhur më datë 24.06.2023, në rrugën “Pjetër Bogdani” tek ish Blloku, Tiranë.
6. Është trajtuar kërkesa për inspektim e z. Erion Kojku, lidhur me regjistrimin e platformës ngritëse për mallra, në Njësinë Administrative Kashar, në Zonën Kadastrale Nr. 2105, pasuria me nr. 83/18 dhe nr. 83/15, Tiranë, më datë 10.05.2023.

C. Lidhur me inspektimin e objekteve që janë djegur për shkak të zjarreve të rëna në to:

1. Është inspektuar objekti “Lokal” me pronar z. Arban Veli, në Jalë, fshati Vuno, Bashkia Himarë. Ngjarja ka ndodhur më datë 11.01.2023.
2. Është inspektuar objekti “Servis automjetesh” me pronar z. Fredi Pirra, fshati Saver, Lushnjë. Ngjarja ka ndodhur më datë 07.01.2023.
3. Është inspektuar objekti i subjektit “Deutschcolor”sh.a., me adresë: Autostrada Tiranë-Durrës km 19. Ngjarja ka ndodhur më datë 23.09.2023.
4. Është inspektuar objekti “Godinë banimi” 8KT dhe 10KT, pranë N.SH.R.A.K, rruga “Sali Butka” Tiranë. Ngjarja ka ndodhur më datë 14.09.2023.

D. Lidhur me regjistrimin e pajisjeve impianteve, instalimeve elektrike dhe makineritë ngritëse.

Për vitin 2023 kanë sjellë dokumentacionin për regjistrimin e pajisjeve, impianteve, instalimeve elektrike dhe makineritë ngritëse 753 subjekte. Në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi 781 subjekte.

VI. Objektivat në vazhdim

1. Unifikimi i veprimeve të inspektorëve lidhur me zbutjen e rrishtit elektrik në përputhje me parimin e proporcionalitetit.
2. Përmirësimi i formateve të inspektimit dhe harmonizimi me kërkesat e Inspektoratit Qendror.
3. Trajnim i inspektorëve lidhur me, unifikimin e interpretimit të fenomeneve dhe qëndrimeve ndaj rregullave e normave teknike në fuqi dhe më pas, nevoja e përafritit të tyre me normat dhe rregullat bashkohore europiane.
4. Vazhdimi i ecurisë së punës për krijimin e bazës së të dhënave për regjistrimin e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.

4 DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË
TYRE
4 (DINGN)

Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre ushtron kontroll mbi personat juridikë që ushtrojnë veprimtari të përpunimit, transportimit dhe tregtimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, si më poshtë listuar:

- Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, për Transportin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe Nënprodukteve të tyre", të ndryshuar;
- Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë;
- Ligji nr. 7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi".
- Vendim nr. 410, datë 13.05.2015 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial",
- VKM nr. 147, datë 21.3.2007 "Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diezel";
- VKM nr. 429, datë 26.06.2019 "Për cilësinë e lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim teknik civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)";
- VKM nr.970, datë 02.12.2015 Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj (ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.4.2017)
- VKM nr.491, datë 19.7.2017 Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre.
- Urdhër i Ministrit nr. 315, datë 24.08.2017 "Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj";
- Urdhër i Ministrit nr. 6, datë 09.01.2015 "Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse", i ndryshuar;
- Urdhër Nr. të Kryeministrit Nr 105, datë 13.08.2020 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", i ndryshuar
- Urdhër Nr. 288, datë 13.10.2020 Për miratimin e rregullores së brendshme "organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror teknik dhe Industrial".
- Urdhër Nr. 184 datë 5.7.2005 "Për miratimin e kushteve teknike dhe normave të projektimit për impjantet dhe instalimet që shërbejnë për transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të Tyre.

Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre (DINGN), është pjesë përbërëse e strukturës organizative e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), përgjegjëse për kontrollin e veprimtarisë së personave juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e saj në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës dhe gazit dhe nënprodukteve të tyre.

- ❖ Për kontrollin e zbatimit të normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve përkatëse nga personat juridik.
- ❖ Kontrollin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në Licencat përkatëse që u janë dhënë personave juridikë, përfshirë dhe kushtet teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe ruajtjen e mjedisit.
- ❖ Kontrollin e respektimit të standardeve për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj për t'u siguruar konsumatorëve produkte cilësore sipas standardeve në fuqi.

Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit Nr.105, datë 13.08.2020 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", i ndryshuar, Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre ka në përbërje të saj 34 punonjës dhe kryen veprimtarinë inspektuese në gjithë territorin e vendit tonë e ndarë në katër sektorë: Sektori i Mbikëqyrjes dhe Ekspertizës Teknike (3 punonjës), Sektori i Rajonit Qendror Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Korçë (12 punonjës), Sektori i Rajonit Jugor Fier, Vlorë, Berat, Gjirokastër (10 punonjës), Sektori i Rajonit Verior Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër (8 punonjës).

Më poshtë paraqitet veprimtaria e kryer për periudhën Janar - Dhjetor 2023 në mbështetje të programit vjetor të miratuar në bazë të metodologjisë së inspektimit periodik dhe vlerësimit të riskut.

I. Inspektime për kontrollet cilësore për respektimin e standardeve teknike të Naftës dhe Nënprodukteve të tyre.

Kontrolli cilësor i Naftës dhe nënprodukteve të tyre bëhet në zbatim të Urdhrit nr.6, datë 09.01.2015 të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI), sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), "Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse" i ndryshuar, nëpërmjet marrjes së mostrave, sipas Standardit Shtetëror në fuqi S SH EN ISO 3170 : 2005 dhe S SH EN ISO 3171 : 2002. VKM nr.147, datë 21.03.2007, "Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel"; VKM nr. 429, datë 26.6.2019, "Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)" dhe të metodikave të testimit të standardeve përkatëse në fuqi, të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimeve, në Laboratorin e Akredituar.

1. Inspektime në shoqëritë aksionere të Licencuara (sha)

Janë inspektuar subjektet e tregtimit me shumicë për kontroll cilësor dhe marrje mostra me tarifë për çdo 4- mujor, në vitin 2023 kanë ushtruar veprimtari 146 subjekte sha, Tabela 1(a)

Numri i subjekteve SHA sipas kategorive të produkteve dhe sipas sektorëve					
Sektori	Lloji A	Lloji B kateg. I/A	Lloji A categ. IV/A	Lloji C	Shuma
Sektori i rajonit qendror	33	22	54	2	111

Sektori i rajonit jugor	6	9	8	0	23
Sektori i rajonit verior	1	6	5	0	12
Shuma	40	37	67	2	146

Tabela 1. (a) Numri i subjekteve të tregtimit me shumicë të naftës dhe nënprodukteve të tyre të shpërndara sipas llojit kategorisë për vitin 2023.

Gjatë këtij viti kanë mbyllur veprimtarinë e tregtimit me shumicë në fushën hidrokarbure subjektet:

- "Enkein Oil" sha pajisur me licencë lloji A, kategoria II/A Benzinë dhe III/A Gazoil
- "G & O TRADING" sha pajisur me licencë lloji A, kategoria III/A Gazoil
- "Enkein Oil" sha pajisur me licencë lloji B, kategoria I/A Gaz i lëngshëm nga nafta (GLN)
- "ERG" sha pajisur me licencë lloji A, kategoria IV/A Vajra lubrifikante
- "INA DELTA" sha pajisur me licencë lloji A, kategoria IV/A vajra lubrifikante


Në 4-mujorin e dytë të vitin 2023 ka filluar aktivitetet të tregtimit me shumicë GLN-së shoqëria "Lufi" sha pajisur me licencë lloji B, kategoria I/A Gaz i lëngshëm nga nafta (GLN).

Është ushtruar kontroll për çdo katërmujor në gjithë depozitat e shoqërive të tregtimit me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre dhe janë marrë 556 mostra me tarifë sipas tabelës 1(b) të ndara sipas sektorëve dhe kategorive të produkteve.

Produkti Sektori	Produkti											Nr. i mostrave
	Gazoil	Benzine	Bitumi	GLN	Naftë Bruto	Vaj Lubrifikant	Mazut	Jet A-1	Gjysë m produkt	Graso	Benzine avioni	
1	84	43	11	75	3	158	3	9	0	7	3	396
2	12	2	9	36	18	24	9		3	0	0	113
3	9	5	0	18	0	15	0	0	0	0	0	47
Shuma	105	50	20	129	21	197	12	9	3	7	3	556

Tabela 1. (b) Numri i mostrave të marra me tarifë në shoqëritë aksionare për vitin 2023

Numri i mostrave të marra me tarifë në shoqëritë aksionare për vitin 2023



Grafiku 1: Numri i mostrave të marra me tarifë në shoqëritë aksionare për vitin 2023

Viti 2023	Të ardhura (lekë)
Planifikuar	32 000 000
Arkëtuar	35 560 000

Tabela 2. Të ardhura nga tarifata e marrjes së mostrave në subjektet e tregimit me shumicë për vitin 2023.

2. Inspektime në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar (shpk)


Janë inspektuar subjektet e tregimit me pakicë të karburanteve, për kontroll cilësor dhe marrje mostra me tarifë për vitin 2023.

Në tabelat 3 dhe 4 jepet mostërmarrja me tarifë në shpk dhe vlera e faturuar për vitin 2023 të ndara sipas sektorëve të DINGN.

Sektori	Produktet e tregimit			Numri i mostrave
	Gazoil	Benzinë	GLN	
1	514	484	390	1388
2	289	274	116	679
3	207	191	104	502
Shuma	1010	948	610	2569

Tabela 3. Numri i mostrave të marra me tarifë në shoqëritë e tregimit me pakicë për vitin 2023.

Numri i mostrave të marra me tarifë në shoqëritë e tregtimit me pakicë për vitin 2023



Grafiku 2: Numri i mostrave të marra me tarifë në shoqëritë e tregtimit me pakicë për vitin 2023

Viti 2022	Të ardhura (lekë)
Planifikuar	85 000 000
arkëtuar	88 260 000

Tabela 4. Të ardhura nga tarifët e marrjes së mostrave në subjektet e tregtimit me pakicë për vitin 2023

3. Kontrolli cilësor Para-zhdoganimit

Kontrolli cilësor parazhdoganimit kryhet në zbatim të Urdhrit të Ministrit nr. 6, datë 09.01.2015 “Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifët përkatëse”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.3492, dt.30.04.2015 për “Koordinimin ndër-institucional të procedurave standarde të kontrollit sasior, cilësor dhe fiskal të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj në Republikën e Shqipërisë”. Mostrat janë marrë për sasi të importit me mjet transportues anijet në терминаlet e vendit tonë, Porto Romano dhe PIA Vlorë, si dhe me Autoçisterna në pikat doganore toksore.

Gjatë këtij viti në terminalin e Shëngjinit nuk janë zhdoganuar Naftë dhe nënproduktet e tyre. Për rafineritë e naftës “R B H Beline” sha dhe “Al Global Oil” sha kontrolli cilësor është kryer në zbatim të Urdhërit të përbashkët ish METE dhe MF, nr. 4288 dhe 4267 datë 30.4.2010.

Në tabelat e mëposhtme jepen numri i mostrave sipas pikave doganore dhe sasi të produkteve të ndara sipas kategorive të mostruara për kontroll cilësor.

Sektori	Dogana	N Bruto	B	G	G-0,4%	JET-AI	BIO-Drezel + Dizel	Vaxhin Nstle	GLN	Sokra	Mazut	Btuna	Graso	Vaj Lubrif.	Te tjera	Nr. Totali mostrave PROGRESIVI
1	Porto Romano, Durres	1	116	29	0	11	61	0	134	0	2	0	1	215	6	576
	Tirane	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	633	0	636
	Rinas	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Elbasan	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	9	3	13
	Kapshtice	0	252	549	0	0	0	0	0	0	0	120	0	3	0	924
	Qafe Thane	0	12	0	0	0	0	0	0	0	0	24	0	0	0	36
	Shuma	1	380	578	0	11	61	0	134	0	26	121	4	860	9	2185
2	Berat, Lushnje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1
	Zharrëz (Dega Fier)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	20	0	20	12	52
	PIA Vlore	24	9	10	0	0	0	0	14	0	0	0	0	14	0	71
	KPTHN Ballsh	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Sarande	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
	Kafaje	0	72	180	0	0	0	0	1	0	0	2	0	18	0	273
	Shuma	25	81	190	0	0	0	0	15	0	0	22	0	53	12	398
3	Shengjin, Lezab	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Shkoder, Morine, Kukes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	0	3
	Shuma	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	0	3
TOTALI		26	461	768	0	11	61	0	149	0	26	143	4	916	21	2586

Tabela 5. Numri i mostrave të marra me tarifë për kontroll cilësor para-zhdoganim për vitin 2023 të shpërndara sipas sektoreve të DINGN.

Nr.	Lloji i produktit	Viti 2022			Viti 2023				
		Sasia e importuar (ton)	Sasia e prodhuar në vend	Shuma e sasive të zhdoganuara	Nr. i mostrave	Sasia e importuar (ton)	Sasia e prodhuar në vend	Shuma e sasive të zhdoganuara	Nr. i mostrave
1	Gazoil	863 137	-	863 137	702	987 550	-	987 550	768
2	Benzinë	94 753	-	94 753	329	74 495	-	74 495	461
3	Biodiezel (Pame)	3 999	-	3 999	-	-	-	-	-
4	Biodiezel + Diezel	145 318	-	145 318	44	163 610	-	163 610	61
5	GLN	341 429	-	341 429	201	335 963	-	335 963	149
6	Benzinë + Bioetanol	-	-	-	-	-	-	-	-
7	Lëndë djegëse (Mazut)	802	-	802	31	666	-	666	26
8	Naftë Bruto	-	567 639	567 639	39	-	522 787	522 787	26
9	Vaj lubrifikante	9 044	-	9 044	713	12 455	-	12 455	916
10	Bitum	-	28 985	28 985	15	-	49 240	49 240	143
11	JET A-1	55 153	-	55 153	167	71 456	-	71 456	11
13	Nenprodukte naftë nga rafineritë për eksport	-	26 237	26 237	27	-	49 766	30 996	9
13	Shuma	1 514 185	622 861	2 137 046	2269	1 616 195	621 791	2 267 986	2586

Tabela 6. Numri dhe sasia e produkteve në (ton) e mostrave të marra me tarifë për kontroll cilësor para-zhdoganim për vitin 2023.

Gjatë këtij viti 2023 janë tregtuar brenda vendit rreth 163 610 mijë ton (Gazoil +biodiezel), i cili është gazoil i përzier me esterin e metilit të acidit yndyror me koncentrim 0,8 - 3.3 %. Nuk është prodhuar bio-etanol.

Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, me qëllim rritjen e efektivitetit të kontrollit cilësor kryen inspektime për respektimin e standardeve shtetërore të nënprodukteve të naftës.

Karburantet që janë analizuar në këtë periudhë janë ato që tregtohen normalisht në territorin e vendit.

Për vitin 2023 ka rritje të zhdoganimit të produkteve hidrokarbure në sasinë 130 940 ton.

Viti	Sasia në ton e mostruar për kontroll cilësor parazhdoganimit
2022	2 137 046
2023	2 267 986

Tabela 7. Sasia në ton e mostruar për kontroll cilësor parazhdoganimit për vitet 2022 dhe 2023

Viti 2022	Të ardhura (lekë)
Planifikuar	45 000 000
arkëtuar	57 870 000

Tabela 8. Të ardhura nga tarifat e marrjes së mostrave para zhdoganimit për vitin 2023

Gjatë vitit 2023 kanë ushtuar veprimtari rafineritë e përpunimit të naftës bruto “Al Global Oil” sha UPN, Fier dhe “RBH Beline” sha në Elbasan, ndërsa rafineria e Përpunimit të naftës Ballsh dhe rafineria e naftës AM-OIL me adresë ish Uzina e Plasmasit, Lushnje nuk kanë ushtuar aktivitet të përpunimit naftës bruto.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2023 janë parashikuar 162,000,000 të ardhura nga kontrolli cilësor në subjektet e tregtimit me shumicë, me pakicë dhe parazhdoganimit.

Për këtë periudhë janë faturuar 181,698,000 lekë nga kontrolli cilësor në subjektet e tregtimit me shumicë, me pakicë dhe parazhdoganimit.

4. Inspektimi i subjekteve të tregimit me shumicë dhe pakicë për kontroll cilësor (Sondazhe)

Janë inspektuar subjektet të tregimit me shumicë dhe stacionet e karburanteve të shitjes me pakicë për kontroll cilësor (sondazh) për produktet e tregimit në depozitat dhe stacionet e shitjes së karburanteve.

Sektori \ Produkti	Sektori			Shuma
	1	2	3	
Gazeoil	327	53	89	469
Benzinë	165	40	33	238
GLN	3	1		4
Shuma				711

Tabela 9. Numri i mostrave për kontroll cilësor (sondazhe) në subjektet e tregimit me shumicë (sha) dhe në subjektet e tregimit me pakicë (shpk), stacione të shitjes së karburanteve për vitin 2023.



Grafiku 3: Mostrat për kontroll cilësor (sondazhe) në subjektet sha & shpk, 2023

5. Inspektimi i subjekteve që janë pjesë e tregut si Konsumator të Mëdhenj

Janë inspektuar subjektet Konsumatorë të Mëdhenj nga të cilët janë marrë mostra për kontroll cilësor për produktet që përdorin dhe dokumentacioni i furnizimit. Gjithsej janë analizuar 10 mostra për kontroll cilësor për vitin 2023.

Produkti	Numri mostrave
Gazoil	9
GLN	1
Shuma	10

Tabela 10. Numri i mostrave për kontroll cilësor të Konsumatorëve të Mëdhenj, për vitin 2023

6. Inspektimi i subjekteve për palë të tretë.

Janë inspektuar subjektet sipas kërkesave nga palët e treta ku janë marrë gjithsej 22 mostra për kontroll cilësor.

Produkti	Numri i mostrave
Gazoil	7
Benzinë	1
GLN	1
Naftë Bruto	8
Vajra Lubrifikante	2
Mazut	3
Shuma	22

Tabela 11. Numri i mostrave për kontroll cilësor për palë të tretë për vitin 2023

Në total për vitin 2023 janë marrë gjithsej 6454 mostra për kontroll cilësor.

7. Kontrollë të ushtruara në Rafineritë e naftës dhe në Impiantet e Përpunimit të nënprodukteve të naftës, sipas VKM nr.19, datë 14.01.2015 dhe VKM nr.755, datë 12.11.2014

Kontrollet cilësore janë kryer në bashkëpunim me përfaqësuesit e doganave në zbatim të Udhëzimit nr.3492, datë 30.04.2015 për "Kordinimin ndër-institucional të procedurave standarde të kontrollit sasior, cilësor dhe fiskal të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të Urdhrit nr.6, datë 09.01.2015 "Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifatat përkatëse", i ndryshuar;

Gjatë vitit 2023, krahas importit kanë ushtruar veprimtari Rafineria e përpunimit të naftës UPN, Fier dhe Rafineria e përpunimit naftës në Elbasan.

Zbatimi i standardeve cilësore të karburanteve S SH EN 228 : 2012 +A1 :2017 për benzinën, SH EN 590:2022 për gazoilin dhe SSH EN 589 :2009 për gazin e lëngët është në përputhje me teknologjinë e avancuar të motorëve, por edhe me objektivat e BE për emetimin e gazrave nga mjetet lëvizëse.

Metodat e marrjes së mostrave që zbatohen janë në përputhje me standardin S SH EN ISO 3170:2005 dhe S SH EN ISO 3171:2002 ndërsa kryerja e analizave është realizuar në laboratorin e këtij institucioni i cili funksionon sipas S SH ISO/IEC 17025 2017.

II. Ndërveprime me OMVK

Në zbatim të VKM nr. 491 datë. 19.07.2017 "Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nenprodukteve të tyre" dhe të Urdhrit të Ministrit nr.315, datë 24.08.2017 "Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregimit të naftës dhe nenprodukteve të saj", për periudhën Janar – Dhjetor 2023, jepen vërtetimet teknike të lëshuara nga OMVK e miratuara për subjektet e tregimit me shumicë dhe pakicë.

Sipas raportimeve rezulton se janë lëshuar gjithsej 1170 vërtetime Teknike, nga të cilat 162 vërtetime teknike në subjektet sha dhe 1008 vërtetime teknike në subjektet shpk:

1. OMVK Nr. OMI 011 SEISS APPROVAL ALBANIA shpk ka lëshuar 390 Vërtetime Teknike, nga të cilat 293 në subjektet Shpk dhe 97 në subjektet Sha.
2. OMVK Nr. OMI 013 NOA CONTROL shpk ka lëshuar 509 Vërtetime Teknike, nga të cilat 497 në subjektet Shpk dhe 12 në subjektet Sha.
3. OMVK Nr. OMI 009-R2 ERGI PINK shpk ka lëshuar 95 Vërtetime Teknike, nga të cilat 67 në subjektet Shpk dhe 28 në subjektet Sha.
4. OMVK Nr. OMI 024 ALCERT shpk ka lëshuar 32 Vërtetime Teknike, nga të cilat 25 në subjektet Shpk dhe 7 në subjektet Sha.
5. OMVK NR. (OMI 007) Ecit shpk ka lëshuar gjithsej 10 Vërtetime teknike, nga të cilat 5 në subjektet Shpk dhe 5 për subjektet Sha.
6. OMVK NR. (OMI 002) M.F.M shpk ka lëshuar gjithsej 22 Vërtetime teknike nga të cilat. 13 në subjektet Shpk dhe 9 për subjektet Sha.
7. OMVK NR. (OMI 014) AI - Inspektim shpk ka lëshuar gjithsej 109 Vërtetime teknike, nga të cilat 106 në subjektet Shpk dhe 3 për subjektet Sha.
8. OMVK NR. (OMI 008) Siguria Presion shpk ka lëshuar gjithsej 3 Vërtetime teknike, nga të cilat 2 në subjektet shpk dhe 1 për subjektet sha.

III. Inspektimet e kryera për periudhën Janar - Dhjetor 2023

Janë ushtruar inspektimet në subjektet e tregtimit me shumicë (sha) dhe subjektet e tregëtimit me pakicë (shpk), në zbatim të Ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të detyrave të ngarkuara sipas Ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar për:

1. Inspektime për kontrollet cilësore për respektimin e standardeve teknike të Naftës dhe Nënprodukteve të tyre,
2. Inspektime për zbatimin e kushteve të parashikuara në lejet apo autorizimet përkatëse që u janë dhënë personave juridik, në instalimet, impiantet dhe pajisjet e përdorura, në mënyrë që ato të zbatojnë normat teknike dhe masat mbrojtëse kundra zjarrit,
3. Inspektime për kontrollin e zbatimit të kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve përkatëse.

Të dhënat e mëposhtme janë marrë në bashkëpunim me Sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Sistemeve.

Numri i inspektimeve sipas programit dhe jashtë programit, Janar-Dhjetor 2023				
Muaji	Sekt. Tiranë- Durrës- Elbasan- Korcë	Sekt. Fier- Berat- Vlorë- Gjirokastër	Sekt. Lezhë- Shkodër- Kukës-Dibër	total
Janar	31	9	14	54
Shkurt	46	16	8	70
Mars	41	14	14	69
Prill	38	20	14	72
Maj	39	19	14	72
Qershor	27	19	20	66
Korrik	45	20	18	83
Gusht	22	10	6	38
Shtator	38	21	10	69
Tetor	44	14	3	61
Nëntor	45	19	15	79
Dhjetor	64	1	9	74
Total	480	182	145	807

1. Kërkesë për disa ndryshime në Vendimin Nr. 491, datë 19.7.2017 "Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre".
2. Kërkesë për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin Nr. 315, datë 24.08.2017, "Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj".
3. Kërkesë për disa shtesa dhe ndryshime të Urdhrit të Ministrit nr. 6, datë 09.01.2015 "Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifatat përkatëse", i ndryshuar;
4. DINGN në bashkëpunim me Sektorin e Laboratorit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve në Drejtorinë e Laboratorit Qendror ka përgatitur dokumentacionin teknik për miratimin e standardeve për vajrat lubrifikante dhe nënproduktet e tjera

VI. Problematika

Shfuqizimi i Urdhrit nr. 76, datë 18.03.2015, "Për procedurat dhe tarifatat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj" na ka vënë në vështirësi të madhe si institucion për mbledhjen e tarifave të kontrollit cilësor në subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e hidrokarbureve. Në këtë kuptim, ky institucion nuk ka të përcaktuar mekanizmat detyrues ligjore për vjeljen e tarifave për kontrollin periodik cilësor të naftës dhe nënprodukteve të saj.

Në Drejtorinë e DINGN ka Inspektorë të rinj për të cilët kërkohet ngritje të nivelit profesional. Zbatimi i ligjit organik nr. 8450/1999 të ndryshuar; ligji për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore kërkojnë angazhim nga të gjithë Inspektorët. Për inspektimet online është punuar me Inspektoratin Qendror për trajnimin e Inspektorëve, proces i cili duhet të vazhdojë gjatë vitit 2024 për ngritjen e nivelit profesional të Inspektorëve sipas kërkesave të ligjit.

Nuk është arritur të krijojmë ambiente pune për të gjithë sektorët e DINGN.

VII. Objektivat për vitin 2024

1. Rritja e nivelit të respektimit të cilësisë sipas standardeve dhe rregullave teknike për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre në tregun e brendshëm, nëpërmjet kontrolleve cilësore rutinë e të planifikuara në të gjithë subjektet e tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.
2. Rritja e nivelit të respektimit të cilësisë sipas standardeve dhe rregullave teknike për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre në subjektet Konsumatorë të mëdhenj dhe ato fundorë, nëpërmjet kontrolleve cilësore rutinë e të planifikuara në të gjithë subjektet që përdorin këto produkte.
3. Rritja e sigurisë së njerëzve duke përmirësuar normat dhe kushtet teknike në instalimet teknologjike të tregtimit naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.
4. Realizimi i të ardhurave nga shërbimi i kontrollit cilësor në sha dhe të gjithë subjekteve të cilat i nënshtrohen kërkesave të ligjit nr. 8450 dt. 24.02.1999, të ndryshuar.
5. Realizimi i kontrolleve për respektimin e kushteve sipas licencave të marra për të gjitha instalimet për depozitimin e tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, me pakicë dhe shumicë në shoqëritë e pajisura me Licencë Tregtimi.

DREJTORIA E SISTEMEVE TË GAZIFIKIMIT DHE IMPIANTEVE KOMBËTARE
(DSGIK)

I. PËRMBAJTJA

1. Kuadri ligjor mbi të cilin zhvillohet aktiviteti i DSGIK-^{se}
2. Organizimi i DSGIK-^{se}
3. Aktiviteti i DSGIK-^{se}

II. PËRMBLEDHJE

Analiza përmban veprimtarinë e DSGIK-^{se} për periudhën Janar – Dhjetor 2023 sipas organizimit në katër sektorë nga të cilët tre sektore janë rajonal dhe një sektor është i mbikqyrjes dhe ekspertizës teknike.

III. HYRJE

Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare është pjesë përbërëse e strukturës organizative të ISHTI-t, krijuar në zbatim të VKM Nr. 410, datë 13.05.2015 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksonimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”.

Misioni i saj është shprehur në V.K.M. nr. 410 datë. 13/05/2015, Kreu II “*Misioni dhe funksionet e ISHTI-së*” në Pikën 1 gërma “ç” thuhet se: “*ISHTI-ja është struktura përgjegjëse për inspektimin për zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e sigurisë së punës në veprimtarinë e sektorit të gazit natyror, përfshirë transmetimin, shpërndarjen, depozitimin, si dhe ndërtimin e operimin e infrastrukturës së gazit natyror, sipas legjislacionit të sektorit të gazit natyror*”.

Detyrat e DSGIK -^{se} janë përcaktuar në Nenin 100 “*Mbikëqyrja dhe inspektimi*” dhe Nenin 101 “*Inspektorati shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit*”, të Kreut VIII “*Inspektimi, Mbikëqyrja, Kundërvajtjet Administrative Dhe Sanksionet*”, të Ligjit Nr. 102/2015 “*Për Sektorin e Gazit Natyror*” Neni 100, i Ligjit nr. 102/2015 përcakton se: “*në përputhje me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, ministria ushtron funksionet e saj mbikëqyrëse, nëpërmjet strukturave të saj dhe inspektoratit shtetëror përgjegjës për gazin (DSGIK)*”.

Neni 101 përcakton se: “*Inspektorati shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit (DSGIK), kryen inspektimin e objekteve për transportin, depozitimin dhe shpërndarjen e gazit natyror, si dhe të objekteve të tjera të gazit, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe rregulloren përkatëse, të miratuar nga ministri.*”

Objekti i këtij inspektimi përfshin zbatimin e dispozitave të parashikuara në këtë ligj, akteve nënligjore, rregulloreve, rregullat, standardet, specifikimet teknike dhe normat e cilësisë, në lidhje me performancën e veprimtarive të gazit nga ana e subjekteve që kryejnë veprimtari gaz, subjekteve të sektorit publik dhe shfrytëzuesve të sistemit të gazit”.

Roli dhe përgjegjësit e inspektoratit shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit natyror si dhe të drejtat dhe detyrimet e inspektorit për inspektim janë të shprehura në Kreun VI dhe VII të VKM Nr. 573

datë. 3.10.2018 “Për miratimin e rregullave dhe të procedurave në ushtrimin e funksioneve mbikqyrëse në sektorin e gazit natyror të ministrisë përgjegjëse për energjinë”

Marrëdhëniet ndërmjet strukturës përgjegjëse, që mbulon aktivitetin e sektorit të gazit në ministri, dhe inspektoratit shtetëror përgjegjës për gazin janë përcaktuar me Urdhrin e Ministrit përgjegjës për energjinë Nr. 280 date 1.10.2020.

IV. FUSHAT E VEPRIMIT

Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare kryen inspektimin e objekteve për transportin, shpërndarjen dhe depozitimin e gazit natyror, si dhe të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar, por edhe të objekteve të tjera të gazit, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Objekti i inspektimeve teknike është zbatimi i dispozitave të parashikuara në ligjin nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, përka të bëjë me aspektet teknike të projektimit, ndërtimit dhe shfrytëzimit të instalimeve dhe pajisjeve që shërbejnë për transmetimin, shpërndarjen, depozitimin nëntokësor të gazit natyror, si dhe terminalet e gazit natyror të lëngëzuar, përka të bëjë me rregullat teknike përkatëse, në lidhje me performancën e veprimtarive të gazit nga ana e subjekteve që kryejnë veprimtari gazi, subjekteve të sektorit publik dhe shfrytëzuesve të sistemit të gazit.

Mbikëqyrja inspektuese përfshin edhe mbikëqyrjen e cilësisë së gazit natyror që shpërndahet për konsumatorët në zbatim të kërkesave të standarteve të cilësisë.

Në zbatim të dispozitave të ligjit 32/2016 dt.24.3.2016 “Për sigurinë e punës së paisjeve dhe instalimeve nën presion” DSGIK inspekton të gjithë operatorët ekonomik që merren me transmetimin, shpërndarjen dhe depozitimin nëntokësor të gazit natyror, pajisjet/ instalimet nën presion të tyre, në lidhje me dokumentacionin teknik e ligjor të shfrytëzimit të këtyre pajisjeve/instalimeve.

V. KUADRI LIGJOR MBI TË CILIN ZHVILLON AKTIVITETIN INSPEKTUES DSGIK e

të saj DSGIK mbështetet në kuadrin ligjor si më poshtë:

1. **Ligji Nr. 102/2015** “Për Sektorin e Gazit Natyror“ i ndryshuar,
2. **Ligji nr.10433, datë 16.06.2011** “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”
3. **Ligji 32/2016 datë 24.03.2016** “Për Garantimin e Sigurisë së Punës së Pajisjeve dhe instalimeve Nën Presion”
4. **VKM Nr. 410 datë 13.05.2015** “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”
5. **VKM nr. 573, datë 3.10.2018**, “Për miratimin e rregullave dhe të procedurave në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse në sektorin e gazit natyror të Ministrisë përgjegjëse për energjinë”.
6. **VKM nr. 551, datë 18.06.2015**, “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure”, të ndryshuar

7. **VKM Nr. 713 datë 25.08.2010** “Për përcaktimin e rregullave për kushtet e procedurat për dhënien e lejeve për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së sistemeve të Gazit Natyror
8. **VKM nr. 87, datë 14.02.2018**, “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”
9. **VKM Nr.696, datë 16.08.2013** “Për përcaktimin e procedrave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoriatit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-inspektimi”, për inspektimet online”
10. **Urdhri Ministrit Nr. 170 datë 8.6.2020** “Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes së kartës së identifikimit për inspektorin që kryen inspektim teknik në sektorin e gazit natyror”
11. **Urdhri Ministrit Nr. 184 datë 17.06.2020** “Për përcaktimin e rregullave për kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën e tyre për shkeljet në aktivitetet në sektorin e gazit natyror”
12. **Urdhri Ministrit Nr. 279 datë 01.10.2020** “Për përcaktimin e rregullave për ushtrimin e funksionit mbikqyrës të Ministrisë në aktivitetin e operatorëve të gazit natyror për koordinimin e operacioneve në terren”
13. **Urdhri Ministrit Nr. 280 datë 01.10.2020** “Për miratimin e formës dhe praktikave në marrëdhëniet ndërmjet strukturës përgjegjëse që mbulon aktivitetin e sektorit të gazit natyror në ministri dhe Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës për sektorin e gazit natyror”
14. **Urdhri Ministrit Nr. 281 datë 01.10.2020** “Për përcaktimin e rregullave për përmbajtjen e urdhërit të inspektimit të leshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) në rolin e Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës për sektorin e gazit natyror, për kryerjen e inspektimeve në objektet e transmetimit, shpërndarjes dhe depozitimit të gazit natyror, të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar si dhe të objekteve të tjera të gazit ”
15. **Paketa e 9 (nëntë) Vendimeve të Këshillit të Ministrave:** “Për miratimin e rregullave teknike e të kriterëve të sigurisë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të Gazit Natyror, të instalimeve të gazit natyror të lëngshëm, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”
16. **VKM nr. 104, datë 04.02.2015**, “Për miratimin e rregullave teknike e të kriterëve të sigurisë, *pjesa e dytë*, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”,
17. **VKM nr. 612, datë 27.10.2017**, “Për miratimin e rregullave teknike e të kriterëve të sigurisë, *pjesa e tretë*, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”,
18. **VKM nr. 663, datë 10.10.2019**, “Për miratimin e rregullave teknike e të kriterëve të sigurisë, *pjesa e katërt*, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”,
19. **VKM nr. 294, datë 14.04.2020**, “Për miratimin e rregullave teknike e të kriterëve të sigurisë, *pjesa e pestë*, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të

transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”,

20. **VKM nr. 857, datë 04.11.2020**, “Për miratimin e rregullave teknike e të kriterëve të sigurisë, *pjesa e gjashtë*, për kërkesat minimale të projektimit teknik, të ndërtimit dhe të operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, të hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte.”
21. **VKM nr. 659, datë 27.08.2020**, “Për miratimin e rregullave teknike e të kriterëve të sigurisë, *pjesa e shtatë*, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”,
22. **VKM nr. 678, datë 02.09.2020**, “Për miratimin e rregullave teknike e të kriterëve të sigurisë, *pjesa e tetë*, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”,
23. **VKM nr. 679, datë 02.09.2020**, “Për miratimin e rregullave teknike e të kriterëve të sigurisë, *pjesa e nëntë*, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”.

VI. ORGANIZIMI I DSGIK

Aktiviteti inspektues i operatorëve ekonomikë në lidhje me performancën e veprimtarive të transportit, shpërndarjes dhe depozitimit të gazit natyror, si dhe të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar, por edhe të objekteve të tjera të gazit, në sektorin publik dhe shfrytëzues, që përdorin pajisje/instalime nën presion kryhet sipas organizimit mbi bazën e strukturës së miratuar konform Urdhrit të Kryeministrit.

DSGIK përbëhet nga një staf prej 16 punonjësish të organizuar në katër sektor përkatësisht:

- ❖ Sektori i Rajonit Qendror Tiranë-Durrës-Elbasan-Korçë 1 Përg.Sektor - 3 inspektorë
- ❖ Sektori i Rajonit Jugor Fier-Vlorë-Berat-Gjirokastrë 1 Përg.Sektor - 3 inspektorë
- ❖ Sektori i Rajonit Verior Shkodër-Lezhë-Kukës-Dibër 1 Përg.Sektor - 3 inspektorë
- ❖ Sektori i Mbikqyrjes dhe Ekspertizës Teknike 1 Përg.Sektor - 2 inspektorë

VII. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

Qëllimi i inspektimit të operatorëve ekonomik ka të bëjë me performancën e veprimtarive të transportit, shpërndarjes dhe depozitimit të gazit natyror, si dhe të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar, por edhe të objekteve të tjera të gazit, në sektorin publik dhe shfrytëzues, njohja e gjendjes teknike në lidhje me sigurinë e pajisjeve/instalimeve dhe garantimi i sigurisë së punës së tyre.

Këta operatorë ekonomikë, për nevoja të aktivitetit kanë instaluar duke vënë në shfrytëzim pajisje/instalime nën presion.

Duke marrë në konsideratë jo vetëm llojin e fluidit që mbajnë apo transportojnë, por edhe qëllimin, ndërtimin, strukturën, aksesorët e sigurisë dhe sidomos regjimin e punës në presione vazhdimisht

të larta, pajisjet/instalimet nën presion janë të një risku të lartë ç'ka e bën të detyrueshëm inspektimin teknik periodik nga Organet e Miratuara.

Të gjitha inspektimet e operatoreve ekonomik në fushën e gazit natyror do të kryhen on-line me tabletë sipas Listës së Verifikimit të miratuar nga Inspektorati Qendror.

VIII. AKTIVITETI I KRYER

DSGIK si drejtori e krijuar rishtas vijon punën për njohjen e stafit me aktet ligjore dhe nënligjore, (ligji, VKM, Urdhra Ministri dhe Rregullat Teknike), të miratuara në vazhdimësi.

1. Këtij qëllimi i kanë shërbyer edhe trajnimet e inspektorëve të emëruar në këtë drejtori, sipas një Programi të veçantë trajnimi, pasi gjatë vitit 2023 në DSGIK ka patur emërime të reja, lëvizje të stafit brenda drejtorisë.
2. Me anë të shkresës Nr. 501 prot., datë 03.09.2020 Inspektorati Qendror ka dërguar pranë ISHTI-t Modulet e Trajnimit fillestar për Inspektorët, bazuar në Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë". Këto module sëbashku me bazën ligjore të nevojshme i'u janë shpërndanë inspektorëve në periudhë prove të emëruar në DSGIK gjatë vitit 2023. Në vijim të përgatitjes të inspektorëve, nga vetë drejtoria ka kryer disa trajnime të stafit për t'u paraprirë inspektimeve të parashikuara të kryheshin në muajt nëntor dhe dhjetor. Në zbatim të kërkesës së Inspektoratit Qendror dhe bazuar në Modulet e Trajnimit dhe bazën ligjore, DSGIK ka përgatitur 40 pyetje me 4 alternativa mbi të cilat është hartuar testi përfundimtar nga Inspektorati Qendror për këta inspektorë.
3. Në muajin Janar është kryer Vlerësimi i performancës së punës së çdo punonjësi për vitin 2022 bazuar në modelin e përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Juridike për vlerësimin e performancës së punonjësve, si dhe planifikimi i grafikut të lejeve vjetore.
4. Në zbatim të Urdhrit të Ministrit Nr. 281 "Për përcaktimin e rregullave për përmbajtjen e urdhrit të inspektimit të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) në rolin e Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës për sektorin e gazit natyror, për kryerjen e inspektimeve në objektet e transmetimit, shpërndarjes dhe depozitimit të gazit natyror, të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar, si dhe të objekteve të tjera të gazit" është punuar për formatimin e listë-verifikimit (Checklistës së Inspektimit), sipas kërkesave të ligjit për inspektimin dhe është bërë shtimi në sistemin e inspektimeve online e-inspektimi nga Inspektorati Qendror.
5. Referuar ligjit Nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror". Enti Rregullator i Energjisë (ERE) pajis me licencë operatorët ekonomikë, të cilët mund të kryejnë aktivitetet në fushën e shpërndarjes, transmetimit, tregtimit me shumicë dhe furnizimit me gaz natyror.
Bazuar në ligjin Nr. 102/2015, si dhe të akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij, ISHTI është struktura përgjegjëse për inspektimin e operatoreve në fushën e transmetimit, shpërndarjes, tregtimit, depozitimit, furnizimit, si dhe për ndërtimin e operimit e infrastrukturës së gazit natyror. Është krijuar databazë e operatoreve ekonomikë të licensuar nga ERE në fushën e operimit të gazit natyror dhe janë përgatitur programet e inspektimit për këta operatorë si më poshtë listuar:
 - a. Sipas njoftimit për inspektim Nr. 9729 Prot. datë 22.11.2023 dhe në zbatim të Autorizimeve të Inspektimit të Kryeinspektorit me Nr.10579 Prot., datë 14.12.2023 dhe

Nr.10727 Prot., datë 18.12.2023 u krye inspektimi në operatorin “Trans Adriatic Pipeline AG-Albania”, i cili kryen aktivitet në “Transmetimin e gazit natyror” sipas licencës TGN 19, në stacionin e matjes në Bilisht dhe në stacionin e kompresorëve në Seman, Fier. Inspektimi në stacionin e kompresorëve në Seman, Fier u krye më datë 20.12.2023 me çështjen e inspektimit Nr. ISHTI – DQ – 2023 – 006013. Inspektimi në stacionin e matjes në Bilisht u krye më datë 21.12.2023 me çështjen e inspektimit Nr. ISHTI – DQ – 2023 – 006012. Në fund të inspektimit rezultoi se, operatori kryen aktivitet të rregullt dhe nuk ka shkelje të kërkesave ligjore. Për këtë operator është bërë rregjistrimi i 77 pajisjeve nën presion, si dhe hapja e librave për pajisjet si me poshtë:

- i. Stacioni i matjes në Bilisht - 16 pajisje nën presion*
 - ii. Stacioni i kompresorëve në Seman - 43 pajisje nën presion*
 - iii. Tubacionet e gazsjellësit - 18 pajisje nën presion*
- b. Sipas njoftimit për inspektim Nr. 8883 Prot. datë 01.11.2023 dhe në zbatim të Autorizimit të Inspektimit të Kryeinspektorit Nr. 9131 Prot., datë 07.11.2023 u krye inspektimi në operatorin “ALBGAZ” sh.a. i cili është licensuar në fushën e “Shpërndarjes gazit natyror”, sipas licencës SHGN 17 dhe të “Transmetimit të gazit natyror”, sipas licencës TGN 17. Inspektimi u krye më datë 16.11.2023, sipas çështjes Nr. ISHTI – DQ – 2023 – 005579. Në fund të inspektimit rezultoi se, operatori nuk kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror. Gjithashtu, me anë të emailit zyrtar ardhur në ISHTI me datë 21.12.2023 operatori ekonomik vë në dijeni se, nuk kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror.
- c. Sipas njoftimit për inspektim Nr. 8323 Prot. datë 20.10.2023 dhe në zbatim të Autorizimit të Inspektimit të Kryeinspektorit Nr. 9130 Prot., datë 07.11.2023 u krye inspektimi në operatorin “GSA” sh.p.k. i cili është licensuar në fushën e “Tregtimit me shumicë të gazit natyror”, sipas licencës TGN 20 dhe të “Furnizimit me gaz natyror (shitje me pakicë)”, sipas licencës FGN 20. Inspektimi u krye më datë 09.11.2022 sipas çështjes Nr. ISHTI – DQ – 2023 – 005573. Në fund të inspektimit rezultoi se, operatori nuk kryen aktivitet. Me shkresën Nr. 025 Prot. datë 27.10.2023 protokolluar në ISHTI me Nr. 8323/1 Prot. datë 31.10.2023 operatori ekonomik vë në dijeni ISHTI-n se, nuk kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror.
- d. Sipas njoftimit për inspektim Nr. 8324 Prot. datë 20.10.2023 dhe në zbatim të Autorizimit të Inspektimit të Kryeinspektorit Nr. 9129 Prot., datë 07.11.2023 u krye inspektimi në operatorin “BALKGAZ” sh.p.k. i cili është licensuar në fushën e “Tregtimit me shumicë të gazit natyror”, sipas licencës TGN 18. Inspektimi u krye më datë 14.11.2023, sipas çështjes Nr. ISHTI – DQ – 2023 – 005576. Në fund të inspektimit rezultoi se, operatori nuk kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror. Me anë të emailit dërguar ISHTI, protokolluar me Nr. 8324/1 Prot. datë 13.11.2023 operatori ekonomik vë në dijeni ISHTI se, nuk kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror.
- e. Sipas njoftimit për inspektim Nr. 8884 Prot. dt. 01.11.2023 dhe në zbatim të Autorizimit të Inspektimit të Kryeinspektorit Nr. 9129 dt. 07.11.2023 u krye inspektimi në operatorin ekonomik “ALBPETROL” sh.a. i pajisur me licencë për “Furnizim me gaz natyror” FGN 21.

Inspektimi u krye më datë 23.11.2023, sipas çështjes Nr. ISHTI – DQ – 2023 – 005581. Me shkresën Nr. 9895 Prot. datë 23.11.2023 operatori ekonomik vë në dijeni ISHTI se, nuk kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror dhe nuk disponon asnjë aset, impiant apo pajisje nën presion për furnizim me gaz natyror. Në fund të inspektimit rezultoi se, operatori nuk kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror.

Operatori ekonomik “Phoenix Petroleum Gas” sh.a. i pajisur me licencat për “Tregtim me shumicë të gazit natyror” TGN 16K dhe “Furnizim me gaz natyror” FGN 16, me shkresën Nr. 001/12 Prot., datë 02.12.2022 të protokolluar në ISHTI me Nr. 9616/1 Prot., datë 05.12.2022 ka njoftuar se, operatori është me statusin “i pezulluar” dhe nuk kryen aktivitet. Në këto kushte, nuk mund të kryhej inspektim në sistemin e inspektimeve on-line. Nga verifikimet e kryera gjatë vitit 2023 subjekti vazhdon të jetë me statusin “i pezulluar”.

IX. TRAJNIME DHE OBJEKTIVA PËR VITIN 2024

Referuar **Urdhrit Nr. 280, datë 01.10.2020** “Për Miratimin e Formës dhe Praktikave në marrëdhëniet ndërmjet Strukturës Përgjegjëse, që mbulon aktivitetin e Sektorit të Gazit Natyror në Ministri, dhe Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës për Sektorin e Gazit Natyror”, VKM Nr. 573, datë 3.10.2018 “Për Miratimin e Rregullave dhe të Procedurave në Ushtrimin e Funksioneve Mbikëqyrëse në Sektorin e Gazit Natyror të Ministrisë Përgjegjëse për Energjinë”, duke parë persepektivën e madhe për t’u zhvilluar, rëndësinë strategjike dhe sigurinë në punë të pajisjeve/instalimeve nën presion që ka sektori i gazit natyror, si dhe detyrimin ligjor për përmbushjen me përgjegjësi të të gjithë detyrave funksionale, për vitin 2024 është e nevojshme të kryhen trajnime dhe specializime edhe në terren të stafit të kësaj drejtorie.

Me licensimin e operatorëve ekonomikë si persona juridikë, sipas Nenit 22, të ligjit Nr. 102/105 “Për sektorin e gazit Natyror”, të cilët kryejnë një veprimtari në sektorin e gazit natyror për: transmetim të gazit natyror, shpërndarje të gazit natyror, furnizim të gazit natyror, tregtim të gazit natyror, operim në hapësirat e depozitimit të gazit natyror, operim në impiantet e GNL-së, funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror, nga DSGIK:

1. Do të rritet bashkëpunimi me strukturën përgjegjëse që mbulon aktivitetin e sektorit të gazit natyror në ministri;
2. Do të hartohen programe të veçanta inspektimi për çdo operator ekonomik;
3. Do të punohet me plan inspektimi mujor për çdo inspektor dhe sektor;
4. Do të raportohet çdo muaj nga çdo sektor për situatën dhe realizimin e detyrave;
5. Do të bëhet analizë periodike për realizimin e detyrave të ngarkuara;
6. Do të bëhet vlerësimi i punës të çdo inspektori dhe përgjegjësi sektori çdo tre muaj dhe në fund të vitit;
7. Do të propozohen tek titullari masa administrative për çdo inspektor dhe përgjegjës sektori që ka mangësi dhe prapambetje të pajustificuar, konform procedurave përkatëse të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të ISHTI;
8. Do të ndiqen me prioritet ekzekutimi i të gjitha sanksioneve të mundshme të vendosura në çdo operator ekonomik.

Drejtoria e Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional është në varësi të Kryeinspektorit dhe përbëhet nga tre sektorë:

- a) Sektori i Koordinimit Ndërinstitucional
- b) Sektori i Marrëdhënieve me Publikun
- c) Sektori i Projekteve dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar

I. Objektivat kryesorë

1. Intensifikimi i bashkëpunimit të ISHTI-t me institucionet e tjera vendase, me qëllim harmonizimin e të gjitha aktiviteteve në funksion të një bashkërendimi sa më eficient dhe të një produkti cilësor të punës.
2. Informimi i Publikut në mënyrë të qartë dhe transparente në lidhje me aktivitetet, arritjet dhe ecurinë e ISHTI-t, në përputhje me strategjitë, të cilat synojnë të krijojnë dhe ruajnë imazhe publike.
3. Krijimi i bashkëpunimit, mbajtja e vazhdueshme e komunikimit me organizatat ndërkombëtare dhe institucionet homologe të huaja me qëllim, rritjen e kapaciteteve institucionale të ISHTI-t, në përputhje me standardet bashkëkohore dhe direktivat e BE.
4. Kërkimi dhe përthithja e projekteve të financuara nga grantet e donatorëve të huaj dhe zbatimi i tyre me qëllim rritjen e kapaciteteve teknike, logjistike dhe profesionale të ISHTI-t.

A. Sektori i Koordinimit Ndërinstitucional

Ky sektor duke synuar një eficiencë sa më të mirë të punës së ISHTI-t, kryen detyrat funksionale si më poshtë:

- a. Koordinon punën me drejtoritë e tjera teknike, për plotësimin e detyrave të caktuara në kohë dhe me cilësi.
- b. Koordinon punën për mbarëvajtjen e bashkëpunimit dhe marrëdhënieve dypalëshe me institucionet e tjera vendase.
- c. Përgjigjet për koordinimin, marrjen e informacionit dhe përgatitjen e materialeve raportuese.
- d. Është përgjegjës për respektimin e afateve për mbledhjen dhe dërgimin e kërkesave dhe përgjigjeve zyrtare nëpërmjet Platformës së AMS dhe SQDNE, të cilat kanë si synim kalimin e të gjitha shërbimeve online.

Gjatë vitit 2023 janë koordinuar programet e punës me drejtoritë e tjera teknike të ISHTI-t, janë kryer takime brenda dhe jashtë institucionit, për evidentimin e fushave të veprimtarive të përbashkëta, është bashkëpunuar me Sektorin e Projekteve dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, për evidentimin e planeve dhe ideve për përfshirje më të gjerë të ISHTI-t në projekte, aktivitete, evente kombëtare dhe ndërkombëtare.

B. Administrimi dhe mirëmbajtja e faqes zyrtare të ISHTIT-it (info@ishti.gov.al)

Administrohen të gjitha e-mailet në faqen zyrtare të institucionit. Kërkesat, ankesat e informacionet e dërguara në adresë zyrtare elektronike të institucionit përcillen, sipas

përkatësisë dhe ndiqet kthimi i përgjigjes për trajtimin e rasteve. Kërkesat hidhen në një tabelë si më poshtë, ku jepen të dhënat e subjektit dhe drejtoria përkatëse që i është përcjellë kërkesa.

C. Raportimi i masave administrative të institucionit

Sektori i Koordinimit Ndërinstitucional raporton në mënyrë periodike për Kryeministrinë, në lidhje me masat administrative të vendosura nga institucionit, si dhe raportim mbi kontrollet që do të ushtrohen në të gjithë vendin dhe numrin e inspektimeve, që realizohen sipas qarqeve apo rajoneve, tipologjitë e subjekteve që kontrollohen krahas raportimeve periodike mujore dhe gjobave të vendosura. Për periudhën (janar- dhjetor 2023) janë raportuar 52 masa administrative të vendosura nga ISHTI.

D. Sistemi i Menaxhimit të Aplikimeve (AMS) dhe Sistemi i Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik

ISHTI nëpërmjet Sektorit të Koordinimit Ndërinstitucional bën të mundur që, të gjitha shkresat të nënshkruhen brenda afatit ligjor, si dhe raporton lidhur me mbarëvajtjen e dy platformave AMS/SQDNE në bashkëpunim me AKSH-in. Ky sektor raporton një herë në javë rastet e aplikimeve me/pa vonesë në MIE.

Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE) është sistemi i cili do të bëjë të mundur komunikimin dhe shkëmbimin e dokumenteve shoqëruese të kërkuara ndërmjet institucioneve për ofrimin e shërbimit/aplikimit.

Ky sistem ka për objektiv përcaktimin e procedurave dhe të afateve të shkëmbimit të dokumenteve ndërmjet institucioneve, nëpërmjet Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik, me qëllim ofrimin e shërbimit/aplikimit të qytetarit apo të biznesit.

E. Regjistri i Kërkesave

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron çdo tre muaj, në përputhje me nenin 8, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim LDI), zbatimin e detyrimit për mbajtjen dhe përditësimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve nga koordinatorët e të drejtës për informim pranë autoritetit publik.

Regjistri është në përputhje me formatin e miratuar me Urdhër të Komisionerit dhe përmban të gjitha elementët e përcaktuar në lidhjen nr. 1, të këtij urdhri. Përmbajtja e përgjigjes anonimizohet sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen zyrtare të ISHTI-it, përkatësisht në programin e transparencës, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat/mjediset e ISHTI-it.

Për periudhën (Janar-Dhjetor 2023) janë raportuar 1152 kërkesa, të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të ISHTI-it.

F. Procedura e Shkëmbimit të Dokumenteve

Nëpunësi i administratës publike ka detyrimin të sigurojë dokumentacionin shoqërues për ofrimin e shërbimit të kërkuar nga qytetari apo institucioni kërkuar nëpërmjet SQDNE-së.

Detyrimi i nëpunësit të administratës publike, për mundësimin e dokumenteve në SQDNE nis në momentin e marrjes së kërkesës për dokumentacionin shoqërues nëpërmjet SQDNE-së. Shkëmbimi i dokumenteve dhe komunikimi ndërmjet institucioneve kryhet vetëm nëpërmjet SQDNE-së, në të cilin ka akses personi përgjegjës i caktuar në ndjekjen e procesit. Aksesimi në sistem i personit përgjegjës bëhet nëpërmjet kredencialeve personale duke bërë të mundur identifikimin e tij në sistemin SQDNE, sipas legjislacionit që rregullon identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara. Dokumentet e hedhura në SQDNE nga personi përgjegjës janë të ngarkuara në këtë sistem sipas formatit të zyrtarizuar, janë të nënshkruara elektronikisht apo të pajisura me vulë elektronike, në varësi të dokumentit. Dokumentet, të cilat janë të ngarkuara në SQDNE dhe rezultojnë si të përfunduara kanë vlerë të njëjtë me dokumentet e lëshuara hard-copy nga institucioni.

G. Portali “Pyet shtetin”

Portali “Pyet shtetin” është një platform online, e cila ka për qëllim të ndihmojë qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit, për të patur një akses më të madh dhe për të gjetur më me lehtësi informacionin me karakter publik. Portali synon gjithashtu të lehtësojë procedurat e dërgimit të kërkesave për informim ndaj çdo autoriteti publik përgjegjës, si dhe të ankesave në rast refuzimi të informacionit të kërkuar pranë Komisionierit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale. Përmes shfrytëzimit të këtij portali, çdo qytetar apo dhe çdo grup interesi mund të dërgojë në mënyrë të thjeshtë elektronike kërkesat apo ankesat në rast refuzimi. Gjatë periudhës (Janar-Dhjetor 2023) për portalin “ Pyet shtetin”.al kanë ardhur 3 kerkesa/ankesa.

H. Programi i Transparencës

Në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, është përgatitur programi i transparencës për Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial. Ky program prezanton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit të sipërcituar. Ky program vlerësohet si mënyrë konkrete përmes së cilës, Autoriteti Publik (këtej e tutje ISHTI), ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e ligjit Për të Drejtën e Informimit. Autoriteti Publik do të përditësojë herëpashere Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2, të nenit 5 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor përbërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike, si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin. Informacioni i publikuar sipas skemës përditësohet sa herë ndryshon.

I. Sektori Informimit Publik

Sektori i Informimit Publik është përgjegjës për informimin e publikut, ndërlidhjen e medias me drejtoritë përkatëse, menaxhimin e rrjeteve sociale, si edhe realizimin e video promovuese. Koordinimin e marrëdhënieve me median e shkruar dhe atë audiovizive me drejtoritë përkatëse për dhënien e informacionit, përditësimin e faqes së internetit dhe reagimeve në rrjeteve sociale, në lidhje me aktivitetin e ISHTI-t. Koordinimin e punës dhe kujdesin për shpërndarjen e informacioneve të nevojshme elektronike, apo lëshimit të aksesit mbi to për punonjësit e

caktuar nga Drejtori i Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional. Gjatë kësaj periudhës Janar – Dhjetor 2023 janë kryer detyrat si më poshtë:

1. Është përgatitur informacioni në lidhje me aktivitetet e institucionit, të cilat janë me interes për punonjësit dhe publikun, që është publikuar rregullisht në rrjetet sociale.

Viti 2023	Facebook	Instagram	Tëitter
(Janar-Dhjetor 2023)	1070	264	40

2. Është përditësuar informacioni në faqen zyrtare të internetit ISHTI-t www.ishti.gov.al.
3. Janë mbajtur kontakte dhe është komunikuar në lidhje me informacionin zyrtar për aktivitetet e ISHTI-t me media të ndryshme.
4. Janë kryer takime me drejtoritë teknike dhe institucionet eprore për hartimin e ideve të bashkëpunimit në fushën e Informimit Publik.

J. Sektori i Projekteve dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar

Ky sektor është përgjegjës për koordinimin e marrëdhënieve të ISHTI-t me të gjithë aktorët ndërkombëtarë, institucionet e huaja homologe dhe grupet e interesit, koordinimin e punës me donatorët për projektet/programet dhe ndihmës së huaj për të cilat ISHTI është përfitues, koordinimin e punës me drejtoritë teknike për realizimin në kohë të këtyre detyrave.

ISHTI është duke punuar me komitetin teknik të transportit të mallrave të rrezikshme (TDG TC) duke zhvilluar dy takime në Beograd dhe në vazhdim, për të gjetur ekspert nga vende të ndryshme të rajonit të cilët sigurojnë bashkëpunim me institucionin tonë.

Synojmë të zgjerojmë serinë e takimeve të grupeve të reklamave të transportit të TDG, në baza mujore. Këto veprime zbatohen për shkak të politikës së transportit të mallrave të rrezikshme. Ne përfitojmë nga mundësia për të promovuar institucionin tonë.

Në bazë të bashkëpunimit tonë në TDG, jemi duke përgatitur draft-in fillestar mbi fushatën e sigurisë, që prek e-inspektimet, dhe gjetjet e organeve përforcuese të ligjit, në terren.

ISHTI ka qenë pjesëmarrës edhe në takimin teknik, për rajonin e Ballkanit perëndimor me BE-ne. Vlerësojmë së tepërmi, përpjekjet efektive për të kryer *tour de table* (diskutime në tryezë), të cilat priten nga pjesëmarrësit rajonal, duke përfshirë edhe palën shqiptare për të përditësuar:

- a. Kërkim për evidentimin e organizatave ndërkombëtare të rëndësishme, me të cilat duhet të krijohet bashkëpunim.
- b. Kërkim për evidentimin e zyrave homologe të vendeve të rajonit dhe vendet fqinje për bashkëpunim.
- c. Hartim i drafteve të MoU dhe evidentimin e pikave të bashkëpunimit me zyrat homologe.
- d. Kërkim dhe hartim i listës së donatorëve për sigurimin e granteve për financimin e projekteve.
- e. Regjistrim si aplikant në portalin e TAIEX Organ i Komisionit Evropian për suport, në lidhje me organizimin e seminareve (workshopeve), përfitimit të asistencës teknike dhe vizitave të punës (study visits) në inspektoratet homologe të vendeve të BE.

- f. Përgatitjen e Roadmap-it për lëvizjen e lirë të mallrave nga antarët e GNPIE të kapitullit 1 “Lëvizja e lirë e mallrave”. Roadmap-i i lëvizjes së lirë të mallrave është dokumenti më i rëndësishëm për kapitullin 1. Ky dokument pasi të finalizohet, do të ndahet me shërbimet e Komisionit Europian, çka e shton edhe më shumë detyrimin për hartimin e tij në cilësinë e duhur. Veçanërisht në këtë periudhë është përcaktimi i afateve kohore konkrete për harmonizimin dhe masat zbatuese në dokument dhe në planin e veprimit. Kërkesat e akteve europiane mbi Pajisjet nën presion dhe Enët e thjeshta nën presion (respektivisht Directive 2014/68/EU on pressure equipment(PED) dhe Directive 2014/29 on simple pressure vessels (SPVD).
- g. Trajnimet mbështetëse nga projekti SANECA/GIZ në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) dhe zbatohet nga College of Europe.
- h. Pjesëmarrja në Webinarin të ASPA "Fundamental of the EU legal & institutional System & overview of the legal enlargement process (Part 1).
- i. Pjesëmarrja në Webinarin të ASPA “Sistemi i menaxhimit të aplikimeve (AMS) dhe Sistemi i Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik (SQDNE)”, në të cilën u diskutua rreth shfaqjes së të dhënave të aplikimeve, delegimi i aplikimeve si dhe trajtimi i tyre etj.
- j. Trajnimet për ecurinë e shërbimeve on-line, si dhe ndjekja e gjithë procesit duke asistuar nga identifikimi i 7-shërbimeve online deri në akseset për Sistemin e Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrimin Elektronik dhe AMS.
- k. Takime me drejtoritë teknike të ISHTI-t, për të diskutuar në lidhje me funksionet e secilit sektor dhe evidentimin e nevojave për zhvillimin e tyre dhe vijimësinë e punës së mëparshme.

K. Nevojat për realizimin e projekteve

1. Sigurimin e automjeteve për kryerjen e inspektimeve.
2. Sigurimin e pajisjeve (kiteve) të inspektorëve gjatë kryerjes së inspektimit.
3. Përmirësimin e kushteve dhe mjeteve laboratorike në Laboratorin Qendror të ISHTI-t.
4. Instalimi i një monitori qendror në institucion i lidhur në mënyrë dixhitale me procesin e inspektimit online.
5. Trajnimin e stafit të laboratorëve, inspektorëve dhe sektorëve të tjerë të ISHTI-t.
6. Dixhitalizimi i arkivës së ISHTI-t.
7. Sigurimi i automjeteve që përmbajnë laborator të inkorporuar në mënyrë që të kryhet analiza e produktit në vend gjë që siguron transparencë dhe shpejtësi të rezultateve të inspektimit.

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE (DCJ)

Në kuadër të detyrave funksionale të përcaktuara në VKM-në nr. 410, datë 13.05.2015, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, Urdhrit e Kryeministrit 105, datë 13.08.2020, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, i ndryshuar dhe në Urdhrit nr. 288, datë 13.10.2020, “Për miratimin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, po ju paraqesim informacionin e detajuar mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Çështjeve Juridike për periudhën janar – dhjetor 2024.

Në analizën vjetore ku do të pasqyrohet puna dhe aktiviteti i bërë nga Drejtoria e Çështjeve Juridike, në lidhje me proceset gjyqësore, për të cilat ISHTI është në cilësinë e të paditurit ose të palës së tretë, theksojmë se është bërë një punë e mirë në drejtim të përfaqësimit ligjor duke garantuar maksimalisht nivelin e mbrojtjes nëpërmjet provave dhe qëndrimeve të mbajtura nga ana jonë.

Në vijim po analizojmë disa nga treguesit më kryesorë të aktivitetit të Drejtorisë së Çështjeve Juridike. Një ndër prioritetet kryesore ka qenë ndjekja e proceseve gjyqësore, ku në periudhën janar- dhjetor 2023 janë regjistruar pranë gjykatave Administrative por edhe të rretheve, për të cilat ISHTI, ka qenë në cilësinë e të paditurit, ose të personit të tretë.

Gjendja gjyqësore e çështjeve të ndjekura pranë Gjykatës nga Sektori i Ankimimeve për periudhën janar – dhjetor 2023 është sa më poshtë vijon:

Gjatë vitit 2023 janë ndjekur gjithsej 27 çështje në total, nga të cilat 9 dosje i perkasin periudhës 2016 – 2022, ndërsa 18 çështje kanë filluar gjatë vitit 2023.

1. Janë rëzuar **2 kërkesë padi** të paraqitura pranë Gjykatave Administrative dhe ato të Rrethit.
2. Janë pushuar **3 kërkesë padi** e paraqitur pranë Gjykatës Administrative.
3. Janë pranuar **4 kërkesë padi**, të cilat janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe Gjykatën e Apelit Tiranë, ndërkohë për 2 të tjera pritet vendimi. (Në këtë pikë cilësojmë se, vendimmarrja e trupave gjyqësore në jo pak raste është arbitrare pasi, shumë prej vendimeve që marrin formë të prerë nga Gjykata e Apelit kthehen në favorin tonë)
4. Janë aktualisht në proces ndjekje 20 çështje.

Gjithsesi, përveç kësaj problematike ka pasur edhe faktorë të tjerë, që kanë pasur një peshë jo të vogël për raportimin e numrave kaq të ulët, siç janë:

1. Është rritur ndjeshmëria e zbatimit dhe njohjes së ligjit, si nga ana e subjekteve, po ashtu edhe nga ana e inspektorëve, të cilët në vazhdimësi kanë ndërmarrë fushata informuese në terren.
2. Kalimi nga inspektimi manual në inspektim online ka rritur transparencën, si dhe efijencën e procesit të inspektimit, duke e bërë këtë procedurë më pak të kontestueshme.

Vazhdojmë të konstatojmë që, sikurse një vit më parë edhe gjatë vitit 2023, një nga shkaqet kryesore të vendimeve të dhëna kundër ISHTI –t ka ardhur si rezultat i parashkrimit të masave administrative të dhëna në vitet e mëparshme dhe që kanë qenë në pamundësi ekzekutimi nga ana jonë, për shkak se kanë

qenë në procese gjyqësore, çka e bën të pamundur ekzekutimin e tyre, pavarësisht ndjekjes me prioritet për vjeljen e tyre nga Sektori Ankimimeve.

Gjithashtu është konstatuar edhe gjatë këtij viti sikurse një vit me parë se, nga ana e trupës gjyqësore janë marrë shpeshherë vendime arbitrare, sidomos në ato raste ku vendimet kanë qenë të paankimueshme për shkak të vlerës së objektit të padisë. Njëkohësisht gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore janë ngritur problematika të ndryshme lidhur me procedurën inspektuese, si dhe atë administrative ardhur si pasojë e mbivendosjeve apo vakumit ligjor.

Gjatë vitit 2023, në ekzekutimin e titujve ekzekutivë “Vendim Gjobe” nga Zyrat Përmbare, shumë subjekte kanë hapur procese gjyqësore duke kundërshtuar veprimet përmbare dhe duke kërkuar pavlefshmëri të titullit ekzekutiv. Sektorit Ankimimeve i është dashur të ndjekë çështje problematike të Vendim Gjobave të marra gjatë viteve shumë të hershme, thuhet nga 2015, ku shumë prej tyre, falë punës me përkushtim dhe profesionalizëm, kanë arritur të mbrojnë suksesshëm punën dhe vendimmarrjen e institucionit, duke konfirmuar se veprimtaria e institucionit po përmirëson treguesit dhe mbron konsumatorin.

Për periudhën në analizë, nga DÇJ është bërë e mundur administrimi i çdo çështjeje që lidhet me mbështetjen dhe sigurimin e asistencës ligjore dhe juridike në kuadër të ushtrimit të funksioneve dhe detyrave të të gjitha strukturave të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, zbatimin dhe respektimin e ligjit në çdo procedurë administrative që ndjek institucioni. Kështu është siguruar zbatimi i ligjshmërisë në veprimtarinë dhe procedurat e ushtrimit të sanksioneve, masave administrative (gjobat) dhe ndjekjeve penale ndaj subjekteve të inspektuar nga strukturat e ISHTI -t. Është ofruar këshillimi ligjor kurdoherë që është kërkuar nga çdo punonjës, sektor apo drejtoritë e institucionit.

Gjatë kësaj periudhe është punuar në mënyrë të vecantë me shoqëritë përmbare në lidhje me arkëtimin e gjobave nga debitorët. Në mënyrë të përmbledhur gjendja paraqitet si më poshtë vijon:

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2023:

Janë përgatitur **46 kërkesa** drejtuar gjykatës për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit gjithashtu janë dhënë **30 urdhra** ekzekutimi nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Për vitin 2023, janë lidhur në total 30 kontrata shërbimi me zyrat përmbare:

Jemi në pritje për konfirmimin mbi fuqinë e aktit administrativ “vendim gjobe” nga ana e gjykatës për 10 prej tyre.

Theksojmë se, po bëhet një punë e vazhdueshme me zyrat përmbare në arkëtimin e gjobave të dhëna ndër vite, të cilat kanë pasur një proces shumë të ngadaltë ekzekutimi.

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2023 janë vendosur në total 69 masa administrative, sipas Drejtorive respektive:

1. DINGN janë dhënë 17 masa administrative;
2. DIPNP janë dhënë 7 masa administrative;

3. DIPIEMN janë dhënë 45 masa administrative.

Nga masat administrative të vendosura për periudhën janar - dhjetor 2023, Komisioni i Ankimit i ngritur pranë ISHTI-t, ka shfuqizuar 15 të tilla, ndërsa 13 subjekte kundravajtës kanë likujduar vullnetarisht detyrimin.

Ndër të tjera, nga DÇJ janë ndjekur dhe kryer detyra të tjera si më poshtë:

1. Ndjekja në vazhdimësi e problematikave dhe asistimi me Drejtoritë dhe sektorët përkatës.
2. Hartimi i planit të punës në lidhje me ndjekjen e proceseve gjyqësore për çdo javë, gjatë gjithë vitit.
3. Hartimi i analizës paraqitur anëtarëve të komisionit dhe trajtimi juridik i ankimeve të ardhura në institucion në lidhje me masat administrative të marra nga inspektorët, për drejtoritë DINGN, DIPIEMN, DIPNP.
4. Korrespondenca e mbajtur me drejtoritë DINGN, DIPIEMN, DIPNP, për dhënien e informacionit në lidhje me masat administrative të nxjerra për gjatë gjithë vitit 2023 të cilat shqyrtohen në komisionin e kundravajtjeve administrative.
5. Pjesëmarrja në komisionin e shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, dhe trajtimi e shqyrtimi juridik në lidhje me rastet e sanksionuara me masë administrative.
6. Përpilimi dhe zbardhja e masave administrative të vendim gjobave të mbajtura përgjatë gjithë vitit 2023.
7. Korrespondenca mbajtur me sektorin e IT lidhur me data bazën e masave administrative të lëna në fuqi nga komisioni i masave administrative.
8. Verifikimi dhe ndjekja e vendimeve të gjykatave lidhur me proceset gjyqësore.
9. Kryerja e Analizave periodike të Sektorit të Ankimeve dhe Sektorit të Asistencës Ligjore, duke analizuar dhe bërë krahasimin ndër periudha të ndryshme.
10. Asistenca ligjore për drejtoritë e institucionit.

Performanca e DÇJ-së, ka qenë në nivele shumë të mira, është bërë përfaqësim dinjitoz dhe korrekt duke mbrojtur veprimtarinë e Institucionit në çdo rast kur ajo është kundërshtuar juridikisht. Njëkohësisht, duke analizuar peshën e vendimmarrjeve përfundimtare ose jo në favor të ISHTI në raport me paditë e pranuar të formës së prerë konstatojmë se, shumica e vendimmarrjes së ISHTI është konfirmuar nga trupa gjyqësore. Kjo gjë mbështetet duke pasur parasysh edhe numrin e Vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit, të formës së prerë, të cilat në shumicën e rasteve të vendimeve të ankimuara nga ana jonë, të gjykuara nga Gjykatat e Shkallës së Parë, janë ndryshuar në favor të ISHTI-t.

Përfundimisht DÇJ në ushtrimin e detyrave funksionale të ngarkuara, ka përmirësuar ndjeshëm shumë nga elementet e punës që bëhet në mënyrë të vazhdueshme nga ana e të gjithë punonjësve që mbulojnë këtë drejtori, duke rritur vlerat profesionale dhe performancën në tërësi.

↓ DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCËS
(DBF)

Për periudhën Janar – Dhjetor 2023 pranë institucionit tonë janë arkëtuar *195,716,821 lekë* nga të cilat:

- shërbimet *182,269,203 lekë*
- debitorët e trashëguar të vitit deri më 31.12.2022 *11,980,678 lekë*
- gjoba të arkëtuara *1,280,000 lekë*
- kamatë vonesa *186,940 lekë*

Gjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023 nga drejtoritë teknike të ISHTI-it janë evidentuar inspektime dhe faturime si vijon:

Fatura të emetuara nga shërbimi i moster-marrjes nga DING *181,698,000 lekë* dhe janë arkëtuar *178,872,000 lekë* duke rezultuar me situatë debitore në vlerën 2,826,000 lekë në mbyllje të vitit.

Informacioni në analitik për çdo strukturë përgjegjëse u është përcjellë drejtorëve të drejtorive përkatëse, periodikisht (çdo muaj), për të nxjerrë përgjegjësitë dhe minimizuar vlerat e paarkëtuara si në Tabelën 1.

Tabela 1.

<i>Te Ardhurat 2023 nga tarifat e shërbimit</i>			
<i>ISHTI</i>	<i>Detyrim</i>	<i>Likuidim</i>	<i>Debi</i>
	184,349,000	182,269,203	2,866,817
<i>Drejtoria e Inspektimit të Naftes dhe Gazit (DING)</i>	181,698,000	178,872,000	2,826,000
<i>Sektori 1 (Rajoni Qendror, Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë)</i>	117,128,000	115,911,000	1,217,000
Subjekte Shpk	44,635,000	43,955,000	680,000
Subjekte SHA	25,800,000	25,760,000	40,000
Subjekte të Doganes	46,693,000	46,196,000	497,000
<i>Sektori 2 (Rajoni Jugor Fier, Vlorë, Berat, Gjirokastrë)</i>	45,160,000	43,791,000	1,369,000
Subjekte Shpk	25,095,000	24,126,000	969,000
Subjekte SHA	5,910,000	5,760,000	150,000
Subjekte të Doganes	14,155,000	13,905,000	250,000
<i>Sektori 3 (Rajoni Verior Shkoder, Lezhë, Kukës, Diber)</i>	19,410,000	19,170,000	240,000
Subjekte Shpk	16,530,000	16,390,000	140,000
Subjekte SHA	2,850,000	2,750,000	100,000
Subjekte të Doganes	30,000	30,000	-
<i>Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve Elektrike (DIPJE)</i>	60,000	50,000	10,000
<i>Sektori 1 (Rajoni Qendror, Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë)</i>	60,000	50,000	10,000
<i>Sektori 2 (Rajoni Jugor Fier, Vlorë, Berat, Gjirokastrë)</i>	-	-	-
<i>Sektori 3 (Rajoni Verior Shkoder, Lezhë, Kukës, Diber)</i>	-	-	-
<i>Drejtoria e Laboratorit Qendror</i>	2,491,000	2,460,183	30,817
<i>Sektori 1 Laboratori Naftes, Gazit dhe nenprodukteve Qender</i>	1,888,000	1,857,183	30,817
<i>Sektori 2 Laboratori Tekstileve</i>	603,000	603,000	0
<i>Sektori 3 Laboratori Naftes, Gazit dhe nenprodukteve Portoromano</i>	-	-	0
<i>Karte teknologjike</i>	100,000	100,000	-
<i>Me shmanje nga standarti</i>	-	-	-

Njëkohësisht nga DBF në mënyrë periodike janë evidentuar arketimet nga debitorët e mbartur në çelje të vitit 2023, për çdo strukturë duke ndjekur dhe referuar situatën edhe me Drejtorinë Juridike, për të vijuar me ndjekjen e mëtejshme të procedurave për mbledhjen dhe arkëtimin e këtyre debitorëve.

Në vijim do të gjeni informacion të detajuar me vlerën debitore për çdo vit mbartur me 01.01.2023 dhe likuidimin e tyre deri më 31.12.2023 për çdo strukturë përgjegjëse të ISHTI-it

Ky informacion vjen i detajuar për debitorët si nga Tarifat e shërbimit (Tabela 3.) ashtu dhe nga penalitetet (Kundravajtjet Administrative (Tabela 2.).

Tabela 2.

Informacion përmbljedhes i debitoreve sipas strukture përgjegjëse						
Struktura përgjegjëse e të Ardhurave Debitorë	Perioda	Informacion Financiar				Debi 31.12. 2023
		Detyrim deri me 31.12.2022	Lik.Gjaba 2023	Lik.Kamata 2023	Vendim Komisioni Ankimimit të Gjybeve, Shfuqizime	
Drejtoria e Inspektimit të Naftes dhe Gazit (DING)	1999-2006	58,156,250	-	-	-	58,156,250
	2008	14,600,000	-	-	-	14,600,000
	2009	25,370,000	-	-	-	25,370,000
	2010	103,308,502	-	-	-	103,308,502
	2011	43,409,873	-	-	-	43,409,873
	2012	54,864,124	-	-	-	54,864,124
	2013	46,820,000	-	-	-	46,820,000
	2014	265,113,131	-	-	-	265,113,131
	2015	258,655,098	611,678	-	-	258,043,420
	2016	136,764,085	30,000	-	-	136,734,085
	2017	29,583,500	-	-	-	29,583,500
	2018	40,800,000	-	-	-	40,800,000
	2019	13,054,488	-	-	-	13,054,488
	2020	9,650,000	-	-	-	9,650,000
	2021	12,300,000	3,100,000	106,100	-	9,200,000
	2022	5,200,000	-	-	-	5,200,000
	2023	27,680,000	580,000	1,420	5,900,000	21,200,000
		1,145,329,051	4,321,678	107,520	5,900,000	1,135,107,373
Drejtoria e Inspektimit të Paisjeve Elektrike (DIPIE)	1999-2006	10,007,650	-	-	-	10,007,650
	2008	1,392,000	-	-	-	1,392,000
	2009	940,000	-	-	-	940,000
	2010	347,000	-	-	-	347,000
	2011	900,000	-	-	-	900,000
	2014	2,460,000	-	-	-	2,460,000
	2015	300,000	-	-	-	300,000
	2016	1,410,000	-	-	-	1,410,000
	2017	1,230,000	-	-	-	1,230,000
	2018	1,200,000	-	-	-	1,200,000
	2019	886,400	-	-	-	886,400
	2020	170,000	-	-	-	170,000
	2021	1,460,000	300,000	34,600	-	1,160,000
	2022	1,870,000	550,000	19,820	-	1,320,000
	2023	3,760,000	550,000	7,000	310,000	2,900,000
		28,333,050	1,400,000	61,420	310,000	26,623,050
Drejtoria e Instalimeve të Paisjeve nën Presion (DIPNP)	2008	200,000	-	-	-	200,000
	2009	535,000	-	-	-	535,000
	2010	766,372	-	-	-	766,372
	2011	260,000	-	-	-	260,000
	2012	585,000	-	-	-	585,000
	2014	800,000	-	-	-	800,000
	2015	600,000	-	-	-	600,000
	2016	5,799,000	-	-	-	5,799,000
	2017	14,450,000	-	-	-	14,450,000
	2018	3,700,000	-	-	-	3,700,000
	2019	50,000	-	-	-	50,000
	2020	-	-	-	-	-
	2021	2,350,000	500,000	18,000	-	1,850,000
	2022	2,500,000	50,000	-	-	2,550,000
	2023	850,000	150,000	-	500,000	200,000
		33,545,372	700,000	18,000	500,000	32,345,372
Drejtoria e Labororit Qendror Kombëtar (DLQK)						
		1,207,207,473	6,421,678	186,940	6,710,000	1,194,075,795

Situata e detyrimeve të prapambetura gjenerohet nga viti 2006 e në vijim për të cilat është informuar periodikisht Drejtoria Juridike pranë ISHTI-it. Gjithashtu DBF ka kërkuar në vazhdimësi të fillojnë procedurat e parashkrimit të këtyre detyrimeve sikurse referon dhe Ligji për kundravajtjet administrative. Sa vijon evidentohen situatat debitore në çelje të vitit ushtrimor për çdo vit dhe strukturë përgjegjëse, si dhe çfarë është arkëtuar në analitik gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 31.12.2023.

Tabela 3

Informacion permbledhes I debitoreve sipas struktures perqjegjese				
Struktura perqjegjese e te Ardhurave Debitore	Periudha	Likuidim		
		Detyrim deri me 31.12.2022	Debitore qjate vitit 2023	Debi 31.12.2023
Drejtoria e Inspektimit te Naftes dhe Gazit (DING)	2006	2,377,535	-	2,377,535
	2007	5,232,441	-	5,232,441
	2008	6,923,671	-	6,923,671
	2009	7,660,780	-	7,660,780
	2010	9,055,582	-	9,055,582
	2011	7,115,642	-	7,115,642
	2012	10,967,087	-	10,967,087
	2013	2,927,649	-	2,927,649
	2014	1,734,613	-	1,734,613
	2015	18,867,150	-	18,867,150
	2016	5,079,200	-	5,079,200
	2017	1,180,070	-	1,180,070
	2018	7,755,000	-	7,755,000
	2019	2,045,000	-	2,045,000
2020	2,539,000	-	2,539,000	
2021	2,040,000	-	2,040,000	
2022	8,127,150	6,819,000	1,308,150	
		101,627,570	6,819,000	94,808,570
Drejtoria e Inspektimit te Paisjeve Elektrike (DIPIE)	2007	36,750	-	36,750
	2008	5,040	-	5,040
	2009	45,600	-	45,600
	2010	15,000	-	15,000
	2011	30,000	-	30,000
	2012	38,018	-	38,018
	2013	-	-	-
	2014	110,000	-	110,000
	2015	30,044	-	30,044
	2016	20,000	-	20,000
	2017	10,000	-	10,000
	2018	160,000	-	160,000
	2019	40,000	-	40,000
2020	20,000	-	20,000	
2021	10,000	-	10,000	
2022	-	-	-	
		570,452	-	570,452
Drejtoria e Instalimeve te Paisjeve nen Presion (DIPNP)	2007	2,926,470	-	2,926,470
	2008	871,937	-	871,937
	2009	2,510,239	-	2,510,239
	2010	2,858,270	-	2,858,270
	2011	14,000	-	14,000
	2012	363,950	-	363,950
	2013	270,040	-	270,040
		9,814,906	-	9,814,906
Drejtoria e Laboratorit Qendror Kombetar (DLQK)	2012-2019	124,000	-	124,000
	2022	245,233	220,000	25,233
		369,233	220,000	149,233
		112,382,162	7,039,000	105,343,162

Gjatë Vitit 2023, institucioni vazhdon të kalojë periudha të vështira me financime nga buxheti i shtetit. Në vijim, po ju referojmë informacionin analitik me buxhetet e alokuara, si dhe përdorimin e tyre vjetor sipas klasave të miratuara.

Tabela 4.

Situacioni shpenzimeve JANAR-DHJETOR 2023 ISHTI

GR	PROG	KAR	Proj.	ART	Plani Vjetor	Plani Thesarit	Shp. Thesarit	Xhirime Brendsh	Xhirime Brendsh	Garanci	Pa paguar	Banka	Viti 2022	Total Banka	Nr. Punonjesve	
							(1)	sig-tap (2)	(3)			(4=1-2-3)	6	(7=1-3)	PLAN	FAKT
06	04440	1	90604AA	600	231,630,000	231,630,000	231,630,000	46,429,222				185,200,778		185,200,778	200	200
06	04440	1	90604AA	601	39,000,000	39,000,000	38,388,643	38,388,643				-		-		
			600-601		270,630,000	270,630,000	270,018,643	84,817,865				185,200,778		185,200,778	200	200
06	04440	1	90604AA	602	51,000,000	51,000,000	49,614,564	150,585				49,464,079	3,427,140	49,464,079	-	-
06	04440	1	90604AA	606	-	919,890	864,758	82,852				781,906		781,906	-	-
			602-606		51,000,000	51,919,890	50,479,422	233,437				50,245,985	3,427,140	50,245,985	-	-
06	04440	1	M064072	231	20,238,000	20,238,000	20,238,000					20,238,000		20,238,000		
06	04440	1	188Q017	231												
06	04440	1	M064117	231												
					20,238,000	20,238,000	20,238,000					20,238,000		20,238,000		
					341,868,000	342,787,890	340,736,065	85,051,302				255,684,763	3,427,140	255,684,763	200	200

Tabela 5.

Miratim i Buxhetit 2023 MIE 861/1 date 25.01.2023 me tonen 543 date 26.01.2023 në lekë

EQ	ML	Kodi Institucioni	Emër institucioni	Kap.	Prog.	Llogaria Ek.	Kodi Degës Thesarit	Kodi produktit	DET AJINI 2023	Shtesa Nr.6946/6 date 10.10.2023, 8402/18 date 09.11.2023	Shtesa MIE Nr 7803/3 date 25.10.2023	Shtesa MIE Nr 8402/18 date 09.11.2023 (AN 5 date 18.10.2023)	Pakesim MIE Nr 9854/32 date 09.01.2024 (AN 6 date 14.12.2023)	Shtesa MIE Nr 223/1 date 19.01.2024 (VKM 795 date 28.12.2023)	2023
001	06	1008157	Inspektorati Shtetor Teknik dhe industrial	01	04440	6000000	3635	90604AA	203,000,000		30,600,000		(1,800,000)	430,000	231,630,000
001	06	1005157	Inspektorati Shtetor Teknik dhe industrial	01	04440	6010000	3635	90604AA	34,000,000		5,000,000				39,000,000
001	06	1008157	Inspektorati Shtetor Teknik dhe industrial	01	04440	6020000	3635	90604AA	38,000,000			13,000,000			51,000,000
001	06	1006157	Inspektorati Shtetor Teknik dhe industrial	01	04440	6060000	3635	90604AA	267,945		651,945				919,890
Total Programi									275,267,945	35,000,000	651,945	13,000,000	(1,800,000)	430,000	322,549,890

Tabela 6.

Detajim i buxhetit 2023 Shpenzime kapitale MIE Nr.1360/2 date 15.03.202 me tonen 2071 date 16.03.2023 në lekë

Artikulli 231 Shpenzime Kapitale

EQ	ML	Kodi Institucioni	Emër institucioni	Kap.	Prog.	Llogaria Ek.	Kodi Degës Thesarit	Kodi Projektit	Titulli Projektit	DET AJINI Buxhet i miratuar 2023 MIE 1360/4 date 24.03.2023	Pakesime	Pakesime/shtesa rialokim MF 2341/4 date 04.05.2023, MIE1360/9 date 22.05.2023	Realizim 30.09.2023	Pakesim MIE Nr 9854/29 date 09.01.2024 (AN 6 date 14.12.2023)	Disponibel deri me 31.12.2023
001	06	1008157	Inspektorati Shtetor Teknik dhe industrial	01	04440	2310000	3635	M064072	Aparatura te Laboratorit te Tregantit Cilesor	20,000,000		11,300,000	20,238,000	(11,062,000)	-
001	06	1005157	Inspektorati Shtetor Teknik dhe industrial	01	04440	2010000	3635	188Q017	Aparatura te Laboratorit te	23,750,000		(11,500,000)		(12,450,000)	-
001	06	1008157	Inspektorati Shtetor Teknik dhe industrial	01	04440	2310000	3635	M064117	Laborator Levizës	19,200,000				(19,200,000)	-
Total Programi										62,950,000			20,238,000	(42,712,000)	

Sikurse vihet re nga informacioni i mësipërm, fondet e alokuara nga Buxheti i Shtetit për vitin 2023 janë nën limitet e kërkuara për Shpenzime Operative, ndaj në mënyrë periodike janë kërkuar dhe argumentuar me relacion nevojat shtesë në vlerën 38,300,000 lekë, nga të cilat u mundësuan vetëm 13,000,000 lekë në muajin tetor 2023 duke mundësuar mbulimin e emergjencave për Enë Metalike dhe Plastike, Sigurimi i Ndërtesës së ISHTI-it, Shërbim i sistemit të Aspirimit në LQ të Naftës dhe Gazit ,Dieta të papaguara të punonjësve, si dhe disa emergjenca të tjera. Vlen të theksojmë që, nuk u arrit të mbulohet me fonde Shërbim Kalibrimi i LQ të Naftës dhe Gazit (i përvitshëm), i domosdoshëm për Akreditimin e tij dhe të shërbimeve që ofron kjo strukturë.

Për vitin 2023 realizimi dhe përdorimi i fondeve për shpenzime operative është kryer nëpërmjet Degës së Thesarit Tiranë, me 354 Urdhëra Shpenzimi, si vijon në analitik sipas klasave dhe zërave të shpenzimeve si në Tabelën 7.

Tabela 7.

	BO ISHTI 2023	Realizimi progresiv 2023	Disponibel	
602.0	Materiale zyre dhe te pergjithshme	2,241,380	2,238,180	(3,200)
602.01	Kancelari	847,500	847,500	-
602.02	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndrigim	299,880	299,880	-
602.03	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyrës *inf	594,000	594,000	-
602.05	Blerje dokumentacioni	500,000	496,800	(3,200)
602.1	Materiale dhe sherbime speciale	9,302,666	8,568,056	(734,610)
602.1007	Libra dhe publikime profesionale	114,000	114,000	-
602.1009	Materiale dhe pajisje laboratorike te sherbimit publik	5,914,290	5,179,680	(734,610)
602.1010	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik (Standarte)	326,456	326,456	-
602.1099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale shrita per sekretim mostre,ene plastike dhe	2,947,920	2,947,920	-
602.2	Sherbime nga te trete	8,913,343	9,003,969	90,626
602.2001	Elektricitet	1,127,934	1,127,934	-
602.2002	Uje	274,000	272,864	(1,136)
602.2003	Sherbime telefonike	158,000	145,174	(12,826)
602.2004	Posta dhe sherbimi komier	258,290	258,290	-
602.2008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes	5,616,077	5,616,080	3
602.2099	Sherbime te tjera	1,479,042	1,583,627	104,585
602.3	Shpenzime transporti	9,730,144	9,730,144	0
602.31	Karburant dhe vaj	9,105,200	9,105,200	0
602.32	Pjese kembimi, goma dhe bateri	560,160	560,160	-
602.33	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit	64,784	64,784	-
602.4	Shpenzime udhetimi	9,285,919	8,652,351	(633,568)
602.40	Udhetim i brendshem	8,686,958	8,053,390	(633,568)
602.41	Udhetim jashte shtetit	598,961	598,961	-
602.5	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	94,600	94,600	-
602.58	Shpenzime per mirembajtjen e pajisjeve te zyrave,Riparim Kondioner	94,600	94,600	-
602.6	Shpenzime per qeramarrje	9,643,200	9,643,200	-
602.61	Shpenzime per qeramarrje ambjentalsh	480,000	480,000	-
602.64	Shpenzime per qeramarrje mjetelesh transporti	9,163,200	9,163,200	-
602.7	Shpenzime per detyrime dhe kompensime legale	667,784	667,784	-
602.74	Shpenzime per ekzekutim te vendimeve gjyqesore per largim nga puna	667,784	667,784	-
602.9	Shpenzime te tjera operative	1,120,965	1,120,965	-
602.9004	Shpenzime per sigurimin e ndërtesave dhe te tjera kosb sigurimi te ngjashme	1,120,965	1,120,965	-
		51,000,000	49,719,249	(1,280,752)
600		231,630,000	231,630,000	-
601		39,000,000	38,388,643	(611,357)
606		919,890	864,758	(55,132)
231		20,238,000	20,238,000	-
		342,787,890	340,840,650	(1,947,241)

Vlen të theksohet se, për vitin 2023 kishim të alokuara 62,950,000 Lekë, për tre projekte investimi në pajisje të Laboratorit Qendror, Laboratorit Tekstili, si dhe blerje Autolaboratori si në Tabelën 6, por nuk u bë i mundur përdorimi i tyre, për shkak të ngecjes së procedurave në APP.

Në këto kushte, në Dhjetor të vitit 2023 pjesa e papërdorur u kthye në Buxhetin e Shtetit (si shpjeguar në Tabelën 6).

Drejtoria e Buxhetit dhe Financës pranë ISHTI-it, raporton në mënyrë periodike (muajore) pranë ministrisë së linjës (MIE), informacion të rakorduar me Degën e thesarit Tiranë për arkëtimet nga të ardhurat dhe për shpenzimet e kryera referuar buxhetit të miratuar.

Gjithashtu në mënyrë periodike, referuar grafikut të raportimeve nga MIE, DBF përpilon dhe referon Buxhetet respektive (PBA) vjetore, Raportet e monitorimit për Investimet e periudhës dhe shpenzimet korrente, Raportin e shpenzimeve në valutë dhe cdo raportim apo informacion financiar informacion e raportim të kërkuar nga MIE dhe MF.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE TË BRENDSHME
(DBNJSHB)

❖ **Baza Ligjore**

- *Ligji nr. 7961/1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë". i ndryshuar.*
- *Ligji nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".*
- *Ligji nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore".*
- *Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike".*
- *Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë",*
- *Ligjit Nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat";*
- *VKM nr. 410, datë 13.05.2015, "Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial".*
- *VKM nr. 103, datë 04.02.1998, "Për rregullat e përgjithshme të punës në administratën shtetërore"*
- *VKM Nr. 568, datë 06.10.2021 "Për Miratimin e Rregullave për Kohëzgjatjen e Punës dhe të Pushimit, Orët Shtesë dhe Kompesimin e tyre në Institucionet e Administratës Shtetërore, Institucionet e Pavarura dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore",*
- *Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë"*
- *Urdhrit, e Kryeministrit Nr 105, datë 13.08.2020 "Për Miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", i ndryshuar.*
- *Urdhrit e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 288, datë 13.10.2020, "Për miratimin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial".*

Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme (DBNJSHB) si pjesë përbërëse e strukturës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, gjatë ushtrimit të detyrave të saj funksionale dhe organizative ka për qëllim të sigurojë efikasitet në mbarëvajtjen e punës për sa i përket, menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Arkivë-Protokollit, Prokurimeve Publike, Shërbimeve të Brendshme dhe TIS. Gjithashtu, DBNJSHB ka si objektiv kryesor të punës së saj, mbështetjen dhe asistencën e të gjithë instancave në përbërje të strukturës së ISHTI-t, për të mundësuar realizimin e detyrave të tyre funksionale në mënyrë eficiente dhe efikase, në arritje të qëllimeve dhe objektivave të përgjithshëm të institucionit.

Në vijim paraqitet në mënyrë të detajuar veprimtaria e punës së kryer gjatë vitit 2023, nga secili sektor përkatës i DBNSHB-së.

I. SEKTORI I PROKURIMEVE DHE SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Nga sektori i Prokurimeve Publike dhe Shërbimeve të Brendshme, për periudhën Maj - Gusht 2023 janë realizuar detyrat si më poshtë:

1. Në zbatim të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 3, të nenit 3, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor në varësi të nevojave gjatë periudhës Shtator-Dhjetor të çdo viti përgatit regjistrim për vitin ushtrimor në vijim bazuar në ligjin që miraton parashikimet buxhetore afatmesme. Në çdo rast afati maksimal i hartimit të regjistrit jo më vonë se 10 ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës.”, në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës është hartuar Regjistri i Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit Publik për vitin 2023.

Gjithashtu, në zbatim të pikës 4 të po këtij neni, ku përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor ka detyrimin të krijojë regjistrin e parashikimeve në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i zërave të tij nga APP-ja duhet të bëhet brenda 3 ditëve nga dita e nesërme e punës nga dërgimi i tij për publikim në sistem.”, është realizuar publikimi në sistem i Regjistrit të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit Publik për vitin 2023, i cili pas disa rishikimeve në bazë të fondeve në dispozicion, mori formën si më poshtë vijon:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Kodet CVP	Lloji i prokurimit	Tipi	Tipi i kontratës	Lloji i regjistrit të prokurimit	Burimi i Financimit	Vlera	Lloji i procedurës së prokurimit	Koha e planifikuar për zhvillim
1	Blerje CRM për laboratorin e	Reagentë kimikë,	Prokurim	Kontrate	Mallra	Procedure Prokurimi	Buxheti i shtetit	450000.00	Small Value	Dhjetor
							Vetë Financim	0.00		
							Fonde të tjera	0.00		
2	Blerje dosje me llasik	Dosje	Prokurim	Kontrate	Mallra	Blerje nen vlerën 100 000 Leke	Buxheti i shtetit	40000.00		Dhjetor
							Vetë Financim	0.00		
							Fonde të tjera	0.00		
3	Blerje laborator lëvizës (autolaborator) pjesë e Labororit Qendror	Automjete, Automjete të specializuara, Automjete për qëllime të veçanta	Prokurim	Kontrate	Mallra	Procedure Prokurimi	Buxheti i shtetit	1600000.00	Open Local	Dhjetor
							Vetë Financim	0.00		
							Fonde të tjera	0.00		
4	Implementimi i programit të kontabilitetit	Shërbime instalimi të kompjuterëve dhe pajisjeve për përpunimin e informacionit. Shërbime	Prokurim	Kontrate	Shërbime	Procedure Prokurimi	Buxheti i shtetit	416666.67	Small Value	Dhjetor
							Vetë Financim	0.00		
							Fonde të tjera	0.00		
5	Blerje aparatura laboratorike për treguesit cilësor të tekstilëve në Laboratorin Qendror	Peshore elektronike analitike, Peshore elektronike teknike	Prokurim	Kontrate	Mallra	Procedure Prokurimi	Buxheti i shtetit	10375000.00	Open Local	Dhjetor
							Vetë Financim	0.00		
							Fonde të tjera	0.00		
6	Blerje materiale pastrimi	Pastrues duarsh, Produkte	Prokurim	Kontrate	Mallra	Procedure Prokurimi	Buxheti i shtetit	500000.00	Small Value	Dhjetor
							Vetë Financim	0.00		
							Fonde të tjera	0.00		
7	Blerje materiale kancelarie	Makineri kompjuterike dhe	Prokurim	Kontrate	Mallra	Procedure Prokurimi	Buxheti i shtetit	800000.00	Small Value	Dhjetor
							Vetë Financim	0.00		
							Fonde të tjera	0.00		
8	Blerje bojera printeri, fotokopje,	Toner per printer lazer	Prokurim	Kontrate	Mallra	Procedure Prokurimi	Buxheti i shtetit	990000.00	Small Value	Dhjetor
							Vetë Financim	0.00		
							Fonde të tjera	0.00		
9	Shërbime riparim dhe mirëmbajtje për sistemin e aspirimit të laboratorit të ISHTH	Aspiratorë, Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi, Shërbime mirëmbajtjeje	Prokurim	Kontrate	Shërbime	Procedure Prokurimi	Buxheti i shtetit	500000.00	Small Value	Dhjetor
							Vetë Financim	0.00		
							Fonde të tjera	0.00		
10	Blerje gaze teknike	Gazra, Gazra industriale,	Prokurim	Kontrate	Mallra	Procedure Prokurimi	Buxheti i shtetit	2250000.00	Open Simple	Dhjetor
							Vetë Financim	0.00		
							Fonde të tjera	0.00		

11	Sigurimi TPL i automjeteve të ISHTH-t	Shërbime për sigurimin e detyrueshem për automjetet	Prokurim	Kontrata	Shërbime	Procedure Prokurimi	Buxheti i shtetit	160000.00	Small Value	Dhjetor
							Vetë Financim	0.00		
							Fonde të tjera	0.00		
12	Kampion marrëse për GLN	Enë me presion	Prokurim	Kontrate	Mallra	Procedure Prokurimi	Buxheti i shtetit	709333.33	Small Value	Dhjetor
							Vetë Financim	0.00		
							Fonde të tjera	0.00		
13	Shërbim riparimi dhe mirëmbajtje për pajisjet elektronike	Mirëmbajtje dhe riparim i pajisjeve të teknologjisë së informacionit, Riparim i pajisjeve të teknologjisë së informacionit	Prokurim	Kontrate	Shërbime	Blerje nen vlerën 100 000 Leke	Buxheti i shtetit	100000.00		Dhjetor
							Vetë Financim	0.00		
							Fonde të tjera	0.00		
14	Blerje bileta avioni	Bileta, Bileta transporti, Agjenci udhëtimi dhe shërbime të ngjashme, Agjenci transporti	Prokurim	Sistem Dinamik	Shërbime	Procedure Prokurimi	Buxheti i shtetit	110000.00	Purchase Tickets	Dhjetor
							Vetë Financim	0.00		
							Fonde të tjera	0.00		
15	Blerje karburanti	Karburante, Benzine, Karburant diesel	Prokurim	Kontrate	Mallra	Procedure Prokurimi	Buxheti i shtetit	833333.33	Open Simple	Dhjetor
							Vetë Financim	0.00		
							Fonde të tjera	0.00		
16	Blerje enë metalike dhe plastike për marrje mostre karburanti	Enë, Shishe	Prokurim	Kontrate	Mallra	Procedure Prokurimi	Buxheti i shtetit	541666.67	Open Simple	Dhjetor
							Vetë Financim	0.00		
							Fonde të tjera	0.00		
17	Kontrolli dhe shërbim mirëmbajtje i pajisjeve të MNZ	Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve zjarfikuese	Prokurim	Kontrate	Shërbime	Blerje nen vlerën 100 000 Leke	Buxheti i shtetit	70000.00		Dhjetor
							Vetë Financim	0.00		
							Fonde të tjera	0.00		
18	Shërbime për mirëmbajtjen e rrezeve hidraulike	Shërbime mirembajtjeje	Prokurim	Kontrate	Shërbime	Blerje nen vlerën 100 000 Leke	Buxheti i shtetit	100000.00		Dhjetor
							Vetë Financim	0.00		
							Fonde të tjera	0.00		
